

ΒΑ. GASHI Η
ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΑ
SHQIPNIJA

(GJEOGRAFI)

me 78 ltyra
dhe 5 harta

ATJANINON

BKL
G9

38/3-

ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ
ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟΥ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ



026000334044





N. M. e Tij ZOG I
Mbreti i Shqiptarëve
Ai që e shpëtoi Shqipnin edhe i a rriti emnin e 'sajë



Αριθ. 210. 141. 203.

A. GASHI

GJEOGRAFIJA E SHQIPNIS

PËR SHKOLLAT NORMALE E TË MESME

BIBΛΙΟΘΗΚΗ
 ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΑΑ
 ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟΥ ΚΟΥΡΙΑΑ
 ΠΑΥΛΙΩΤΟΥ
 ΑΥΕΩΝ ΑΡΙΘ.

PELQYE PREJ MINISTRISE E ARSIMIT
 ME SHKRESËN N. 2277 ME 18.7.1933

BOTIM I PARË
ME 5 HARTA DHE 78 FYTYRA

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ
 ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ
 Μητροπολίτη
 ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΑΑ



A. Gashi

SHTËPIJA BOTONJËSE «LUARASI»
TIRANË, 1933



BIBLIOGRAFI

Veprat, që i mora si bazë studimi për hartimin e kësaj gjeografije, po i shënoj këtu poshtë:

1) *Albanien*, von Dr. Herbert Louis, 1927 Verlag von J. Engelhorn's Nachf. in Stuttgart.

2) *In Albaniens Bergen*, von Dr. Friedrich Markgraf. Verlag von Strecker und Schroeder in Stuttgart, 1930.

3) Dr. Ernst Nowack, *Der Nordalbanische Erzbezirk*. Abh. Z. prakt. Geol. u. Bergwirtschaftslehre. Bd. 5. Halle a. S. 1926.

4) *Durch Albanien und Montenegro*, von Hugo Grothe. Muenchen 1913 / Martin Moerikes Verlag.

5) Leon Rey, *Guide de l'Albanie*, 6 Avenue Kléber - Paris 1930

6) Gabriel Louis-Jaray, *L'Albanie inconnue*, Deuxieme édition, Librairie Hachette et Cie 79, Boulevard Saint-Germain, Paris 1913.

7) *Peuples et Nations des Balkans*, par Jacques Ancel, 1926.

8) *Dictionnaire universel d'histoire et de Géographie*, par Ch. Samy Bey Frascbery.

9) *Pritmi i Shqipërisë* prej Lumo Skendo 1915.

10) *Shqipria më 1927* prej T. Selenica.

11) Koleksioni i revistës *Bujqësiya* edhe *Ekonomisti Shqiptar*.

12) *Statistikat e tregtis së jashme të Shqipnis* për vitin 1930-1931-1932.

13) Koleksionet e të përkohshmevet si edhe të disa kalendarevet të ndryshme shqipe.



PËRMBAJTJA E LANDËS

Parathanëje	Page	V
I. Studimi fizik i Shqipnis së Lirë.		
Trajta e sipërfaqes	„	1
Vargmalet, malet edhe pllajat	„	3
1. Alpet e Shqipnis së Veriut	„	4
2. Vargu Linduer	„	6
3. Grumbulli i malevet Qendrorë	„	8
4. Vargmalet detikë ose perëndimorë	„	11
5. Vargmalet jugorë të Shqipnis së Naltë jugore	„	13
Fushat edhe Luginat	„	18
A. Fushat e Shqipnis s' Ulët	„	18
1. Fushat rreth Shkodrës	„	18
2. Fushat ndërmjet Leshit, Tiranës edhe Durrësit	„	20
3. Fushat e Elbasanit	„	21
4. Fushat e gjana të Myzeqesë	„	22
B. Fushat edhe luginat e lagjes së Vijosës	„	23
1. Lugina e Vijosës së Sipërme	„	23
2. Zagorija edhe Pogoni	„	24
3. Lugina e Dropullit	„	24
4. Luginat e Ulësinat e Delvinës	„	25
C. Fushat edhe Luginat e Shqipnis së Naltë ose të Mbrendëshme	„	26
1. Fusha e Korçës	„	27
2. Lugina e Devollit të Sipërm	„	28
3. Fusha e Starovës	„	28
4. Fusha e Kododeshit	„	30
5. Lugina e Drinit të Zi	„	30
6. Luginat e Malësis së Gjakovës	„	31
7. Ulësinat e lagjes së Sipërme të lumit të Matit	„	31
Klima	„	38
1. Gjendja klimatike e Shqipnis	„	38
2. Vera edhe sasija e shinavet në Shqipni	„	34
3. Temperatura në verë	„	36
4. Stina e dimnit	„	37



IV

Flora edhe fauna	<i>faqe</i>	40
1. Brezi i matjevet	40
2. Pyjet e Dushqevet	42
3. Pyjet e brezit të Naltë edhe brezi alpinuer	44
4. Farët e ndryshme të tokavet bujqësore	49
5. Shtazët e egëra	49


II. Studimi politik i Shqipnis.

1. Popullsija	51
2. Fiset e Shqipnis	52
3. Sasiya edhe shpeshësija e popullsis	54
4. Banesat katundare edhe katundet	55
5. Qytetet edhe roli i 'tyne	57
Të ndamet administratore	59
I. Prefektura e Shkodrës	59
II. Prefektura e Tiranës	64
III. Prefektura e Durrësit	66
IV. Prefektura e Elbasanit	69
V. Prefektura e Beratit	72
VI. Prefektura e Vlonës	74
VII. Prefektura e Gjinokastrës	76
VIII. Prefektura e Korçës	80
IX. Prefektura e Dibrës	83
X. Prefektura e Kosovës	84
Pasqyrë e të ndamit administratuer	86-87

III. Studimi ekonomik i Shqipnis.

1. Bujqësija edhe vendi i saj	88
2. Pasunija shtazore	93
3. Pasunit pyjore edhe minerale	96
4. Mjetet marrëdhane edhe rrugët në Shqipni	97
5. Tregtija e jashtme e Shqipnis	100
Pasqyra të tregtis së jashtme	104
6. Gjendja ekonomike e kulture	109
Formimi i Shtetit	111






PARATHANËJE

Deri më sot na ka munguem një tekst gjeografije mbi Shqipërinë. Këte mungesë të gjithë ne arsimtarët e kemi ndijë shumë ças për ças në çdo vit shkolluer. Nga ky shkak kam shumë kohë që i u kam përveshun punës për hartimin e njëj teksti të tillë; mirëpo, i rrethuem me mungesa mjeteshe edhe më fort që të përfitojsha prej praktikës në të dhanunit e kësaj lande si mësim nëpër rendet e ndryshme të shkollave të mesme, jam vonuem deri tash për të botuemen e këtij teksti gjeografije të Shqipërisë.

Gjatë kësaj kohe kam mundë të përfitoj prej mjeteve të ndryshme, që na kanë shtruem përpara dijetarët e huej. Që më 1925 e tetu, shumë dijetarë të huej tue gjetun rast nga qetsija shembullore që mbretnoi në vendet tona, erdhën një mbas njëje me qëllim studimi. Këta si përfundim të studimeve të tyre filluen të botojnë libra shumë të dobishëm, ku përshkruajnë me auktoritet e me kompetencë të gjitha krahinat t'ona arbnore, në pikëpamje të përgjithëshme gjeografike.

Veprat e këtyne dijetarëve të huej si Dr. Ernst Nowack, Dr. Herbert Louis, Dr. F. Markgraf etj., emnat e të cilëve i kam zanë me gojë edhe në bibliografin e këtij teksti, kanë qenë burime të shëndosha për mua, se prej këtyneve mora pjesat e nevojituna për këtë tekst shkolluer.

Ky tekst nuk është pa të mëta, është një skelet që don edhe shumë të bëhet i plotë; prandaj do të më kënaqin kri-



tkat e kënduesvet edhe veçanisht t' arsimtarëvet dashamirë të kësaj dege, kështu që të mund t' a përmirësoj këte libër në shtypjen e dytë.

Do t' ia u di për nderë gjithë atyne dashamirëvet që kanë me më dërguem përshkrime të ndryshme edhe legjenda mbi vendet e njoftuna prej 'tyne, që kështu në botimet e tjera të mundem me e shtuem tekstin me lëndë më të gjënë e më tërheqëse.

Këtu due t' i falem nderit Z. Prof. Ymer Saraçit kundrejt të cilit jam mirënjofhtës për shumë përkëthime nga Gjermanishtja, që më kanë hymë në punë në të hartuemen e këtij teksti.

Për studimin e këtij libri, si mjet mësimi ndër shkolla të mesme mund të përdoret çdo hartë e mirë e Shqipnis me masën deri më 1:200 000. Në këte punë e kam gjetë të mirë të përdorunit e hartës: Albanien prej Dr. Herbert Louis.

AUKTORI




SHQIPNIJA





Fig 1 - Shqipnija ethnike.
Harta e Komitetit Shqiptar të Londanit 1912—1913

Kopjuem prej librit „Albanais et Slaves“ të Lumo Skendo-s



SHQIPNIJA

Vend, madhësi edhe kufi. — Shqipnija, atdheu i ynë i dashtun, pushton anën jugë-perëndimore të gadishullit të Ballkanit; shtrihet në bregun linduer t'Adriatikut e të Jonit ndërmjet shkallëvet të gjanësis veriake $39^{\circ}.30'$ — $42^{\circ}.40'$ edhe të shkallëvet të gjatësis lindore $19^{\circ}.20'$ — $21^{\circ}.3'$, me një sipërfaqe prej 28.390 kilometra katrorë.¹⁾

Kjo me këte madhësi formon Mbretërin t'onë të Lirë ose Shqipnën e Lirë, kufijt e së cilës u-caktuen padrejtësisht me vendimin e Konferencës së Londonit mbas luftës së Ballkanit më 1913; porse atdheu i ynë i vërtetë, Shqipnija ethnike, gjithë ai vend ku i thohet «bukës bukë e ujit uj», është edhe tri herë më i gjanë; shtrihet ndërmjet shkallëvet $39^{\circ}.0'$ — $43^{\circ}.0'$ të gjanësis veriake edhe $19^{\circ}.20'$ — $21^{\circ}.50'$ të gjatësis lindore.

Pjesën e Shqipnis së mbetun nën qeverimin e huej do ta quejmë Shqipnija e Robnueme, për të cilën do të flasim veçan.

I. Studimi fizik i Shqipnis së Lirë.

Trajta e sipërfaqes. — Drejtimet që marrin në të rrjedhunit e 'tyne lumejt e Shqipnis, na japin kuptimin e plotë mbi trajtën e sipërfaqes së tokëvet të 'saj.

Tue qenë se shumica e lumejvet të Shqipnis në të rrjedhunit e 'tyne kanë një drejtim, pothue plotësisht, prej

¹⁾ Vereni hartën e Shqipnis prej Dr. Herbert Louis.





Fig. 2. - Shqipnija e lirë.



lindjes në perëndim, kuptojmë pra se krahinat e Shqipnís nga lindja janë má të nalta edhe vijnë gjithënjí tue u-ulun má sa vijnë nga perëndimi e pranë brigjevet t' Adriati- kut, marrin trajtën e kodrinavet, deri sa këthehen në fusha.

Vetëm dy krahinat skanjore, veriake e jugore të Shqipnís, na dalin pak jasht kësaj rregulle; pse krahinat veriake, që ndodhen në anën e veriut të Drinit të bashkuem me shumicën e anëvet të 'tyne, vijnë tue u-ulun nga juga (vereni drejtimin e kambëvet të djathta të Dri- nit) edhe krahinat jugore të ndodhuna në jugë të Vijo- sës, me përjashtimin e lagjës së lumejvet Pavla-Leshnica e Kalasës, vijnë tue u-ulun thuej se prej juge në veri (vereni drejtimin e kambëvet të majta të Vijosës).

OROGRAFI EDHE HYDROGRAFI

Vargmalet, malet edhe pllajat. — Malsinat e dhe pllajat mbulojnë shumicën e sipërfaqes s' atdheut t' onë (afër $\frac{3}{4}$). Gjithë vargjet e Shqipnís mund t' i ndajmë në pesë grupe:

1. *Alpet e Shqipnís së Veriut, përmbi Drinin e bashkuem, nga veriu.*
2. *Vargu linduer, në të djathtë të Drinit të Zi.*
3. *Grumbulli i malevet qendrorë, prej Drinit¹⁾ deri afër liqenit të Maliqit me një krah edhe deri në ulësinat e Kolonjës me tjetrin.*
4. *Vargmalet perëndimorë ose detikë, prej fushavet të Shkodrës deri në Vijosë.*
5. *Vargmalet jugorë të Shqipnís së naltë Jugore.*

Verejtje: Nga këta pesë grupe, tre të mesmit zgjaten prej veriut në jugë pothue paralel njani me tjetrin, tue rrethuem pllaja, lugina e fusha shumë pjellore ndërmjet

¹⁾ Drini i bashkuem quhet thjeshtësisht *Drin*.



'tyne e tue u-përçamun në shumë vende me gryka e me qafa të kalueshme.

Grupi i parë edhe i pesti përbâhen prej malevet të shumta, të cilët në të zgjatunit e 'tyne nuk e ndjekin drejtimin e të parëvet.

1. **Alpet e Shqipnís së Veriut.** — Alpet e Shqipnís së Veriut pushtojnë vendet, që ndodhen në veri të Drinit; shtrihen prej J. P. në V. L., qysh prej krahinavet lindore të Shkodrës e deri te lugina e Limit (nji lum i Kosovës së Robnueme); mbulojnë nji vend prej 50 km. gjatësi edhe 20 km. gjanësi.

Këta Alpe kanë nji natyrë krejt këlqerike, porsí Alpet e Dinarit të Hercegovinës e të Malit të Zi; nga juga shtrihen deri te malet e Cukalit (1722 m.) pranë Drinit, nga lindja deri te malet serpentinorë të Malsís së Gjakovës, nga veriu deri te lugina këlqerike e Limit edhe nga veri-perëndimi deri te bjeshkët e Malit të Zi.

Vendet mà të naltësuem të këtyne Alpeve ndodhen në veri afër kandit të drejtë të kufinit, Bjeshkët e Namuna me malin Jezerce (afër 2700 m.); kjo anë zihet si qendra e ujnavet rrjedhës të këtyne viseve malësore, mbassi prej këndeje burojnë e zdirgjen në drejtime të ndryshme: nga jugë-perëndimi Cemi edhe Prroni i Thatë, që shkojnë e derdhen në liqenin e Shkodrës; nga juga lumi i Shalës, i cili në pjesën e poshtme quhet Leshnicë edhe lumi i Curajit, qi bashkë me lumin e Shalës, tue rrjedhun me këte drejtim, i përzijnë ujnata e veta me Drinin; nga lindja Valbona, kamba e Drinit, edhe nga veriu nji degë e vogël e Limit.


Gjithë këta përrenj që u-përmendën, i kanë gërryem më katër anët këto krahina malësore, nëpër të cilat kanë formuem lugina shumë të fella (deri 1000 m. kundrejt malevet). Nëpër këta male shifen edhe gjurmat e të gërryemvet, që janë shkaktuem prej akullinavet të kohëvet të hershme gjeologjike.

Nga drejtimet e rrjedhjevet, që kanë përrenjt e këtu-





Fyt. 1. - Nga pamjet e Alpeve të Shqipnis.
Bjeshkët e Namuna: natyra shkambore e malit Jezerce
(Gryka e Jezercës)



Fyt. 2. - Nga pamjet e Alpeve të Shqipnis.
Qafa e Shtegut (Qoku i Nënshtegut 1800 m.)

(Foto Riv. *Minerva*)





Fyt. 3. - Kelmendët n'udhëtim tue u zdjergë prej malevet.



Fyt. 4 - Kuji I Praqes (Alpet e Shqipnis së Veriut).



Fyl. 5. - Shqipnija piktoreske : Maja e Radohinës (2500).





KASKATA E RRI
SHKALLË E THETHIT
MUSEUMI E SHKODER

Fyt. 6. - Nji pamje prej Alpevet të Shqipnis Verlake. Lifqeri (Theqafja ose Ujëvara) e Shkallës së Thethit në Shalë. (f. Pici, Shkodër)



shëm, kuptojmë edhe drejtimin që kanë marrë krahët e ndryshëm të këtyne alpeve të gjanë: nëpër anët e veriut të lumit Cem shtrihen malet e Hotit e të Grudës me majën e Vilës (2100 m.) pothue mbi kufinin e kësaj âne.

Ndërmjet Cemit e të Prronit të Thatë shtrihet pllaja e madhënueshme e Malsís së Madhe. Kjo pllajë me naltësi mezetare 1000—1400 m. e me malin e Veleçikut (1700 m.) në mest âsht vend kullotash e stanesh për Kelmendët, i vetmi fis nomad i Shqipnís së Veriut. «Kelmendët dimnit me tufat e bagtivet përpara zdirgjen poshtë edhe dimnojnë nëpër fushat e Zadrimës, në J. të Shkodrës».

Ana jugore e kësaj pllaje thirret Kastrat edhe mb'at' anë të Prronit të Thatë Shkrel.

Pranë burimevet të lumit të Shalës, në V. L. gjindet mali i Radohinës me 2650 m. naltësi edhe mâ poshtë, n'anën e djathtë të këtij lumi, shtrihet *Biga e Gimajt*; si ky ashtu edhe ai i pari janë me pamje shkambore këlqerike tepër të bardhë.

Në jugë afër Drinit, nëpër vendet malsore të Cukalit, rrjeth Kiri mjedis një lugine plot katunde; kjo luginë ndanë Pultin me Postribën.

Mâ nga lindja e luginës së Kirit vjen lugina e Leshnicës e mbas kësaj ajo e Curajit; ndërmjet këtyne dy të fundit shtrihen malet e Kakinjës (mâ se 2000 m.); në veri të këtyne malevet banon fisi i Shalës edhe në jugë fisi i Nikajt.

Lugina e sipërme e Shalës numurohet si vendi mâ i rreptë e mâ i vetmuem i këtyne anëve. Kjo më katër anët rrethohet me male të naltë e vetëm me tri qafa shumë të naltësueme mund të bâjë marrëdhânje me anët e jashtme: qafa e Shtegut 1800 m., qafa e Pejës 1700 m. edhe qafa e Nermajës 1700 m.

Alpet e Shqipnís së Veriut në lindjen e lumit të Curajit tregojnë një pamje të ndryshme. Këta qysh prej këtij lumi e deri te lugina e Valbonës, janë male ase grumbuj malesh të shpërndamun mbi një pllajë (1500 m.) e të përçamun më shumë anë prej lumejvet. Ndër këta Maja e Hekuravet (2600 m.) âsht mâ e nalta.



3. **Grumbulli i malevet Qendrorë.** — Ky grumbull shtrihet, pothue paralel me vargun linduer, prej veriut në jugë qysh prej malevet të Dukagjinit e deri te liqeni i Maliqit me një gjatësi 170 km. edhe me një gjanësi 20-40 km. Këta male shquhen prej të tjerëvet: *a)* me gjanësin e sipërfaqes së tokëvet që mbulojnë; *b)* me shumsin e pllajavet që rrethojnë edhe *c)* me numurin e math të grykavet a të qafavet që përmbajnë mjedis 'tyne.

Malet e Çermenikës, në V. L. t'Elbasanit, do t'i marrim si qendër për vargun e Grumbullit të malevet Qendrorë, mbassi këta në këtë vend ndahen në shumë dega e pjesësisht e humbin drejtimin edhe karakterin varguer të 'tyne tue u-përziem më tepër me vargun perëndimuer ose detik.

Malsija e Çermenikës ndodhet ndërmjet lagjevet të sipërme të Matit e të Shkumbinit; ka shumë lugina të gjana me katunde të shpeshët edhe në shumë pjesa mbulohet me pyjë dushku. Çermenika me anën e grykavet të shumta nga veriu lidhet me dy lugina: me luginën e Matit edhe me atë të Drinit të Zí, e nga ana tjetër, nga juga, nëpërmjet të luginës së Shkumbinit me fushat e Elbasanit edhe me liqenin e Ohrit e me Korçën.

Nji vargmal i gjatë i përshkuem edhe i përçamun fort prej lumit të Matit e kambëvet të majta të 'tij ndahet prej Çermenikës tue u-shtrimun në drejtimin J. L.—V. P. Ky varg që në verí ndërmjet luginës së Matit e të malevet të Krujës, merr emnin Malet e Skanderbeut, shtrihet paralel me vargun detik Dajt—Krue, por më përmbrenda se ky. Në jugë, në drejtimin Martanesh—Shingjergj, zgjanohet më se 20 km., por tue u-zgjatun nga V. P. e humb si gjanësinën ashtu edhe naltësinën e vet deri sa, në vendin ku bashkohet Mati me Gallatën e me Fanin, pritët për një herit e mbaron (mali i Skurajit 1113 m.) për me i lënë rrugë Matit. Këtu pari nga perëndimi afrohet edhe mbarimi i vargut detik të Krujës edhe nga veriu, mb'atë anë luginës së Matit fillojnë me u-naltësuem malet e Mirditës (mali i Veljës 1172 m. te Maja e Bardhë).





*Fot. 6. — Prej Shtegut të Dhenvet (1800 m.)
në Thehtë (750 m.)*




*Fot. 7. — Maja e Hekuravet (2600 m.)
(Foto Rev. Minerva)*






Fyt. 9. - Të pamit e pllajavet të nalta të Tejës edhe të malevet të Korrabit prej Gjalicës së Lumës Kopjue prej fotografis së *H. Louis*.




Fyt. 10. - Gropa e Qafës së Shtegut

(Foto Rev. *Minerva*)






Fyt. 11. - Katundi Klenjë në Gollobordë, së largu duken malet e Çermenikës. Kopjim nga fotografija e *E. Nowack*




Fyt. 12. - Shtëpijat e katundit Unjat në anën perendimore të luginës së Matit; në të majtë duken pjesat e çveshme të shtresave të reja toksore të periudhës së tretë, në të djathtë shifet Mali i Dejës.
Kopjuem prej fotografisë së *E. Nowack*





Fyt. 13. - Karavani n'udhëtim nëpër bjeshkët shkambore afër Pukës.
Kopjue prej fotografisë së *H. Louis*.



Fyt. 14. - Lugina e Fanit afër Rubikut. Kopjue prej fotografisë *H. Louis*.





... ..



... ..





Fig. 17. - Rruga Këlcyrës-Berat
(Fot. Shqipëria e Illustrueme 1927, T. Solenica)



Fyt 18. - Malet e Përmetit

(Fot. Shqipnija e Illustrueme)





Fig. 19. - Rrethines e Libohovës

(Fot. Shqiptarja e Illustrueme)



Naltësija mezzatare e këtij vargu mbërrin 1000—1500 m. Natyra pyjore e këtushme është shumë e pasme; pyjet e dushkut mbulojnë shumicën e faqevet të këtyne maleve, por ka edhe pyje ahu e pishë (pyjet e Martaneshit e të tjerë). Majat më të larta të këtij vargu janë: Shën Naj 1780 m., ndërmjet Shingjergjit e Martaneshit, edhe mali i Debushit 1700 m., afër Gurrës së Madhe. Ky vargmal i lëshon degët e veta më të dy anët në trajtën e kodrinavet.

Në lindje të Çermenikës, mbas kodrinavet të Moknës, vjen malsija e 'saj me malet më të naltë Pishkash, Shebenik ose mal'i Kuq me 2180 m., e mbas këtij, më në kufi, vjen Jablanica ose Belica në trajtën e një vargu.

Më në fund, përmbi Martaneshin vjen mali i Lopës. Ndërmjet këtij edhe Shebenikut, shtrihet Golloborda e rrethueme edhe vende-vende e mbulueme me male këlqerik të çveshun ose rrallë të veshun me ahishta edhe e naltësue me mezzatarisht përmbi 1000 m.

Mali i Lopës, tue u-shtrimun nga veriu, pjek me malin e Allamanit e përtej qafës së Murës me malin e Dejës 2250 m., me Neshtën e Lurës 2100 m. e më në fund me Zepën 1980 m. Këtu po kjo natyrë vargu, tue i lanë një shteg të ngushtë Drinit të Zi (kanonet e Gjabrecit 600 m. fellë), vijon në të zgjatun edhe bashkohet me malet e Lumës.

Në veri të Zepës këta male e ndërrojnë si drejtimin ashtu edhe natyrën e tyre vargore tue u-shtrimun m'atë anë të Fanit të Vogël në Mirditë në trajtën e malevet të ulëta, të veçaveçta e të përhapta. Këtu vijnë për t'u-përmendun malet e Munellës (afër 2000 m.), mali i Roshit, Kunora e Dardhës (në Pukë nën Iballjën), të cilët duken sikur vijnë me një drejtim; por bjeshka e Kushnenit, e Tërbunit (në jugë të Pukës) edhe Krabi (në veri të Pukës), si edhe mali i Ronës në lindje janë male të veçuem krejt.

Gjithë këta male të Mirditës, të Pukës e të Dukagjinit, me shumicë janë të veshun me pyje dushku, ahu e pishë.



Malet e Moknës (Shebeniku, Belica), tue u shtrimun nga lindja nepër Qafë-Thanë, pjekin me liqenin e Ohrit, në të cilin e shtrijnë siujdhesën shkambore e këlqerike të Linit, mbasandaj me emnin Malet e Mokrës, paralel me liqenin e Ohrit, shkojnë drejt luginës së Devollit (malet e Kamjes, të Llangës, burime të Shkumbinit) nga juga, pranë liqenit të Maliqit.

Pjesa perëndimore e këtij vargu nga ana e jugës vijon qysh prej Çermenike deri në ulësinat e Kolonjës. Malet e Çermenikës, tue i liruem rrugë Shkumbinit nga juga edhe nga jugë-perëndimi, pjekin me malet e Polisit e të Shpatit, të cilët së pari në ballë t'Elbasanit shkojnë si veçmas, por ata të fundit më tutje e ndërrojnë drejtimin e 'tyne si më nga lindja edhe kështu bashkohen me të parët tue trajtuem një varg të veçantë i cili, më të gjitha anët i mbuluem me pyje dushku (rrallë me të ahut e të pishës), në ballë të Grabovës, te Guri i Topit, merr naltësin 2379 m.

Ky varg, në jugë të Grabovës e të Shënapremtes bashkohet me malet e Suhagorës 1870 m., të Koshnicës 1740 m. edhe të Moglicës 2020 m. Dy të parët ndahen ndërmjet 'tyne prej Devollit.

Mbas këtyne malevet ky varg merr trajtën e një pllaje të naltë (me naltësi mezatare 1500 m.), e cila, tue u-përçamë me përrenj e tue u-përshkuem me kodrina të panumurta (të gjitha me natyrë pyjore), bashkohet me malin e Ostrovicës (2360 m.) e me Majën e Lugut e kështu mbërrin me rrethuem pllajën e Voskopojës, në perëndim të fushës së bukur të Korçës. Rreth kësaj pllaje takohet ky varg me kodrinat e Mokrës, të cilat, si pamë edhe më nalt, varen me këtë drejtim.

Vargu i grumbullit qendruer, tue u-shtrimun edhe në jugë të pllajës së Voskopojës me një sistem kodrinash pllajore, vjen e rrethon ulësinën e Kolonjës (1200--1400 m.). Në të zgjatuem në këtë drejtim, në qafën e Qarrit 1123 m. bashkohët ky me krahët e malevet të Moravës edhe më poshtë me ata të Gramosit.



Pranë ulësinës së Kolonjës pra merr fund grumbulli i malevet Qendrorë.

4. Vargmalet detikë ose perëndimorë.— Disa vargje kodrinash e malesh shkamborë, të ngushtë, jo aqë të naltë, me natyrë krejt këlqerike, na e përshkojnë Shqipërinë t' onë të Lirë paralel me brigjet e detit Adriatik. Këta vargje, s' janë tjetër veçse vijimi i vargjevet detikë t' Alpevet të Dinarit, të cilët shtrihen mâ në veri, në Dalmatí, pranë detit. Ky sistem vargu pra na vjen prej veri-perëndimit, nëpër Malin e Zi edhe së pari fillon me u-shtrimun afër detit, në brigjet veriake të gjinit të Drinit: Mali i Rencit, i Barballushit, i Kakariqit edhe i Amullit me 550 m. naltësi. Këta male i naltësojnë fushat e ulta të Bregut të Bunës edhe ato të Zadrimës, që shtrihen në jugë të Shkodrës edhe e shtyejnë Drinin që të zdirgjet mâ nga juga e të derdhet atje larg në det, rëposh Leshit. Këta male rrethojnë ndërmjet 'tyne kënetën e Kakariqit.

Ky varg merr një drejtim nga jugë-lindja e, tue u-gërryem prej Drinit, afër Leshit, vijon në të zgjatun edhe te gryka e Kolshit bashkohet me kodrinat e zgjatueme të malit të Veljës (Maja e Bardhë 1170 m.), i cili shtrihet mâ përmbrenda nga lindja tue ndamë Malsin e Leshit prej Mirdite.

Sistemi varguer në fjalë, sa mâ shumë të shtrihet nga jugë-lindja, aqë mâ shumë i largohet detit e mâ në fund, tue u-gjindun gjithënji në lindjën e rrugës Tiranë-Shkodër, pranë Milotit, në jugë të Bulgërit, përçahet prej Matjes. Në jugë të Matjes fillojnë të shtrihen po me drejtimin V. P.—J. L. vargu i Skanderbeut edhe vargu Krue—Dajt. Fort të madhnueshme janë pamjet e këtyne dyve të fundit. Këta me natyrë shkambore këlqerike shtrihen në lindje të Krujës e të Tiranës porsí murnajë; faqet e 'tyne të këthyeme nga deti në pjesat e ulta vishen me dushkaja. Naltësija mezatare e këtij vargu është 1000—1200 m. (Dajti 1612 m.).



Ky varg përçahet në gryka a në qafa të kalueshme, me anë të përrenjvet, që vijnë prej lindjes (si lumi i Zezës, Zall'i Herrit edhe Lumi i Tiranës) për me formuem nga perëndimi lumin e Ishmit. Malet e Krujës e sidomos Dajti nëpër faqet e 'tyne të këthyeme nga deti përmbajnë pllajza fushore të naltësueme njana mbi tjetrën në trajta të shtresavet (terasevet), nëpër të cilat lulëzojnë livadhet në blerim me burime ujnash të ftofët si akulli.

Mali i Dajtit, tue u-shtrimun qysh prej qafës së Tujanit (228 m.) me një gjatësi afër 11 kilometrash, vjen te shkalla e Priskës (941 m.), ku bashkohet me malet e Shingjergjit, të Shën Mëris e të Shën Gjinit (Mali me Gropa).


Mâ poshtë, nga juga, vendi është i gërryem prej Arzenit (prej ku vjen?); por si të kalohet kjo luginë, fillojnë me u-naltësue me malet e Krrabës (1000 m.), të cilat tue u-shtrimun nga juga, mbarojnë në luginën e Shkumbinit pranë Elbasanit.

Malet e Krrabës, tue i përhapun degët e 'tyne në trajtën e kodrinavet të grumbullueme, në të djathtë të Shkumbinit të poshtëm formojnë malsinat e Peqinit. Po kjo natyrë grumbuj kodrinash vijon si në të majtë të Shkumbinit (malet e Dumres me pllajën plot liqenj të Belshit) ashtu edhe në të dy anët e Devollit deri në Berat.

Në jugë e në perëndim të Beratit shtrihen malet e Mallakastrës. Këta qysh prej perëndimit të Beratit deri në gjanësinën e Vlonës formojnë një krahinë shumë të gjatë kodrinash ndërmjet Osunit (lumi i Beratit) e të Vijosës. Ky sistem kodrinash në të shtrimit e vet merr një drejtim nga jugë-lindja tue u-përçamun më katër anët me përrenj, që derdhën në të dy lujt e naltpërmendun.

Kësaj krahine i mungojnë malet e nalta; i vetmi mal është ai i Shpirakës (Mali me Vija 1203 m.).

• Kodrinat e Mallakastrës, sidomos ato të perëndimit, janë të mbulueme me ullishta të denduna e të mira. Kjo krahinë qysh në kohat e moçme ka pasun qytete të lulëzueme si Pojanin, Byllisin edhe Plloçën (Amantia) etj... •





Fyt. 20. - Pllaja e Kolonjës (1100 m.) Kopjue prej fotografis së H. Louis



Fyt. 21. - Të dukunit e pllajevet të Mashkullorit edhe të malevet Ostravica prej Majës së Lugut. Kopjim nga fotografija e E. Nowack





Fyl. 22. - Vargmalet e Shqipnis J. P.; Të pamit e Malit të Gjerë edhe të Majës së Luçës prej naltësivet të Lunxheris. Kop. prej *E. Nowack*



Fyl. 23. — Drimadha, një katund në Rivierën Shqiptare. Largas malet Çika. Kopjue prej *E. Nowack*







Fig. 24. - Nji veshtrim prej urës së Osumit drejt nga perëndimi.
Largas shifet mali i Shpirakës (Mali me Vija 1203 m)



Fyt. 25. - Të pamit e Drinit prej Rozafatit. Largas duken malet
detikë t' Adriatikut.



Fyt. 26. - Fushat e Tiranës edhe të zgjatuemit e vargut të Krujës.
Kopjuem prej fotografis së *E. Novack*



Vargu i Mallakastrës, tue u-shtrimun nga juga, merr fund në ballë të Tepelenës me fushën e Luftinjës.

Prej këtij vargu detik ose perëndimuer, për degat e ndryshme të të cilit folëm deri tash, shkëputen nga perëndimi kodrina të bukura të veshuna me druna e me bimë të natyrës së makjevet (bime ferrash e blerimesh mesdheake). Këto kodrina në shumë vende shtrihen deri pranë detit: kodrinat e bukura të Prezës, të Shijakut, të Kavajës, të Durrësit, të Rodonit, t' Ardenicës etj. . . .

Shënim. — Vargu detik ase perëndimuer, cakton plotësisht kufinin e Shqipnís s' Ulët Detike e të Shqipnís së Naltë të Mbrendëshme.

5. Vargmalet jugore të Shqipnís së Naltë jugore.— Shqipnija Jugore naltësohet me male e me vargmale të shumta, që në të shtrimin e 'tyne nuk ndjekin një drejtim të njëjshëm. Për me i kuptuem mirë këta po nevojitem me i ndamë në disa pjesa si pas krahinavet ku shtrihen:

a) Malsija ndërmjet Leskovikut e të Beratit. — Gjithë kjo malsí, që ndodhet në lindje të Vijosës së sipërme, ka një natyrë shtresore (plloçore); përçahet me shumë anë prej përrenjvet të Vijosës me një anë e të Osumit m' anë tjetër. Kjo malsí shtrihet me drejtimin V. P.—J. L tue u-naltësuem në disa vende 1200-1500 m., si me thanë: Qarrishta (1256 m.), mal' i Krashovës (1400 m.), Kokojka (1555 m.), vargu i Postenanit, që më shumë vende përçahet prej kambëvet të Vijosës (1559 m.) edhe Melesini (1420 m.) afër Leskovikut.

Hyjnë me këte grumbull edhe këta male: mali Bodarit (900 m.) në verí të Përmetit edhe mali i Çarshovës (1100 m.) má në jugë pranë Vijosës.

Gjithë malsinat, që ndodhen në lindjën e Beratit si Glumaka me Tomorin, hyjnë edhe këto me këte grup. Këta male me natyrë shkambore këlqerike naltësohen përmbi 2000 m. (maja má e naltë Tomorica 2480 m.) edhe vishen me një brez pyjuer, që i vesh në një naltësi 1800-1900 m.



Malet e Tomorit, në ballë të Beratit, nga lindja, naltësohen si të vëçuem (2480 m.) me një madhështi e bukuri të pamasë.

b) **Vargu Trebeshinj — Dhëmbel - Nemërçkë.** — Këta vargje shtrihen po në drejtimin e të parëvet në perëndim të luginës së sipërme të Vijosës edhe formojnë një vargëzim malesh me gjatësi 60 km.

Trebëshinja (1920 m.), fillon qysh prej qafës së Kiqokut (700 m.) e mbaron në Vijosë te gryka e Këlcyrës. Mb'atë anë kësaj gryke, nga juga, vijoje në të zgjatun një mbas tjetrit vargu i Dhëmbelit (1200-2000 m.) edhe vargu i Nemërçkës. Ky i fundit, qysh prej majës së Papingut (2495 m.) e deri mb'at'anë majës së Tumbës (2220 m.) shtrihet pors një murnajë edhe vetëm një pjesë të vogël e ka mb'at'anë kufinit, në Greqi.

Gryka e Këlcyrës, një grykë e fellë, e preme prej Vijosës, zgjatet prej Këlcyrës deri afër Tepelenës më se 10 km., me pamje tepër madhështore.

Gjithë ky varg ka një natyrë shkambore këlqerike edhe është i pasun me kullota.

c) **Vargu Shëndëlli — Lunxhëri - Bureto.** — Ky varg shtrihet në perëndim të luginës Zagori-Pogon edhe ka po një natyrë gjeografike me vargun e dytë.

Në veri, pjek me vargun e kodrinavet të Mallakas-trës pranë katundit të Mariçanit, ku fillon me u-naltësue edhe quhet Shëndëlli (1810 m.). Kjo pjesë bjeshke, tue u-shtrimun nga juga, përçahet prej Vijosës (Grykë e Këlcyrës) edhe tue u-shtrimun me drejtimin J. L. mb'anë tjetër të Vijosës, formon malet: Lekli (1730 m.), Strakaveci (1960 m.), mali i Lunxheris (2160 m.); por mbas këtij mali me një herë përçahet prej lumit të Suhës (kamba e djathtë e Drinit). Tue vijuem ky të shtrimit e vet edhe në jugë të këtij lumi e merr emnin Bureto (1800 m.) në lindjen e Libohovës.

Edhe mali i Makrikambo (1877 m.), që ndodhet më në kufinin t'onë me Greqinë, i përket këtij vargu.



c) **Vargu i Gjerë - Shtugara.** — Ky varg shtrihet në perëndim të luginës Drin-Kseria (Dropulli); naltësohet ngadalas nga perëndimi (1200 - 1800 m.) me emnin mali i Gjerë, i cili, tue filluem në veri-perëndim të Gjinokastrës, zgjatet teposhtë në J. L. edhe ngrihet me majat Muzinë - Platevun (1160 m.), me malin e Kraës (1225 m.) të Polcës (1435 m.), të Shtugarës (1800 m.) edhe futet mbrenda në kufinin e Greqís tue u-shtrimun atje deri në Çamërin e Robënueme. Dy qytete ndodhen në rranzët të këtij vargu: Gjinokastra në veri-lindje edhe Delvina në perëndim; edhe katunde të panumurt i vargohen për bukurí nëpër të dy anët.

d) **Malet Griba - Kurvelesh.** — Në veri të lumit të Kardhiqit fillon me u-naltësuem një krahinë plot me male. Këta male, tue u-zgjatun nga veriu, rrethojnë një pllajë të naltë (1500 m.). Kjo pllajë pra, e cila shtrihet prej J. L. në V. P. deri te maja e Kulthit (1911 m.), quhet Kurvelesh i Sipërmë. Pllaja në fjalë përhapet nga veriu ndërmjet Shushicës edhe Vijosës e atje e shton naltësin e 'saj me malet: Tershnicë (1625 m.), malet e Gribës (Qendrevica 2130 m.).

(Kjo pllajë me të dy rranzët e veta pranë luginavet të Vijosës e të Shushicës jep shenja të pasunívet të mëdha minerale si vojguri, naft etj. . . (Selenica, pranë Vijosës, në veri).

dh) **Malet detikë të Delvinës.** — Lugina e ngushtë por e bukur e Delvinës nga ana e perëndimit naltësohet me një bres malesh. Ky bres malsuer shtrihet paralel me brigjet e Jonit. Këta male nuk janë aqë të naltë; por kodrinat e buta e të panumurta, të cilat i shpërndajnë deri afër detit, i kanë me rëndësi të posaçme.

Ky sistem malesh fillon në Jugë të Delvinës me malin e Kostarit (550 m.) edhe, tue u-shtrimun nga jugë-lindja, me malet e Koqino-Lithariut (930 m.), të Kazanja-Koritjes (1315 m.) edhe të Shëndenit (1700 m.), vjen tue shtuem naltësin. Në shumë vende ky përçahet si prej lumit të Pavlës ashtu edhe prej kambës së 'tij Lesnicës.



Në pjesën më jugore të këtij sistemi, rëposh Pavla-s shtrihen malet Mles (1040 m.) edhe fare në jugë, pranë Konispolit, paralel me detin shtrihet vargu detik Saraqin-Mile, i cili ndahet dysh prej Pavla-s. Ky varg i fundëshëm shtyhet në veri deri te lugina e Vurgut, që ndodhet në shpindë të Sarandës, nga lindja, e që përshkohet prej Kalasës, lum'i Butrintit. (Gërmadhat ë Butrintit në brigjet jugorë të liqenit.)


e) **Malsija e Labëris së sipërme.** — N'anë të veriut të Sarandës, në perëndim të lumit të Kalasës, malet Levan (965 m.), Konjak edhe Galisht (1500 m.), trajtojnë një vargmal, i cili s'ka asnjë lidhje me luginën e Delvinës. Ky varg shtrihet me drejtimin V. P. — J. L. ose më tepër V. — J. edhe me rrëzën perendimore varet përmbi detin e Jonís, ku formon brigjet shkambore.

Ky varg tue kapërcyem në perëndim të Shushicës, në ballë të Kurveleshit, vijon me malet Çika (2050 m.), të cilët në majën e Shtogut (1870 m.) bashkohen me malet e Lungara-s e këta, tue e humbun dalë nga dalë naltësín e 'tyne në trajtën e kodrinavet të bukura e me emnin malet e Shashicës, mbërrijnë në Kaninë, në jugë të Vlonës, edhe mbarojnë afër kësaj të fundit.

Malet e Çikës i shtrijnë degat e 'tyne deri në gjinin e Dukatit, tue u-përçamun prej lumit me këte emën, që derdhet po në këte gjí. Në perëndim të këtij lumi shtrihet vargu detik: Rëza e Kanallit (Keravnia 1600 m.), i cili nga veriu, mbas pllajës së Ravenës, pjek me malet e Karaburunit edhe shkon deri te sqepi i Gjuhëzës (= Linguetta it. = Glossa gr.). Këto vargje mbarojnë nga deti me brigje shkambore, nëpër të cilët është tepër veshtirë marrëdhënja me detin.

Në mbarimin Jugor të malevet Keravnia vjen shkalla e Llogaras (1055 m.) vend i veshun me pyje pishore dhe i shquem me klimë të shëndoshë.

Në jugë të Llogaras, ndërmjet detit e malevet të Çikës, shtrihet Himara, një krahinë malësore, por e lulëzue me një hijeshí të veçantë, me brigje shkambore të






Fig. 3. - Sistema e malevet të Shqipnis.



përthymë, me pamje të bukura e me pasje bimore të veçanta. Ky vend, me të vërtetë meriton të quhet Riviera e Shqipërisë.

II. FUSHAT EDHE LUGINAT

Gjithë malet, vargmalet edhe pllajtat, që i pamë deri tash, shtrihen në Shqipëri e Mbrendëshme, të cilën mund ta quajmë edhe Shqipëria e Naltë. Vargjet Detike e rrethojnë këte pjesë të Shqipërisë. Në perëndimin e këtyne vargjevet shtrihet Shqipëria e Ulët, e cila në të shumtën e anëvet mbulohet me fusha të gjana, lymike e shumë pjellore.


A. Fushat e Shqipërisë s'Ulët. — Shqipëria e Ulët ose Detike përmban këto fusha:

1. *Fushat rreth Shkodrës: në veri fushat e Shtojit (ose të Podgoricës) edhe në jugë: fushat e Zadrimesë;*
2. *Fushat ndërmjet Leshit, Tiranës edhe Durrësit;*
3. *Fushat e Elbasanit;*
4. *Fushat e gjana të Myzeqes.*

1. **Fushat rreth Shkodrës.** — N' anë të veriut të Shkodrës, në bregun lindur të liqenit me këte emën, shtrihet fusha e Shtojit, e cila zgjatet pothuë deri në Kastrat, 20 km. e gjatë edhe 5-8 km. e gjanë. Kjo fushë gjeografisht s'është tjetër veç se pjesa e zgjatueme e fushës së Podgoricës (në Malin e Zi) në veri. Vraka, Kopliku i poshtëm, Bujzaujt përbajnë pjesat më kryesore të kësaj fushe.

Fusha e Shtojit nga lindja rrethohet me Alpet e Shqipërisë së Veriut, të cilët këtu fillojnë me u-naltësuem. Përrenjt e shumtë në këte anë i gërrijnë këto alpe edhe e lymnosin këte fushë të bukur.

Në jugë të Shkodrës po ajo natyrë fushore vijon në të zgjatunit e saj. Fusha e Zadrimesë shtrihet në anë të majtë të Drinit, qysh prej Vaut të Dejës (= vendi ku nda-



het Drinassa prej Drinit) e deri në Lesh tue pasë një gjatësi prej 25 km. edhe një gjatësi 5-10 km.

Kjo fushë tue u-shtrimun edhe ndërmjet Drinit e të Bunës, merr emnin fusha e Bregut të Bunës, e cila nga juga rrethohet me vargjet e ulta detike, Barbullush, Renç etj. edhe me kënetën e Kakariqit.

Si fusha e Zadrimes ashtu edhe ajo e Bregut të Bunës në kohën e vërshimit të Drinit e të Bunës mbesin në shumë pjesa të mbulueme me ujna.

Fusha e Zadrimes e rrethueme nga lindja me vargjet e me kodrinat detike të Mirditës, tue u-shtrimun nga jugë-perëndimi, afër Leshit e malsis së këtij, ngushtohet fare.

(Liqeni i Shkodrës. — Ky liqen, me një sipërfaqe prej 355 km². është më i madhi liqen i gadishullit Ballkan. Faqja i gjindet vetëm 13 m. mbi det. Zgjatet prej veri-perëndimit në jugë-lindje 45 km. edhe në qendër zgjanohet 10-14 km. Nga shkaku i lymnavet të sjellun me shumicë prej përrenjvet, ky liqen nuk është aqë i fellë, në verë vetëm 7 m.; por në dimën nga ngushtica e shtratit të Bunës, i vetmi lum që e lidhë këtë me Adriatikon, ujnati shtohen edhe kështu kur ndodhë, nga një herë, një e naltësue me tillë deri tre metrash, shkaktohet vërshimi i liqenit mbi brigjet e veta e mbi pazarin e Shkodrës.

Ky liqen është i pasun me sasin e me farët e peshqëvet dhe të njalavet. Si peshqit (disa farë) si edhe njalati si mbas stinëvet të mbara për 'to, enden prej detit në liqen edhe prej liqenit në det.

Farët e peshqëvet, që gjinden në këtë liqen si edhe në Bunë, e cila e lidhë liqenin me detin, janë këto: qefulli, krapit, njala, gjuhca, levreku, trofta (më i shijueshmi), nila, lloska, kubla, lloça, blini, mlysha, ushunja etj.

Vezët e qefullit si edhe të blinit gatiten edhe bahun putarka (havjar).

Peshkataria e këtij liqeni i sjell Shtetit një fitim prej më se 100.000 fr. ar në një vit).




2. **Fushat ndërmjet Leshit, Tiranës edhe Durrësit.**— Në jugë të Leshit fillon me u-shtrimun një fushë, e cila deri afër gjânësinës së Krujës, pranë Ishmit, është e mbuluar me pyje të shpëshët fushore (pyjet e Mamurashit). Kjo fushë, afër 30 km. e gjatë edhe 8 km. e gjënë e quejme me emnat fusha e Leshit, e Bregut të Matit, e Gurëzës edhe e Suzës, është vepra e tre lumejvet: Drin, Mat edhe Ishëm, të cilët me gojnat e tyre vetëm nga 10 km. larg shoqi-shoqit kanë formuar këtu një delta pothuë të përbaskët. Kjo delta (= bigë) pra është vendi i kësaj fushe me natyrë krejt lymike edhe mbulohet me pyje pishe detike, dushku, qarri, shkoze e gumushavet tjera.

Kjo fushë qysh prej Leshit e deri te ujt e Matjes (= Matit) nga lindja rrethohet me kodrinat detike të Malës së Leshit e të Mirditës (Bulgëri) edhe në jugë të lumit të Matit, rëposhë Milotit, në Laç, fillon të rrethohet, po me këte anë, me vargun detik të Krujës; por nga perëndimi, mbi deltan e përmendun, afër detit mbulohet me moçale. (klime e Leshit?)

Në ballë të Krujës, afër Dervenit, mb' atë vend ku lumi i Tiranës me atë të Zezës bashkohen edhe formojnë Ishmin, fusha e përçame me këta lumej fillon m' u-quejtun **Fushë e Krujës**, e cila, tue u-shtrimun edhe në anën e majtë të lumit të Tiranës, mbërrin deri në rânzën e kodrinave vargore të Prezës (mali i Kërçokës 324 m.).

Fusha e Krujës, e përshkueme nga lindja me kodrina të buta e të veshme, shtrihet deri në Vorë. (Vereni mbi hartë drejtimin e rrugës Tiranë-Shkodër, Tiranë-Durrës!). Në këte vend një fushë tjetër fillon m' u-zgjanuem e me u dredhun mâ nga J. L. tue qenë gjithnji e rrethueme nga lindja me vargun e Krujës e të Dajtit e nga perëndimi me kodrinat vargore të Kasharit etj, ... Kjo shtyhet deri në kodrinat jugore të Tiranës, kryeqytetit t'onë të bukur, edhe quhet **Fusha e Tiranës**.

Fusha e Tiranës, ajo fushë e bukur, madhështin e merr jo vetëm prej natyrës së gratëshme të tokëvet të



'saj, por mâ tepër prej kodrinavet të hijeshme, që i shpërndahen aty këtu në të dy anët e sidomos prej vargjevet të kaltërtë të blertë të Krujës e të Dajtit.

Kjo fushë, mbassi i mungon humusi, në pjesat e poshtme të kores lumike të kuqe e pjellore, për t'i a mbajtur vlagën e nevojshme, âsht e thatë në verë; por, tue u-njomun me anë të remavet e vijavet të marruna prej lumit të Tiranës, që e përshkon mjedis, jep prodhime të shumta bujqësore. Gjatësija e sistemit fushuer që shtrihet ndërmjet Leshit e Tiranës âsht mâ se 50 km.

« Kodrinat detike vargore të Prezës (Mali i Kërçokut) shtrihen qysh prej luginës s' Erzënit me drejtimin J. L. — V. P., paralel me vargun Dajt — Krujë. Këto me këte drejtim shtyhen nga deti, ku formojnë siujdhesën e Muzhllit (mali i Muzhllit 205 m. = Muzhlli i Skanderbeut), e cila merr fund me sqepin e Rodonit, që asht skanji jugor i gjinit të Drinit ».

Tue kaluem këte varg, në drejtimin e rrugës Tiranë — Durrës, nëpër një grykë fort të bukur (Pigëz), nga perëndimi, shifet fusha e Shijakut, e cila, e përshkrueme me Arzenin, zgjatet nga V. P. deri në det (gjini Lalzë).

Në perëndim t' Arzenit, për mb' at' anë disa kodrinavet, shtrihet **Fusha e Durrësit**, e cila shtyhet në det me disa kodrina shkambore (= mali i Durrësit 188 m.). Në faqen jugore të këtij mali ndodhet qyteti i Durrësit edhe mbi këtë, nalt në kodër, ngriket me hijeshi e madhështif pallati i Mbretit t' onë.

Ky mal, në verë mbaron me sqepin e Palit (88 m.) (= Bishti i Pallës).

Fusha e Durrësit pothue gjithë anën perëndimore e ka të mbulueme me moçale e me një kënetë të madhe (= Këneta e Durrësit) që përmbajnë ligatina edhe miskonja malarike. Dobësija klimatike e Durrësit shkaktohet prej këtyneve.

3. **Fushat e Elbasanit.** — Në jugë-perëndimin e Elbasanit, fillon me u-shtrimun një fushë shumë e bukur



qysh prej qytetit e deri në rânzë të pllajës së Belshit me një gjatësi 18-20 km. e me një gjânësi 5.8 km.

Shkumbini e zgjanon luginën e vet, porsa të vijë në jugë t' Elbasanit, edhe e përshkon këte fushë deri afër Shelkut, ku e shmangë drejtimin e vet tue u-futun nëpër grykat e ngushta të Paprit, përmes kodrinavet me këtë emën, që janë degët e Krrabës.

Lugina e Shkumbinit në këte vend i qaset fort luginës së Devollit tue pasë një largim vetëm 7 km. Shtrati i Devollit në këte drejtim është vetëm 5-10 m. më i naltë se ai i Shkumbinit, i cili në kohnat e moçme pa dyshim do të ketë pasë një drejtim nga J. P. tue pasun Devollin si kambën e 'tij. Kjo provohet edhe me moshën e re gjeologjike të shtratit të ri, që ka çelun Shkumbini në Papër e tutje për me dalun nëpër Peqin (Claudiana e moçme), në fushat e Kavajës ose më mirë me thënë në Myzeqen e Veriut.


Fusha e Elbasanit, e rrethueme nga lindja e nga veriu me kodrinat e vargut të Krrabës edhe nga juga me ato të malevet të Shpatit, quhet Fusha Mbret, pranë Elbasanit, edhe fusha e Bozhokut ose e Dumrés si edhe e Belikut, më nga jugë-perëndimi.

4. Fushat e gjâna të Myzeqes. — Në pjesën jugore të Shqipnis Detike, ndërmjet luginavet Shkumbin—Devoll, shtrihen fushat e gjâna të Myzeqes ose më mirë me thanë Myzeqeja.

Këto fusha janë aqë të gjâna, sa që po të vështrohen prej mezit të 'tyne, majat e kodrinavet t' ulta si ato t' Ardenicës etj., që i ndodhen përqark, shumë herë nuk mund të shifen, pse mëshifen ndën një orizont të gjânë.

Myzeqeja në drejtimin e Semanit prej lindjes në perëndim zgjanohet (40 km.) më tepër edhe, tue u-shtyem nga veriu, vjen gjithnji tue u-ngushtuem deri sa pranë Kavajës me gjanësi vetëm 8-10 km. pjek me detin.

Në gojë të popullit zakonisht, Myzeqe thirren vetëm fushat e ulta pranë Semanit; mirpo gjeografisht ky emën duhet t'i përmbledhi të gjitha fushat, që shtrihen qysh



prej Semanit deri në det, për mb'atë anë të Shkumbinit e të Kavajës, mbassi këto kanë po një natyrë gjeologjike edhe bujqësore. Jo vetëm këto, por edhe Kënetat e Durrësit me rrethinat e veta fushore, n'anën e veriut të gjinit të Durrësit ka një natyrë të përbashkët me Myzeqen.

Myzeqeja e shtrëme prej V. V. P. në J. J. L. me një gjatësi më se 60 kilometrash, në shumicën e anëve të përdimit rrethohet me një varg kodrinash me natyrë pyjore (pyjet e Divjakës etj.). Me të dy anët e këtij vargu shtrihen moçallet edhe kënetat e gjana të Karavastas, të Tërbufit, të cilat me anofelet që përmbajnë, e prishin klimën e këtyne visevet.

Myzeqeja sot në një gjindje të mjerueshme me të thamit e kënetavet e të moçalevet edhe me sistematizimin e kanalevet njomëse, nesër mund të bëhet vendi më i lumnueshëm, grunarja e gjithë Shqipnis, e kështu mund t'i përtrihet fama e dikurshme, e cila famë veç faktevet tjera historike, tash mbas zbulimevet të reja po i provohet edhe me shkëlqimin e atëhershëm të Pojanit, asaj porte më kryesore të kohës së vjetër, nëpër të cilën rrithshin pasjet pa masë bujqësore të kësaj treve fushore.

B. Fushat edhe luginat e lagjës së Vijosës ose të Shqipnis së Naltë Jugore. — Lagjeja e gjënë e Vijosës përmban shumë luginat e fusha të ngushta, të cilat shtrihen pothuë paralel njana me tjetrën, përshkohen me ujnat e ndryshëm të lagjës së Vijosës edhe ndahen ndërmjet me nga një varg të kësaj ane.

Këto luginat e fusha janë:

1. **Lugina e Vijosës së sipërme.** — Kjo luginë, vendi rrjedhjes së Vijosës së sipërme, ndodhet në J. P. të malsis, që shtrihet ndërmjet Leskovikut e Beratit.

Vijosa e përshkon këtë luginë, me ujna të fuqishme që sjell nga Pindët (afër Përmetit në kohë vere 50 cb. m./sek.) e me lymna të pa masë e lymnos në të gjitha anët. Qysh



prej kufinit deri në pikën ku bashkohet me Çarshovën (kamba e saj) edhe qysh prej Përmetit (fusha e Përmetit) e deri pranë Këlcyrës lugina merr një zgjanim në trajtën e fushavet lymike.

«Katundet këtu, si edhe nëpër luginat e tjera të kësaj ane të Shqipërisë, nuk janë ndërtuëm në rrafshinat e luginës por nëpër rânzët e dy vargjevet që e rrethojnë këtë (vereni vendet e katundevet mbi hartë).

Përmeti edhe Këlcyra janë si qendra më të para për pazaret e këtyne katundevet».


2. Zagorija edhe Pogoni. — Krahinat luginore, Zagori — Ppgon, shtrihen paralel me luginën e Vijosës së sipërme, në J. P. të vargut Dhembel — Nemërçka. Nga këto ajo e Zagoris zgjatet edhe pirret nga V. P. qysh prej drejtimit të qafës së Dhembelit deri në grykën e Këlcyrës tue u-përshkuem me një përroi (i Dhembelit) të fuqishëm, që varet prej qafës së përmendun.

Kjo luginë pjellore, përgjithësisht e gjënë, kur vjen afër katundit Maleshovë, ku përroi e përçanë malin me këte emën, fillon me u-ngushtuëm e me u-bâmë një grykë.

Lugina e Ppgonit s'është tjetër veç pjesës së zgjatue të Zagoris nga J. L. e Nemërçkës. Përroi i Çatishtit me atë të Sopikut e përshkojnë këtë luginë prej jugë në veri e, tue u-bashkuem, formojnë lmin e Suhës i cili në ballë të Poliçanit formon një bryl edhe këthen nga J. P. nëpër gryka të ngushta (gryka e Selekës).

Gjithë katundet, që vargohen në të dy anët e këtyne dy krahinave luginore, kanë mbetun si të vetmuem, mbassi u mungon një qendër e madhe (Voshtina në Greq). Populli i këtushëm për marrëdhanjet e nevojshme detyrohet me përshkuem qafa a shkallë 1400 metrash të nalta për me mujtun me zbritun në tregun e Gjinokastrës, mb'atë anë tjetër të Lunxheris.

3. Lugina e Dropullit. — Lugina e Dropullit ose e Drinit (= Drino) shtrihet me drejtimin J. L. — V. P., qysh prej lagjës së përroit Kseria në kufinin e Greqis e





Fyt. 27. - Të pamit e Kalas së Shkodrës prej Taraboshit.
Në pjesën e përparshme duket të dalunit e Bunës prej Iqenit.
Largas shifen fushat e Shkodrës me Drinin edhe bjeshkët.





Fyt. 28. - Fusha pjellore e Tiranës e mbulueme me b me moçalike të farës së Makjevet, pranë lumit të Tiranës.




Fyt. 29 - Pamja e Bregut të Lumit (lumi i Tiranës). Largas vargu Krue-Dajt.






Fig. 30. - Pyjet virgjinë të Divjakës.
Lisat madhështorë të dushkut të mbështjellun me ngjitëset
ujtave të moçallit apin pamjen e pyjevet tropikale






Fot. 31. - Drini afër Kuksit

Fot. Dr. F. Markgraf



Fyt. 31. bis - Ura e Drinit afër Ymishtit

Fot. Dr. F. Markgraf






Fig. 32 - Vijosa në Përmet.
Vargu Dhëmbel në perëndim të Përmetit



Fig. 33. - Gjinokastra e ngrëfme mbi shpatullinat e malit Gjerë
e sundon gjithë fushen e Dropullit





Fig. 34. - Natyra e brigjevet detike të Jonis.
Gjinthi i Sarandës edhe kodrinat që rrethojnë Sarandën nga lindja

(Fot. Shqipëria e Illustrueme)



Fig. 35. - Vendi gjeografik i Delvinës

(Fot. Shqipëria e Illustrueme)






Fig. 36. - Kodrinat e Vlonës nga perëndimi.

Largas mali i Kaninës

(Fot. Shqipëria e Illustrueme)





Fyt 32 - Vijosa në Përmet.
Vargu Dhëmbel në perëndim të Përmetit



Fyt. 35. - Gjinokastra e ngrëfme mbi shpatullinat e malit Gjere
e sundon gjithë fushen e Dropullit





Fig. 34. - Natyra e brigjevet detike te Jonis.
Gjinthi i Sarandes edhe kodrinat qe rrethojne Saranden nga lindja

(Fot. Shqipnja e Illustrueme)



Fig. 35. - Vendi gjeografik i Delvinës

(Fot. Shqipnija e Illustrueme)



Fig. 36 - Kodinat e Vlonës nga perëndimi.
Largues mali i Kaninës

(Fot. Shqipëria e Illustrueme)

deri afër Palokastrës, në vendin ku bashkohet Lumi Kar-dhiq me Drinin; rrethohet nga V. L. me vargun Lun-xheri — Bureto edhe nga J. P. me vargun Mali Gjerë.

Kjo luginë e mbulueme me një shtresë të ré lymike mbi të cilën spërdredhet lumi Drin, është edhe më e gjana e të gjitha luginave të kësaj ane, 45 km. e gjatë edhe 6-8 km. e gjënë.

Drini, tue u varë nga V. P., përmbi Palokastrën, më në Hundëkuq, ngushton fort luginën e vet nëpër mest malevet të Kurveleshit edhe me këte mënyrë mbas 10 kilometrash i përziën ujnën e veta me Vijosën pak pa ardhun në Tepelenë.

• Vijosa tue kaluem Tepelenën (mbi një shtresë shkambore 40 m. sipër lumit) kur vjen në Memaliaj, futet në tokat e Mallakastrës, ku lugina e poshtëme afër detit i zgjanohet e i bâhet porsî fushë, e cila prej popullit thirret Myzeqeja e Vogël. »

Kjo luginë e gjënë në trajtën e një fushe (fusha e Gjinokastrës), në të gjitha anët mbulohet më ara drith-nash (mâ tepët misër), njomet me kujdes me anë të remave të hapuna prej Drinit.

Këte fushë e sondon Gjinokastrë, e cila, e ngrefme mbi shpatullina të çveshme e shkambore të malit të Gjerë, është qyteti më i math i Shqipërisë së Naltë Jugë-perëndimore.

Me gjithë që tokët e gjithë luginës punohen shumë mirë, edhe këtu asnjë katund nuk ndodhet i ngrefun mbi këtë, por prap si nëpër të tjerat në rranzë të malevet të rrethit.

4. Luginat ulësinat e Delvinës. — Në jugë-perëndimin e vargut të Malit të Gjerë, shtrihet krahina e ulët kodrinore e luginore e Delvinës.

Luginat e kësaj krahine, n'anën e veriut përbâhen prej lumit edhe të kambëvet të Kalasës edhe në jugë përbâhen prej atyne të lumit e të kambëvet të Pavlës.

Lugina e Kalasës, tue ndjekun drejtimin e lumit me



këte emën, që zbret prej malevet Galisht-Luç, kur vjen rëposh Tatzatit, fillon me u-zgjanuem e kështu vijon deri te liqeni i Butrintit. Këtij lumi në të dy anët i shtohen disa Përrenj, të cilët gërmojnë lugina të fella në drejtimet e veta. Këto lugina të dyta, të cilat mbajnë emnat e përrenjvet nga lindja janë: lugina e Delvinës edhe ajo e Bistrieës; nga perëndimi: vetëm ajo e Nivicë-Bubarit. Pjesa jugore e kësaj luginë lymike afër liqenit të përmendun më nalt quhet Vurg. Kjo luginë pjellore nga perëndimi rrethohet me vargun detik e breguer të Sarandë — Shëndelli-t, i cili, i veshun me shumë anë me gumusha dushku e makjesh (ferra?), mbaron në det, ku formon brigje shkambore të nalta, Në këto brigje, në anën e jugës ndodhet Saranda (= it. Santi Quaranta) me një gjinth të vogël, por shumë të bukur.

Kjo natyrë shkambore e brigjevet të detit, vijon gjatë buzëvet të Shqipnis Jugore deri në gjinin e Vlonës.

Lugina e Pavlës, në jugë, ka një drejtim përgjithënisht prej lindjes në perëndim. Kësaj nga lindja i bashkohet lugina e Leshnicës.

« Lumi Pavla si e merr Leshnicën e përrenjt e tjerë, e përshkon këte luginë tue lymnosun edhe derdhet në det në gjinin e Butrintit. »

Këto lugina me gjithë që janë pjellore, nuk janë tue u-mbjellun ashtu sikur mbillen të tjerat në këto anë të Shqipnis. Këto përdoren më tepër për kullota dimnore se sa për ara.

Moçalet malarike të ndodhuna në shumë anë, pri-shin klimën e këtyne vendeve (vetëm 27 veta në një km²).

Folni ç' dini përgjithënisht mbi lumin e Vijosës!
Vizoni krejt lagjën e Vijosës!

C Fushat edhe luginat e Shqipnis së Naltë ose të Mbrendëshme. — Shqipnija e Mbrendëshme si vend malesh e pllajash nuk përmban aq shumë fusha sa Shqipnija detike; por luginat i ka me shumicë.



Ndër fushat e kësaj ane të Shqipërisë më e madhja edhe më e rëndësishmja është ajo e Korçës.

1. **Fusha e Korçës.** — Ndërmjet malit të Thatë, malevet të Moravës edhe malevet e kodrinave të Oparit e të Devollit (Mokrës!) rreth pllajës së Voskopojës, shtrihet një fushë e bukur në trajtën e trekandëshit, me një horizont të gjatë e me pamje madhështore e tërheqëse, me një syprinë të rrafshët, plot me ara të punueme, që vijnë tue u-naltësuem dalë nga dalë nëpër rrethinat e saja në kodrina të buta e të veshuna. Kjo pra është fusha e Korçës.

Kjo fushë, tue u-shtrimun prej veriut në jugë me një gjatësi 35 kilometrash e me naltësi mezatore 800 m. mbifaqen e detit, vjen gjithënjë tue u-bâ më e ngushtë deri sa merr fund porsë një grykë nëpër kodrinat e Floqit, në rranzë të qafës së Qarrit.

Devolli edhe përrenjt e shumtë (më i madhi i 'tyne është Dunaveci) e njomin edhe e përshkojnë këte fushë lymike tue i mbledhun e tue i përhapun ujnatin e 'tyne në liqenin e Maliqit (3 m. fellë) në veri. «Ky liqen s'përmban brigje e rrethina të lame, të shqueme e të vjetra, prandaj mund të merret para sysh si një liqen i rí. Edhe gojëdhënat e vendësve të këtushëm mbi këte punë, që thonë: — se sot e 80 vjetë më parë mbas një tërmetit të fortë, që paska ranë në këto vise, liqeni e paska rritun madhësinë e vet — mund të jenë të vërteta. Liqeni në fjalë rrethohet me një brez moçalik plot baltë, që mbulohet me kallama e me zhuga (shevar). Jashtë këtij brezi, sidomos nga juga, vjen brezi i kullotave e i livadheve me ligatinë e me bar të trashë e të ashpër. (Këtu kullosin më tepër kualt edhe bollicat). Për bukurinë e numurmëdhenj janë farët e shpezëvet në këte liqen sidomos pelikani (pâca) edhe bajzat, zhytërat etj.

Vetëm dy katunde peshkatarësh i ndodhen përfaqë: Sovjani edhe Libovniku».

Nga jugë-perëndimi liqeni ngushtohet fort (ura e Maliqit) e këtu Devolli del prej liqenit tue gërmuem më tutje



nji grykë lugine (300-400 m. fellësí mezzatare) të fellë edhe shkon nëpër mest malevet prej L. në P. «Me këte vend janë tue u-bâmë punimet e të të thamit të këtij liqeni, prej nji shoqënie vendëse: Shoqnija e Maliqit».

Në jugë të kësaj fushe, në rânzë e në faqe të kodrina-
vet, që varren nga malet e Moravës, lulëzon Korça e bukur.

2. Mb'anë tjetër të malevet të Moravës, nga lindja, shtrihet **lugina e Devollit të sipërmë**.

Devolli, tue buruem afër qafës së Fushës, ndërmjet Gramosit e Moravës, varet në këte luginë, në të cilën rri-
tet gjithnji tue i marrë përrenjt e shumtë të lagjës së vet edhe si e përshkon gjatazi këte luginë, prej jube në veri, kur e këthen drejtimin e vet nga veri-perëndimi për më dalë në fushën e Korçës, merr edhe kambën e vet mâ të fuqishme, që i vjen prej liqenit të Prespës së Vogël.

Lugina e Devollit të sipërmë është lymike edhe pje-
llore; ka mâ se 20 km. gjatësi edhe 8-10 km. gjânësi; me klimë të shëndetshme (850-900 m. naltësi mezzatare) e me katunde të pasun e të ndertuem mirë. Në qendrën e kësaj lugine ndodhet Bilishti.

Kjo luginë, tue u-ngushtuem nga veri-perëndimi, në drejtimin e Devollit, vjen e piqet me fushën e Korçës.

Nëpër këte luginë shkon rruga për Follorinë—Sela-
nik (në Greqí), e cila kalon nëpër qafën e Kapështicës.

Foloi ç'dini përgjithënisht përmbi lumin e Devollit (Devoll + O-
sum = Seman)!

Vizoni edhe lagjen e këtij lumi!

3. **Fusha e Starovës.** — Në jugë të liqenit t'Ohrit shtrihet nji fushë e vogël (700 m. nalt detit), në qendrën e së cilës ndodhet Starova. Kjo fushë nga V. P. vjen tue u-ngushtuem e tue u-naltësuem deri sa në vendin mâ të skanjshëm, pranë qytetit të Pogradecit, me fushat e arat terasinore të këtij, merr fund.

Pogradeci me klimë të shëndoshë e me pamje ma-
dhështore ka marrë nji randësi të posaçme në këte anë.



«Në këte fushë të bukur mbillet gruni, misri edhe drithnat e tjera; zbatohet edhe kopështarija sidomos në katundin Tushemisht.

Nëpër kodrinat më t'ulëta që e rrethojnë këte fushë, janë shtuem edhe vënishtat e rrushit».

«**Liqeni i Ohrit.**— Liqeni i Ohrit është më i madhi, mbas liqenit të Shkodrës edhe më i felli liqen i gadishullit të Ballkanit. Sipërfaqeja e këtij liqeni është 270 km² edhe fellsija 200 m. në më shumë se gjymsën. Faqja i gjindet 687 m. mbi detin. Ky merr ujnë e liqenit të Prespës (130 m. më nël se ky) me anën e Drinit, i cili rrjeth nën dhë e i derth ujnë e veta në këte liqen pranë Shën-Naumit e Tushemishtit.

Liqeni i Ohrit, përveç dy anëvet skanjore veriake e jugore rrethohet me male të nëltë; nga lindja vargu i malevet të Thatë edhe nga perëndimi malet e Mokrës.

Malet e Thatë e ndajnë këte liqen prej atij të Prespës.


Drini i Zi del në Strugë tue marrë ujnë e këtij liqeni.

Ky liqen është edhe ndër më të këthjelltit e botës; në fellsina më se 20 m. ndër ujna, mund të shifen lehtësisht peshqit tue lëvizun. Ujët e këtij në verat më të nxëhta e ruen jashtzakonisht freskën e vet (burimet e shumtë në shtratin e liqenit). Peshkatorija në këtë është mjaft e gjallë; zihen më me shumicë peshqit lekna, kresnica, koran, plashica etj., por më i shijueshmi është peshku i bardhë i quejtun belbica ose belushka.

Në rrethinat e këtij ndodhen fort pak katunde; ndër këta më i bukuri është Lini (Lichnitus) katund peshkatarësh, i ndër tuem në buzë t'ujit në faqen e veriut të gadishullit po me këte emën; ka një pamje romantike.

Marrërdhanja tregtare nëpër këtë kryhet me anë të barkavet të mëdha o me një vapor të vogël, por se këto marrërdhanje janë tepër të pakta, mbassi $\frac{3}{4}$ tat e liqenit ndodhen nën sundimin e Jugosllavis».

Fusha e Starovës më tri anët rrethohet me kodrinat e degëvet të Mokrës, të cilat n' anën e jugës, si formojnë nëltësinën kodrinore (200—400 m. relative) të



veshun me dushqe, shkojnë e bashkohen me malet e Thatë, në lindje.

Kodrinat e perëndimit nga ana e Pogradecit vishen në shumë vende me pyje gështenjash.

4. **Fusha e Kododeshit.** — Në perëndim të liqenit t' Ohrit, në rânzë të Qafë-Thanës, shtrihet fusha e Kododeshit. Ana e veriut të kësaj fushe (Rajica) edhe ana e lindjes (Uraka, Kododeshi) mbulohet me ara gruni e misri, kurse anët perëndimore edhe jugore (fusha e Musdovës) mbassi janë ligatinë përdoren për livadhe e kullota. Kjo fushë jep shenjat e shtratit të një liqenit të moçëm.

5. **Lugina e Drinit të Zi.** — Drini i Zi del prej liqenit t' Ohrit, në Strugë (Jugosllavi) edhe, tue rrjedhun mb' ate anë të kufinit mbrenda në tokat e Shqipnës Lindore të robnueme afër Dibrës së Madhe, futet në tokat e Shqipnës së Lirë. Ky lum këtu ka formuem një luginë (400—500 m. naltësi) të gjanë e shumë pjellore.

Kjo luginë shtrihet prej juge në veri, mâ se 30 kilometra, ndërmjet vargut linduer Deshat—Korab edhe të grumbullit Qendruer të malevet të Shqipnës së Mbrendëshme.

Këta vargje i varin degat e 'tyne kodrinore të buta e të veshuna me një naltësi 100—200 m. mbi luginën.

Nga ana e veriut në ballë të Peshkopis lugina merr po ate zgjanim që pat në ballë të Dibrës, në jugë; por, kur vjen në Arras, fillon m' u-ngushtuem edhe këtu pari merr fund.

Në këte luginë (500 m. naltësi) verës bân mjaft nxehtë; bâhet gruni, misri, pemët edhe rrushi. Katunde të mëdhenj e të pasun me arat e punueme të 'tyne e hijeshojnë këte luginë të bukur.

Drini i Zi në këte anë merr shumë përrenj, të cilët, tue u-varun prej vargjevet të rrethit, i gërryejnë këta edhe në shumë vende sjellin me sasi të mëdha ranë, zhu-rë, edhe gurë.

•Disa gjeologë kujtojnë se kjo luginë do të ketë qe-



në dikur një liqen, në të cilin Drini i Zi i përzinte ujnat e veta në jugë të Dibrës. Për këte gjâ deri tash nuk janë gjindun ende shenja provash aqë të mjafta.»

6. **Luginat e Malsís së Gjakovës.** — Drini i Zi, por sa kapërcen nëpër disa ngushtica të fella, mbërrin në **Kukës**, ku piqet me Drinin e Bardhë, i cili vjen prej fushës së Metojës (në Kosovën e Robënueme). Drinit, të bashkuem kështu, prej verí-lindjes i vijnë një shumicë përrenjsh (lumi i Krumës, i Bityçit, i Degës et.). Këta përrenj, që rrjedhin prej bjeshkëvet të Malsís së Gjakovës, e që vargohen ndërmjet Bishtrikut 1955 m. e Shkëlzenit 2460 m., kur bijnë në pjesat e ulta, formojnë lugina e rudina shumë të bukura, të cilat blerojnë me kullota e me livadhe shumë të gjâna përkundrejt bjeshkëvet të thata, të kuqëremta e të kaltërta nga ngjyra.

«Malësorët këto lugina i përdorin për kullota dimnore edhe pjesësisht për ara e livadhe. Këta verës ngjiten me tufat e tyne nalt nëpër bjeshkët e 'tyne, ku kanë edhe stanet».

«Drini qysh në Kukës e tutje, gjithnji rrjeth fòrt spërdredhtas (gjarpnueshëm) nëpër gryka të ngushta pa sajuem ndonji luginë me rëndësi deri sa bie në rrafshinat rreth Shkodrës».

Polni ç' dini përgjithënisht mbi Drinin!

Vizoni lagjen e Drinit tue i a shenjuem edhe kambët má kryesore te tij!

7. **Ulësinat e lagjës së sipërme të lumit të Matit.** — Ulësinat e Matit formojnë krahinën má t'ulët të Shqipnis së Mbrendëshme me një naltësi 200--400 m. mbi detin. Faqaja e kësaj ulësine ásht e mbulueme me një shtresë të trashë gurësh, ranë të kuqe të së tretës kohë gjeologjike. Nën këte shtresë ndodhet një shtresë tjetër prej gurësh serpentinerë. Të dy këto shtresa gjinden në mes të kësaj luginë të bukur.

Në perëndim të kësaj luginë naltësohet jo kudo me një rregull, krahu perëndimuer i Grumbullit të malevet



Qendrorë (m. Skanderbeut), që shtrihet përkundrejt vargut detik Krue—Dajt edhe paralel me ate; në lindjet i shkojnë disa rrëpina të buta, të cilat janë formuem prej shtresash të kohës së tretë edhe i përkasin Grumbullit Qendruer (mali i Allamanit dhe m. i Dejës); në jugë gjinden naltësit gigantike të Çermenikës; në verí naltsohet shkalla e Prosekut, e cila është ndasja e lagjes së Fanit e të Matit..

Kjo krahinë e rrethueme me të gjitha anët me male të naltë. e hapme vetëm me gryka të ngushta nga V. P. , në drejtimin e lumit, është tepër strategjike. Aty këtu nëpër rranzat e malevet gjinden sktëpija të përndame përmbi rrafshina të vogla, që mund të punohen, kur se katundet e mëdhenj gjinden më të dy anët e kësaj ulësine, mbassi këtu ndodhen rrafshinat më të mëdhaja, jo fort të përçame, e pra të mbara për mbjellje.


Prej malevet të rrethit, të veshun më me shumicë me pyje ahu mbi këto rrafshina, varen kodrina edhe rrëpina të mbulueme me gumusha dushqesh, në ranzë të të cilavet burojnë krojet e panumurta të këtushëm.

Mbi shkallën, e cila mbrenda në luginën e Matit formon vijën ndase ndërmjet lagjevet të Fanit e të Matit, duken qartazi nënshtresat e gurëvet serpentimorë kurse më në verí në ulësinën e vogël (Ndërfusha) pranë Fanit, këto shtresa humbin.

« Ulësinat e Matit pjekin edhe me ulësinat e Ungrejtit e të Kalivaçit të Mirditës tue pasë ndërmjet me këta vetëm disa shkalla jo të nalta. Këto të fundit vijnë deri afër Drinit. Për këte arsye pra mund të themi se një ulësinë e vijueme po me natyrën e ulësinës së Matit, shkon drejtë liqenit të Shkodrës.

Kjo ulësinë prej më se 80 km. gjatësi, e shtrime qysh prej Martaneshit deri afër Drinit, nuk përshkohet si luginat e tjera vetëm prej një lumi, por prej shumë lumesh si Matja, Fani edhe Gjadri ».

Lugina e Matit ka një shpeshësi popullsije më të madhe se krahinat e rrethit të vet malësuer e shkambuer



të thatë. Marrëdhajet e Matit më tepër kryhen me ulësinat e Drinit e me malësin e Mirditës, të cilat për arësyenat e nalt-tregueme, janë pak a shumë të kalueshme. Në jugë naltësinat e Çermenikës formojnë ndalesa për marrëdhajet. Po kështu edhe vargjet Perëndimorë kalohen me vështirsi.

Në Mat nuk gjindet ndonji qytet, por nevoja për pazare tregtije është e madhe dhe me të vërtetë mbahen të tilla (pazare) javë për javë në tre katunde: Klos' i Poshtëm (Zalli pranë Vaut të Matit), Burel edhe Lisë.

«Kjo krahinë e ndame prej të tjeravet me popullin e saj trim e, që shekuj me rradhë ka rrujtun independencën e vet pa u-përzimë, gjithëmonë fjesht shqiptare, hapi në fletët e historisë s'onë kombëtare një epokë të re shkëlqimi, ngjalli edhe një herë Shqipërinë dhe përsëriti periudhën heroike të Skenderbeut, tue na falun neve Shqiptarëvet Mbretin t'onë August, Shpëtimtarin e Kombit, Zogun e I-rë, tue u-naltësuem kështu në shenjtësinë e tempullit kombëtar».

KLIMA

1. **Gjendja klimatike e Shqipërisë.** — Trajtat e ndryshme të sipërfaqes së Shqipërisë kanë shkaktuem klima të ndryshme në të gjitha anët e saj. Shqipëria e Ulët ose Detike shquhet me klimën e saj mesdhetare, kurse Shqipëria e Naltë Jugë-perëndimore edhe ajo e Mbrendëshme shquhen me klimën e tyre toksores (=kontinentale). Vargu detik Krue—Dajt, malet e Shpatit edhe vargjet pranë detit të Shqipërisë J. P. formojnë kufijt ndërmjet këtyne dy klimavet të ndryshme.

Në veri, afër mbarimit të luginës së Matit, ku vargjet Qendrorë të Shqipërisë së Mbrendëshme vijnë tue ulun, edhe në jugë, ku malet ndërmjet Shqipërisë së Naltë J. P. edhe Shqipërisë së Naltë të Mbrendëshme nuk janë aqë të naltë, klima detike me atë toksoren nuk kanë një



kufi të caktuem, d. m. th. në këto vende klima detike futet më fellë përmbranda në Shqipëri.


Gjendja klimatike e Shqipërisë së Mbrendëshme nuk është e njëjshme. Klima e Shqipërisë Mbrendëshme Veriake ndryshon prej asaj të Jugores. Kufini klimatik ndërmjet këtyne të dyjave shkon në veri të Çermenikës, tue e lënë luginën e Dibrës në jugë.

Sadoqë statistikat klimatike apo meteorologjike na mungojnë, por brezet bimorë na prijnë mjaft për dallimin e klimave të ndryshme të këtyne anëve: afër kufinit, që u-përmend më sipri, mbarojnë pyjet e ahut, të cilat vijnë në Shqipërinë e Mbrendëshme të Veriut prej Europës Qendrore. Këto pyje ahishtash më tutje, rrëposh kufinit të përmendun në Shqipërinë e Mbrendëshme Jugore, ndodhen fort rrallë aty-këtu.

Shqipëria Jugore e Mbrendëshme në verë është e nxehët porsa Shqipëria e Ulët a Detike e ndoshta edhe më e nxehët, por nuk është fare e thatë. Gjendja klimatike e kësaj, nga ajo e Detikës, ndryshon prej ngricave, të cilat ngjajnë në dimën edhe në qendrën e gadishullit të Ballkanit. Pra klima e Shqipërisë së Mbrendëshme Jugore i ngjan klimës së Maqedonisë.

Shqipëria e Mbrendëshme Veriake, përveç dimnavet më të fortë e me shumë borë, ka edhe vera relativisht me lagësí e freskí. Këtu verës bie shi rregullisht, prandaj klima e 'saj i ngjanë klimës s'Alpevet Lindorë t'Europës Qendrore.

2. Vera edhe sasija e shinave në Shqipëri. — Në Shqipërinë e Ulët detike edhe nëpër krahinat bregore të Shqipërisë J. P. vera fillon në muejin e Majit porsa fillojnë me frymun ernat etezieme, të cilat këtu përgjithnisht vijnë prej veri-perëndimit. Këto erna vijojnë këtu gjatë muejvet të verës. Brigjevet të detit në jugë, lagështija u vjen vetëm me anë të shirokës. Kjo është një erë jugore, e cila në malet e naltë të brigjevet të Shqipërisë J. P. si edhe në vargjet perëndimorë të Shqipërisë së Mbrendëshme shkak-



ton vrânsina edhe shtërgata. Në Shqipëri e Ulët shirokkoja bie fort rrallë shi.

Si mbas përfundimevet të nxjerruna nga statistikat meteorologjike të Shqipërisë s'Ulët, (Durrës, Tiranë, Elbasan, Berat edhe Vlonë) sasija mezatore e shinave me këte anë të Shqipërisë mbërrin 1000-1200 mm., tue pasë vetëm 55 mm. për katër muej, prej Majit deri në Gusht (me përjashtimin e Beratit ku kjo sasi është 50 mm. Korriku në të gjitha anët ka ndën 15 mm. Vetëm Shkodra, e cila ka shumë më tepër shi (1456mm.), qysh në Maj merr një sasi të madhe shiu (92mm.), sasi të cilën anët e tjera nuk e marrin as për 4 muejt e përmendun. Këto shifra na kallzojnë një vorfëni të madhe të shiut në verë. Thatësija e verës në Shqipëri e Ulët shtohet edhe më tepër prej periodave të thata, që zgjasin shumë. Këto perioda në një vërtetë prej 10 vjetësh janë: në Shkodër 25 ditë, në Durrës 32, në Vlonë 44. Më e gjata periode e konstatueme në Shkodër ka vijuem 81 ditë, në Durrës 54, në Vlonë 69 ditë. Edhe në qoftë së bân me randonji herë, derdhet me një ose me dy të ranëme i gjithë shiu i një muji. Për këte arsye pra përpjestimi i të ranmes së shiut në këto anë nuk është aspak i mbarë për të rriturit e bimëvevet.

Në Shqipëri ë Mbrendëshme Veriake vera është më e lagët, si p. sh. në malsin e Çermënikës si edhe në malet e Skanderbeut në Qershuer nga një herë bie shumë shi. Po kështu edhe në malsinat e Mirditës në mes të Korrikut bijnë shina të rrepta. Të tilla shinash bijnë në mes të Gushtit edhe nëpër Alpet e Shqipërisë së Veriut si edhe nëpër malet që gjinden në Veri të Korabit (në Lumë). Në ulësinat e Dibres edhe në Gollobordë moti i thatë fillon në Shtatuer. Përdorimi i ujit për të njomurit e tokëvevet është tepër i rrallë në këto anë,

Në Shqipëri e Ulët, në Shqipëri J. P. si edhe në shumë pjesa të Shqipërisë Mbrendëshme Jugore, thatësija e verës është kaqë e madhe, sa që për të mbjellurit e për të rriturit e bimëvevet bujqësore është e domosdoshme të



njomunit e tokës me anë të remavet se përndryshe nuk bëhet kurrgjá.

Qielli i Shqipnis s' Ulët qysh nga Maji është shumë pak i vránët; mirëpo në Shqipnin e Naltë J. P. edhe në Shqipnin e Mbrendëshme vránsina është shumë má e madhe.


3. **Temperatura në verë.** — Temperaturat e ditës në fillimin e verës, me një qiell gjithëmonë të rrimët, ngrihen shumë. Maksimumet e temperaturës relativisht mbeten t' ungjëta. Maksimumi mezatar i përvjetshëm për Shkodrën (30 vjet) është $34,0^{\circ}$, për Durrësin (11 vjet) $35,5^{\circ}$. Si maksimum absolut për Shkodrën është $36,6^{\circ}$, për Durrësin $35,0^{\circ}$. Këtu duket influenza zbutëse e detit.

Temperatura mezatare për 4 (Shkodër) deri 6 (Vlonë) muej të vitit në Shqipnin e Ulët qindron përmbi $30,0^{\circ}$.

Netët në këte anë të Shqipnis janë jashtzakonisht të nxehta; nga kjo punë shkaktohet që temperaturat mezatare të Korrikut në Shqipnin e Ulët qindrojnë afër gradës $25,0^{\circ}$. Të vijuemit e temperaturavet të nalta natën edhe në mëngjes shkakton të zderlaqunit e trupit, tue ia marrë njeriut çdo dëshirë për punë.

Nuk janë orët e mesditës ato që ia paralizojnë njeriut fuqin e punës, por má tepër janë orët e paramesditës, 6 e deri më 10. Po sa lenë dielli shduket flladi i natës edhe afër orës 10 fillon një erë e freskët detike, e cila i bân orët e mesditës pak má të kândëshme, me gjithë që temperatura është tue hypun. Gjatë buzëvet të detit fryejnë natën edhe ditën disa erna lokale detike edhe tokësore me një rregullim të vijueshëm.

Nxehtësija e madhe e verës e sidomos vijimi i vapës edhe natën u plotësojnë bimëvet mesdhetare kushtet e rritjes së 'tyne; prandaj ullijt edhe fiqt janë shumë të përhapun nëpër këto anë të Shqipnis. Përveç këtyneve, mb' ata vende ku ka mjaft ujë është përhapun edhe kultura e orizit. Po këto kondita klimatike iu favorizojnë jetesën edhe anofelidëvet, të cilët janë mbajtësit e mikro-




bit të malarjes e prandaj Shqipnija detike vuen shumë nga kjo sëmundje.

Nxehtësija në Shqipnín e Ulët zgjatet deri në Vjeshtat. Në Shtatuer temperatura qindron ende më 20° . Muejt e Vjeshtavet këtu janë 2° — 3° mâ të nxehtë se muejt analogë të prandverës. Edhe me këta ndryshime ka të bájë influenza e detit.

Në Shqipnín e Mbrendëshme puna e nxehtësis ndryshon. Këtu njeriu i mësuem prej vapës së verës në Shtatuer thanë së ftofti. Edhe ditët e verës këtu ndryshojnë nga ato të Shqipnís s' Ulët. Ditët e verës nëpër ulësinat e Shqipnís së Mbrendëshme janë të nxehta. Në këto ulësina temperatura, rregullisht hypën përmbi 25° . Maksimumi absolut i temperaturës në këto anë, me gjithë naltësinat e mdha që kanë mbi detin, është mâ i naltë se ai i krahinavet pranë detit. Temperatura këtu shumë herë hypën mbi 38° ; mirëpo netët janë shumë të freskëta e sidomos nëpër majet e malevet janë shumë të ftofta. Në naltësinat mbi 1000 m., qysh në fillimin e Shtatorit e medje në dy javët e fundit të Gushtit, natën bie brymë e fortë.

4. **Stina e dimnit.** — Shtatori i bie Shqipnís s' Ulët shiun e parë të fortë si paralajmtar të kohës së shiut dhe mbas pak javësh vjen një tjetër shi e kështu me intervale, që shkojnë tue u-vogluem, vijnë të tjerë e të tjerë; me këte mënyrë fillon periudha e shinavet. Në Shqipnín e Mbrendëshme t' ulunit e temperaturës lajmon afrimin e dimnit. Tash ti kudo cyklonet një mbas njëje fillojnë me e përshkuem atmosferën e Shqipnís. Ernat e forta vijnë vërdallë pa pushim. Ernat e jugës, që përzihen me cyklonet, bijnë shina me shumicë. Ndoth që në muejt e dimnit bie shiu i njëj mueji në pak ditë, e nga një herë në një ditë të vetme. Ndërmjet këtyne shinavet qarohet nga një herë qielli dhe kështu mund të shifet dielli. Nga ky shkak dimni ka relativisht pak vrânësne. Vrânësina në të gjithë Shqipnín është rreth 50%, pothue e njëjshme në të tana krahinat. Vlona në Nanduer



vrânësinën mâ të madhe e ka 62% (minimumin në Korrik 14%); Shkodra 52% edhe Durrësi 51% në Dhetuer.

Maksimumi i shinavet në Shqipnî bie në Nanduer, edhe në Mars bie një maksimum tjetër mâ i vogël.


	Mezat. e motit	Nand.	Mars	Korrik (minim.)
Shkodra mm.	1456	209	162	29 (Gusht)
Durrësi " "	1090	215	100	12
Tirana " "	1020	201	94	11
Elbasanl " "	1120	221	103	12
Berati " "	1200	217	119	14
Vlona " "	1080	195	107	13
<hr/>				
Kruja mm.	1710	337	157	19
Puka " "	1820	260	202	36

Në Prill fillon me u-larguem koha e shiut për me ia liruem vendin motit të thatë të verës.

Vetëm njani nga stacionet, që u-përshkruen naltë, Puka, gjindet në Shqipnî e Mbrendëshme; porse ky nuk mundet me na dhanë një fytyrë tipike për të gjitha këto anë malsore.

Shinat e mdhenj të dimnit prishin nga një herë komunikacionin e Shqipnîs. Krahinat e gjâna të Shqipnîs detike, që janë shumë t'ulta, veç këtyne edhe ato fusha argjilore me popullsi të shpeshët me këte kohë marrin trajtën e një liqeni të math. Rrugët deri më sot kanë qenë jo aqë të mjafta e të mira, prandaj Shteti këto po i shton edhe po i përmirëson gjithënjë në ditët t'ona me një gjallëni të posaçme. Po kjo gjâ është edhe në Shqipnî e J. P., ku gjithë krahinat e ungjëta përbâhen prej dhenavet rrëshqitëse; porse këtu prap ka rruga si mâ të mira.

Dimni i Shqipnîs s'Ulët është i butë e sidomos në brigjet e detit. Këtu mbretnon një temperaturë mezatare në Kallnuer 8-9° (Durrësi 8,3°, Vlona 9°), e cila shkon tue u-shtuem prej veriut në jugë. Me të larguemit prej detit temperatura shkon tue u-ulun; nëpër krahinat e Shqipnîs s'Ulët 4-6. Edhe këtu prej veriut në jugë shkon tue u-shtuem: me-



zatarja e Kallnuerit në Shkodër është 4,4°, në Tiranë 5,3°, në Elbasan 5,9°, në Berat 6,1°. Me qenë se mezatarja e Korrikut kudo është afër 25°, ndryshimi ndërmjet muejit më të nxehët edhe t'atij më të ftofët për krahinat e mbrendëshme bëhet më i math se për krahinat afër detit. Ky ndryshim vjen tue u-shtuem qysh nga brigjet e detit 16—16,5° (Vlona, Durrësi), 18-21° në stacionin e mbrendëshëm (Shkodra 21,1°). Në Shqipëri e Mbrendëshme mund të jenë ndryshime edhe më të mëdha.

Ngricat ngjajnë rregullisht në Kallnuer kudo e edhe nëpër buzat e detit me gjithë që dimnat i kanë më të butë e të ngrofët. Këto shkaktohen nga rrymat e rrjedhjet ajrore të ftofta, që vijnë nga qendra e gadishullit të Ballkanit, tue mësyem e sulmuem krahinat t'ona t'ulëta e detike. Këto shumë herë shkaktojnë dëme të mëdha, se bëjnë efekte rrenuese në bimët mesdhetare, (si limona portokalla etj.). Këto rryma të ftofta marrin drejtimin prej lindjes në perendim edhe prej veriut në jugë.

Doemos nga një herë ngjajnë edhe çudina, si në dimnin e 1923-24-rës ngrini edhe kënetat e Artës (liqeni i Vlonës), po me këtë vit u thanë 90% portokallet edhe limojt e Elbasanit e të visevet t'jera.

Në Shqipëri, përveç ngricave që ngjajnë kudo në krahinat mesdhetare, bie edhe bora në dimën gjithkrah e edhe nëpër brigjet e detit; por një shtresë bore, që të qindrojë pa u-shkrimun për shumë ditë, mund të takohet vetëm nëpër krahinat e Shqipërisë së Mbrendëshme.

Në Shqipëri e Mbrendëshme Jugore në dimën binë sasina të mëdha bore edhe qindrojnë shumë kohë pa u-shkrimun. Në Shqipëri e Mbrendëshme VeriAKE dimni është po kështu, vetëm me ndryshimin se këtu të rreshmet e borës janë më me shumicë. Nëpër këto anë, shumë herë edhe në mes të verës, gjinden sasina me rëndësi të borës së vjetër në naltësina jo edhe aqë të mëdha.



Flora edhe fauna

ose

Grumbulli bimuer edhe shtanzuer


Vetëm një pjesë e vogël e sipërfaqes së Shqipnis është e çveshun. Pjesa tjetër më e madhe e saj është e veshun me bime pak a shumë të denduna.

Përmbi grumbullin bimuer të Shqipnis deri më sot nuk është bëmë një përshkrim i plotë.

Si në çdo anë të faqes së dheut ashtu edhe në Shqipni grumbulli bimuer ndryshon si mbas naltësis së vendit. Në Shqipni dallojmë katër breze bimorë: më i ulti është *brezi i makjevet*; në këte bres gjinden bime me gjethe të forta, të cilat i karakterizojnë krahinat mesdhetare. Përmbi këte shtrihet *brezi i gjânë i dushkut*, deri diku mjaft i përziem me ahishtat, të cilat luejnë rolin më kryesuer. Ky formon një bres të poshtëm pyjesh në Shqipni. Mbas këtij vjen një bres tjetër me pyje, që duen lagështinë, edhe bima a pema karakteristike e këtij brezi është *ahu*. Ky bres rregullisht në Shqipni formon kufinin më të naltë bimuer. Brezi i katërt është *brezi alpinuer*.

1. **Brezi i Makjevet.** — Makjet formojnë gumusha drësh, gjethe t' ashpërtë e gjithëmonë të blerët, të cilët takohen në çdo krahinë mesdhetare. Këto gumusha, si grumbuj ferrash të pluhnosun, të përziem me ngjitëset gjembore, të gjitha në një ngjyrë pothue t'errët edhe me një naltësi 4—5 m. janë pothue të papërshkueshme. Makjet më të rritëshme edhe më të shumëfarëshme gjinden nëpër brigjet e detit ose përmbi faqet e kodrinave të këthyeme nga deti. Këto janë: bruga, shqjopa, shkoza gungaçe gjembore, driza, manaferra, ferrat, ngjitëset gjembore, mara, xungthi ose zhuga, grifsha, ullastra, gjineshtra etj. (*erica arborea, quercus ilex, pistacia lentiscus* etj.)

Në pjesat e Shqipnis më larg detit vendim e makjevet e zënë vetëm disa prej farëvet të tyre, tue qenë të trazuem me druna, që blerojnë vetëm në verë.



Makjet origjinale në Shqipëri nuk formojnë një bres bimësi të përbashkët. Këto pjesësisht mbulojnë anët jugore edhe perëndimore të kodrinave të Shqipërisë s'Ulët dhe më në jugë vetëm brigjet jugorë të Shqipërisë J. P. Në mënyrën e të përdamit të bimëveve nëpër brigjet e Shqipërisë duket qartazi influenca klimatike e pjesave të mbrendëshme të gadishullit të Ballkanit. Në dimën disa rryma të ftofta ajrore rrjedhin edhe e sulmojnë Shqipërinë, tue i mbërrimun deri në brigjet e detit. Prandaj makjet origjinale përmbëlidhen mb' ato anë që mund të përfitojnë nga influenca zbutëse e detit, (dy faqet e ndryshme të një kodre apo mali me bimësinë të ndryshme).

Makjet në Shqipërinë e Mesme mbarojnë te vargu Krujë—Dajt. Edhe në Shqipërinë e Jugës gjinden mbi ato pjesa të maleve detike, ku u vjen mbarë klima. Po kështu mund të ndodhen këto edhe në Shqipërinë e Mbrendëshme, deri aty ku mund të vijnë ernat detike, p. sh. fusha Buelit bashkë me fushën e Labinotit, të dy në lindje të Elbasanit etj... kanë bimësi makjesh me gjithë që ndodhen në Shqipërinë e Mbrendëshme. Kufiri i brezit të makjeve nuk është aqë i naltë. Këta kufij në Shqipëri shkojnë si gjithë kufijt e tjerë bimorë, tue hypun prej veriut në Jugë edhe prej perëndimit në lindje. Ky kufi në Shkodër mund të jetë 200 m., në Durrës 200—300 m. në rrëzë Dajtit kap 500 m. Në Vlonë, në pjesat perëndimore të malit të Çikës, kufiri i makjeve mbërrinë deri më 350m., ku formon një vijë fort të dallueshme, e cila është më e nalta në brigjet detike të Shqipërisë.

Dora e njeriut i ka zhdukun makjet nëpër disa vende, për me fituem vende bujqësore nëpër të cilat ka formuem një farë makjeje të kultivuem.

Krahinat me pemë e bimë mesdhetare në Shqipëri vijnë mbas brezit të makjeve. Këto pemë e bimë përmbledhin: portokallat, limonat, mandarinat, qitrat, turunxhat, ullijt, fiqt, shegët, mushmullat e frangut, rrusht, pambukun, orizin etj.... Për kulturën e këtyne bujqit shqiptarë kanë zgjedhun vendet më të përshtatshëm edhe më




tepër në Rivierën Shqiptare, në rrypin buzë detar të Bregut të detit, prej Vlone deri në Himarë, atje ku ka uj. Këto pemë a bimë rriten edhe në disa uaze në Shqipërinë e Mbrendëshme si n' Elbasan edhe në Delvinë; në të parin shtrihen orizoret deri në Labinot edhe në të dytën gjatë rrugës së Sarandës.

2. **Pyjet e Dushqevet.** — Aty ku nuk rriten më makjet, d.m.th. mb'ato vende që nuk janë të mprojtuna kundrejt ernavet të ftofta toksore, fillojnë rregullisht pyjet e rralla të dushqevet. Me këta pyje fillon pra brezi i math i dushkut, i cili mbulon kodrat edhe pjesat e ungjëta të malevet të naltë.

Ky bres fillon qysh prej kodrinavet të buzës së detit edhe shtrihet pa u-shkëputun deri nëpër pjesat e Shqipërisë së Mbrendëshme. Në vendet më të ungjëta të bregut të detit dushqet përzihen me ahun e bardhë, me frashënin e me lisa të tjerë si: shkoza, mllaku, mlleza, kregëza, lejthija, thana, thanukla (funukla), murrizi, blini etj.; kurse në krahinat e mbrendëshme, më fellë, sundon fjesht dushku tue u-gjindun me të tanë farët e veta: bung, qarr etj. Pyjet e dushkut, përgjithënisht janë të thatë. Këta pyje me të vërtetë bëjnë hije, por ajri ndër 'to është i nxehët, mbassi nuk lëviz aspak; prandaj nxehtësia mbrenda këtyne është shpeshë herë më e madhe se përjashta. Ndër këta pyje ditën mbretnon qetësia e plotë. Zoqt që jetojnë këtu, pothue se nuk ndigjohen; edhe derrat e egër, që janë me shumicë të madhe, nuk ndihen së gjalli. Vetem mizat përdhecke, të gjithëfarëshme enden paprâ nëpër trojet lakuriq (pa bar). Në vende, ku ndriçon dielli, ndigjohen zhurmat e gjinkallës e në hije fluturojnë herë me qetësi e herë me zâ gjithë farë mizash e insektesh të tjerë.

Me gjithë që brezi i dushqevet në Shqipërinë e Lirë është mjaft i math, pyje të paprekuna gjinden këtu pothue fort rrallë. Shumë tepër i ka rrënuem dora e njeriut për nevojë drûsh për të djegë, aqë sa në disa vende, ku



përpara lulëzojshin pyjet, sot gjinden vetëm gumusha te vogla (gumusha = zabele të vogla e të rralla). Kjo vërtetohet nga disa dushkaja të rralla, që shifen aty—këtu, të cilat nuk janë tjetër veçse të mbetunat e pyjevet të gjâna të dikuershme.

Pylli gumushuer ose zabeli i dushqevet në Shqipni është mjaft i përhapun kudo pranë qytetevet e katundevet; kurse pyjet e rrituna të kësaj fare gjinden nëpër krahinat e largta, të vetmueme e të shmangëta.

Pyjet e dushkut shumëherë grabiten tue ia marrun dushkun (gjethet) për bagëti. Trupat e dushqevet të mbetun pa dega, nuk munden t'u bëjnë mprojtje edhe hije rranjavet të veta. Nga kjo kështu u prishet edhe u rrëshqet truelli tokësuer i rrëpinshëm që mbahesh më parë me rrjetën e shpeshët të rránjavet, e më në fund rrënohen edhe lisat vetë.

Pyjet e dushkut për vendin t'onë kanë një rëndësi të madhe pse brezi i katundevet t'ona bie përgjithënisht në brezin e dushqevet, prej të cilëvet katundari i ynë është tue nxjerrë pjesën kryesore të nevojës së drunit. Gjethet e dushkut, të ramë rëposh drunavet, në dimën hahen me andje të madhe prej kafshëvet shtëpijake. Kjo punë e përmbush mungesën e kullotavet dimnore edhe deri diku zen vendin e barit të thatë. Prej disa anëvet të Shqipnis (më tepër Mirditë e Himarë) bëhet exportimi i lendavet edhe rrshemëvet, që janë prodhimi i pyjevet kësodoret.

Pyjet e dushkut kryejnë edhe një punë tjetër: ndalojnë ose ngadalësojnë të gërryemit e të rrënuemit e tokës.

Pyjet e dushkut në Shqipni J. P. janë pjesësisht të rrënueme nga të premet e pamëshirëshme që ka bënë bënë nori i atyshëm. Nëpër vargjet këlqerorë të kësaj ane të Shqipnis, hasen aty—këtu disa dushqe në vetmi; këta pa dyshim janë të mbetunat e pyjevet të dikurshëm. Kjo gjindje e mjerueshme na kujton se këtu një herë moti nga të premet që kanë bënë njerzija, është zhdukun një bres pyjuer që dikurë ka qenë në gjindje të lulëzueshme edhe tash nga rrethanat klimatike që sundojnë atje, nuk mund



të rriten më. Këta pyje ndoshta mundet të kenë qenë krijuem nga klima e kohës s'akullit. Faqet e tokavet të pyjevet të rrenuem kësodore kanë rrëshqitun e kanë luejtun prej vendit e kështu në vendin e 'tyne janë formuem faqe të tjera të çveshuna porsi ato të Dalmatis.

Nëpër vendet e tjerë, ku kushtet natyrore janë pak më ndryshe, gjinden të tjerë formime bimore mbrenda brezit të makjevet edhe të dushkut. Në vende që nuk janë aqë të rrëpinshëm, edhe nëpër fusha të thata gjindet një formim i veçantë bimuer, kështu, bashkë me makjet që janë me pakicë, ndodhen edhe druna a pemë të tjera me shumicë që blerojnë vetëm në verë. Ndërmjet këtyne gumushavet gjinden edhe vende që janë të çelun. Në disa vende mbretënojnë ferrat me gjemba të rrezikshëm nëpër të cilat nuk mund të kalohet pa u-grrithë e pa u-grrisun.

Buzët e lumejvet në Shqipni kanë një bimësi të veçantë. Përgjithënisht rrapishtat e vende-vende shelqet, rakitat, plepat etj. porsi një bres rrethojnë rrjedhjet e lumejvet edhe të përrenjvet. Ndër rrapat disa janë shekullorë dhe tepër të bukur.

Në disa vende, ku ujt afrohet ose përhapet në sipërfaqen e tokës, gjinden pyje të shpeshta e të blerta; ndërmjet drunavet të këtyneve rriten kallamat dhe bimët 'tjera ujëse; p. sh. pyjet e Bisticës së poshtme në skanjin juguer të Shqipnis J. P.

Në Shqipni e Mbrendëshme, ku makjet nuk mund të bâhen më, brezi i dushkut merr një zgjanim të posaçëm deri në pjesat më të ulëta. Kufini i këtij brezi kudo është i dalluem plotësisht. Në këtë kufi fillon një bres pyjesh të tjerë prej ahishtash, të cilavet u vjen mbarë (u pëlqen) lagësina. Ky kufi në Shkodër është në një naltësi prej 900 m. dhe shkon tue hypun, si gjithë kufijt klimatikë, në drejtimin juguer të vendit: në Dajt dushqet shtrihen deri nëpër naltësinat 1000 metrash.


3. Pyjet e brezit të naltë, që duen lagështi edhe brezi alpinuer. — Në krahinat e gjana të Shqipnis së Mbren-



dëshme ahishtat janë mjaft të përhapuna. Lisat e këtyne nëpër këto anë ose janë fort të shpeshët afër njani-tjetrit ose të rrallë, larg njani-tjetrit. Në gjendjën e parë pjesa e mbrendëshme e 'tyne nuk pushton fildane dhe në gjendjën e dytë pushton sojet me shumicë. Livadhe mali të njomë shumë herë të zgjanuem prej njeriut me të hapunit e pyjevet, ndajnë vijimin e gjatë të brezit të naltë t'ahishtavet, të cilat në vendet e shmangët e të vetmuem formojnë pyje pothue të paprekuna. Aty-këtu trazohet ngjyra e të blertit t'errët e bredhabet me ngjyrën e të blertit të çelët t'ahishtavet. Freskija ajrore e këtyne pyjevet është tepër e kandëshme; por edhe më e kandëshme edhe tërheqëse e më madhështore është pamja romantike, që çfaqin ata.

Pyjet e ahishtavet në Shqipëri e Lirë nuk gjinden gjithkund nëpër të gjitha malet, atje ku mbaron brezi i dushqevet. Këta pyje mbarojnë në skanjin juguer të Çermenikës. Në malet e Shebenikut e të Mokrës si edhe nëpër vargjet, që gjinden në perëndim të Shkumbinit edhe në Tomor gjinden pyje ahishtash, por më nga juga fort rrallë aty-këtu. Ahishtat e Shqipëris formojnë vijimin e ahishtavet t'Europës Qendrore, të cilavet klima e Shqipëris së Mbrendëshme Jugore nuk u vjen mbarë e prandaj është formuem kufini që folëm tash.

Brezi i naltë i pyjevet të Shqipëris nuk përbâhet vetëm prej ahishtavet. Këto përgjithënisht sundojnë tokat këlqerore; por në serpentinet zavendësohen kryesisht prej pyjevet gigantike vgjenjsh (=Gjerdhenjsh ose pishash), të cilët përbajnë një formim brezi të përkorët të brezit të sipërmë pyjues; prandaj kufini i poshtëm i 'tyne është më i ungjët se ai ahishtavet. Pishat shpeshë herë edhe në vende më të ungjëta ja zanë vendin edhe dushkut. Faqet e malevet serpentiner shumë herë duken të mbulue me me vgjenj (pishë); por luginat, po të këtyne malevet, në të cilat rrjeth uji, janë të mbulueme me ahishta. Në malsinat e krahinës së Drinit të Zi të poshtëm pisha formon pyje të gjënë. Po kështu faqet e këndejshe të




Korabit mbulohen prej këtyne pishavet. Edhe në Koritnik si edhe në vargjet e malevet qendrorë, që e rrethojnë ulësinën e Drinit, pyjet e pishavet shtrihen deri në naltësina 1000 m.

Pyjet e vgjenjvet nuk bájne një përshtypje të freskís si ato t'ahishtavet e sidomos, kur janë tepër t'ungjêta duken fare të thatë. Kêta i përkasin pa dyshim brezit të naltë pyjues; sepse në Shqipnín e Mbrendëshme Veriake shumë herë formojnë kufinin má të naltë bimues (Munella, Nezhda e Lurës), ku në maja të tjera fqinj po me atë naltësi ahishtat mbarojnë tue u-rrëgjue. Po kështu ásh edhe nëpër Alpet e Shqipnís së Veriut p. sh. në Majën e Hekuravet edhe në të tjerat të kësaj ane pishoret thjeshtësisht ndodhen përmbi ahishtat.

Pyjet e vgjenjvet, porsí ato t'ahishtavet, në Shqipnín, marrin kufinin e 'tyne jugues. Kêta gjinden p. sh. aty-kêtu në degat e përparëshme të malit Çika, që ásh vargu detik veriak i Shqipnís J. P.; porse má nga juga nuk gjinden má veçse fort rrallë.

Në Shqipnín e Mbrendëshme Veriake të qenunit e brezit të naltë pyjues luen një rol me rëndësi në çashtjen e ujit. Në pjesën jugore të Shqipnís së Mbrendëshme si edhe në Shqipnín J. P., ku brezi i naltë pyjues mungon krejt, ndryshimet në gjindjen e ujit ndihen qartazi. Kêta ndryshime nuk dallohen fort ndër lumejt e mëdhenj aqë sa ndër përrenjt e vegjël; mirëpo këto rrjedhje kanë një rëndësi drejt për së drejti për banimin e njeriut nëpër male. Në Shqipnín J. P. ka male me naltësi prej 1800 m. si p. sh. mali Gjerë, në faqet e të cilit në verë nuk rrjeth asnjë pikë uji. Fare ndryshe ásh puna në Shqipnín e Mbrendëshme Veriake. Kêtu, veç atyne vendeve fjesht këlqerike që s'e përmbajnë ujt, çdo luginë e malevet ka ujin e vet e medje má tutje rëposh pyjvet t'ahishtavet. Për banimin e përgjithshëm të Shqipnís kjo punë ka një rëndësi të madhe e të posaçme.

Si në gjithë botën ashtu edhe në Shqipnín përmbi brezin pyjues përhapet brezi a shtresa e *alpinëvet*. Ky bres



fillon jo me të gjitha anët në një naltësi. Kufini (mbarimi) më i naltë i pyjevet përgjithënisht bie më poshtë në brigjet e detnavet se sa në pjesat e mbrendëshme të Shqipërisë.

Nuk mund të njihet mirë si qëndron ky kufi në drejtimin juguer. Në disa krahina, si p. sh. në lagjen e sipërme të Shkumbinit, ky bres naltësohet si mbas rregullës së përgjithëshme në drejtimin e ekuatorit, d. m. th. mbas gjënësive gjeografike. Po ta verejmë gjithë Shqipërinë, nuk do të mundemi me folun përmbi naltësimin ndërmjet dy pikave, që kanë po një largim të përbashkët prej detit. Ndërmjet dy këso farë pikash ky kufi duket se ulet pjesësisht në drejtimin juguer. Në Shqipërinë jugore është vëshirë e ndoshta e pa mundun puna e caktimit të kufinit më të naltë të pyjevet, mbasi atje këta mungojnë edhe vendin e tyre e zënë kullotat.

Kufini i sipërmë i pyjevet, në vendet fqinj me krahinat detike, në Shqipërinë e Veriut, si b. f. në Cukal është në një naltësi 1600—1700 m. Vargjet detikë të Shqipërisë së Mbrendëshme e rrujnë këte naltësi kufini pothuë pa e prishun edhe në të zgjatunit e tyre nga juga. Mali i Dajtit, afër Tiranës, përmbi naltësinë 1608 m. është krejt i çveshun d. m. th. naltësinë e kufinit bimuer e ka kaqë. Edhe majat me 1700 m. naltësi të malevet të Skanderbeut, që janë më përmbrenda, dallojnë e duken të çveshun përmbi ahishtat. Në jugë të Shkumbinit, nëpër vargjet perëndimorë të Shqipërisë së Mbrendëshme, ky kufi ngrihet për një herë më nalt, si p. sh. te mali i Shpatit (Bokaniku) 1800 m. edhe te Guri i Topit 2000 m. Shkaku i këtij ndryshimi nuk rrjeth nga të ndodhunit e këtyne më në jugë, por nga që këta largas, pothuë në një gjënësi, rrethohen me vargjet e Shqipërisë J. P. e kështu përkundrajt këtynevet trajtohen jo më si vargje detikë por si të tillë të mbrendëshëm. Në brigjet e detit, në Rëza e Konallit edhe në malet e Çikës kufini pyjuer (vgjenjsh) nuk shkon përmbi 1500 m. Në shkanjin juguer të Shqipërisë J. P., më në fund në Mlëz edhe në Saraqin drunat e



rralla të dushqevet memëzi mbërrijnë me u-pamë në naltësinat 1000 m., kurse më përmbrenda, në këte gjanësi, te mali i Shëndenikut, ky kufi naltësohet deri më 1400 m.

Sa më shumë që t' u-largohemi brigjevet e të shkollmë përmbrenda fellë në Shqipni, do të shofim se kufini pyjuer na naltësohet aqë më tepër. Kjo naltësi kufini pyjuer në vargjet detikë të Shqipnis Veriake pamë se ishte 1600—1700 m.; mirëpo në malet Qendrorë si në Nezhden e Lurës edhe në Mënellë 1800 m. Mb' at' anë të Drinit Zi, në Gjalicën e Lumës, lisat pishore gjinden deri nëpër naltësinat 2000 m. Po ky përpjestim analog u-vërtetue më nalt si për Shqipni J. P. ashtu edhe për pjesën jugore të Shqipnis së Mbrendëshme.

Po të krahasohen kufijt e naltë të malevet të Shqipnis së Mbrendëshme ndërmjet njani-tjetrit, nuk do të shifet ndonji naltësim ne drejtimin juguer; por më tepër do të dallohet e përkundërta. Në Gjalicën e Lumës, si pamë më nalt, pyjet mbarojnë në naltësina 2000 m.; mirëpo në Jablanicë edhe në Shebenik, të cilët janë shumë më nga juga edhe po aqë përmbrenda, ky kufi është në 1900 m.

Kjo gjindje e rëndësishme e kufinit të naltë pyjuer në Shqipni duket sikur me qenë në lidhje me vijimin e natyrës pyjore t' Europës Qendrore, prej ku brezi i naltë i pyjevet lagështi-dashës si ah, pisha edhe bredhi, zgjattet nga juga edhe futet në Shqipni tue pasun nji gjallëni më të madhe në veri se sa në jugë.

Brezi alpinuer pushton sipërfaqe të mëdhaja në Shqipni. Në këte bres shtrihen kullota të gjana, të cilat në pranverë edhe pak më vonë, hijeshojnë tue u-mbuluem me lule të bukura. Përmbi këto, aty pranë, naltësohen shqembinjt e thatë. Këto kullota malësore në shumë vende, të zgjanueme me çfarosjën e me rrënimin e pyjevet, formojnë nji themel me rëndësi për blegtorin shqiptare. Nëpër këto në verë kullosin tufa të mëdha dhensh e dhijs, që për shumë vende malsinash formojnë pasjen më kryesore e jetike.



4. **Farët e ndryshme të tokavet bujqësore edhe punimet e ndryshme nëpër 'to.** — Tokat bujqësore në Shqipëri, veç atyne të natyrshmevet, janë sajuem edhe prej njeriut tue u-çelë pyjet, si në brezin e butë e t'ulët mesdhetar ashtu edhe në brezin pyjues të dushkut. Përveç kësaj përfundime të mira kanë sjellun edhe provat e bâme për këte punë në brezat mâ të naltë, ku nuk âsht aqë e madhe nevoja për ujitjet.

Tri të katërtat e tokëvet t'ona të mbjelluna përdoren për kulturën e misrit, i cili për popullin t'onë formon bazën e ushqimit. Mbas misrit vjen gruni edhe mbasandaj të lashtat e tjera si elbi, teпа edhe tërshana e në shumë vise edhe thekna.

Gjithë farët e perimevet (zarzavatevet) si edhe të gjitha pemët mesdhetare e kontinentale, bâhen me shumicë si mbas vendit e klimës kudo në Shqipëri.

N'atdheun t'onë livadhet e natyrshëm u kanë bâmë mjaft vend tokavet t'ona për kulturat e ndryshme bujqësore. Por na kemi lânë edhe shumë pjesa të tilla pa i punuem, të cilat sot i përdorim për kullota pa llogaritun përfundimisht se a âsht kjo një punë mâ e fitimshme. Në kohën kur kemi me i përdorun metodat mâ të reja bujqësore në punimin e tokavet t'ona, për t'i gjetun vendet e aravet, do të detyrohemi e do të nevojitemi me ndjekun rrugë të tjera.

5. **Shtâzët e egëra.** — Shqipëria përgjithënisht âsht e vorfun në shtâzët e egëra; në shumë krahina nga një herë nuk shifet ndonji krijesë prej këtyne e duket sikur nuk rron shpirt i gjallë nëpër ato. Kaprojt e drëjt, dhít e egëra edhe aríjt, dikurë me shumicë, sot nuk duken mâ veçse rrallë e fort rrallë aty-këtu; vetëm lepurat takohen shpeshë e kudo.

Një jashtregullim në këte punë bâjnë derrat e egër, të cilët janë banorët e pyjevet të dushkut, ku rrojnë me shumicë edhe janë tepër të rrezikshëm për arat e misrit, ku munden me bâ dâme shumë të mëdha.



Vorfnija e shtazëvet t'egra në Shqipni ka rrjedhun prej punës se populli qysh prej shekujsh ka pasë qenë i armatosun dhe kështu i ka faruem këto dalë nga dalë. Nji shkak tjetër i kësaj vorfnije është edhe blegtorija, se tufa të mëdha dhensh e dhijsh gjejnë ushqimin e 'tyne nëpër male e kështu pushtojnë vendin e egërsinavet.

Vetëm ujtit gëzojnë kondita të mira në këte gjindje; këta rrojnë në shumë vende malsish, por më me shumicë gjinden nëpër ulësinat e Delvinës, ku ndodhen me numur të math edhe çakajt.

Dhelpna ose skileja ndodhet më shpesh nëpër vendet e ndryshëm por fishnjari, lundra, kitra (gjeri) e guzaforet e tjera janë më të rralla.

Asht për t'u-çuditun se Shqipnija edhe nga shpezët e egëra ndodhet e vorfun. Këto mungojnë jo vetëm n'ata vende, ku njeriu ka vû dorë në pyje edhe i ka rrënuem këto; por edhe mb'ato anë, ku gjinden krahina të gjana pyjesh të paprekuna. Vetëm në disa pika të caktueme të Shqipnis jeta e shpezëvet është më e gjallë. Nëpër krahinat moçalike të Myzeqes edhe nëpër luginat e ulta të lumejvet rrojnë me shumicë shpezët ujse: rosa e pata t'egra, bajza, shota edhe gusa etj... Në liqenin e Maliqit, të Tërbufit, të Karavastás, edhe nëpër kënetat në jugë të Shkodrës rrojnë me shumicë pelikanët (pácat), të cilët janë zhdukun krejtësisht prej fytyrës së tokës e vetëm në këto vise e në disa krahina të Kosovës së Robnueme japin ende shenja gjallënije.

Nëpër shqembinjt e bjeshkëvet t'ona rrojnë me shumicë shqiponjat, falkojt, sqyfterat, krahathatat, hutinat etj... Po në këto anë nën hijen e ahishtavet janë gjindun edhe linzat e macat e egëra por me pakicë.



II. Studimi politik i Shqipnís

1. Popullsija

Na Shqiptarët i përkasim racës Iliriane. Kjo racë dikurë banonte dhe sundonte n' Ilirín e madhe, e cila shtrihesh në brigjet lindore t' Adriatikut. T' ardhunit e Sllavëvet, që ngjau më të VII-tin shekull në kohën e perandorít Heraklius dhe të përhapunit e 'tynë n' Ilirín e veriut shkaktoj të përziemit e shumë fisevet iliriane t' atjeshme me ata. Kjo e përzieme u-bá má tepër në gjuhë e në zakone se sa në gjak. Malazezi, Hercegovinasi, Boshnjaku, Kroati edhe banuesi i Alpevet Lindorë fizikisht na japin shenjat e racës Iliriane e jo slave, me gjithë që janë sllavizuem krejtësisht si nga gjuha ashtu edhe nga zakonet. Këta sot si mbas anstropologëvet má të përmendun, i përkasin racës Iliriane, e cila po quhet edhe racë dinarike.

Karakteristikat fizike të kësaj race që e bajnë këte të dallohet nga të tjerat, janë: shkurtësija e asaj pjese të kokës, që mbulohet me flokë, gjatësija e rregulltë e fytyrës, gjatësija e shqueme e trupit, të qenunit e syvet dhe të flokëvet në ngjyrë të mbyllët (si të gështenjt). Cilësit dhe karakterët shpirtnore të kësaj rase janë: drejtësija, dëshira për trimëni, kryenaltësija kombëtare, dashurnija për vend e atdhe etj..

Na, Shqiptarët përgjithësisht i kemi rrujtun të gjitha cilësinat e racës s'onë, vetëm në disa vende gjendja klimatike edhe gjeografike na kanë shkaktuem disa ndryshime të vogla trupore edhe shpirtnore. Shqiptari i krahinavet moçalike të Shqipnís s'Ulët në krahasim me atë të malsívet me klimë të shëndoshë ka pak ndryshime trupore; po kështu ai i Jugës e i krahinavet afër detit, në krahasim me atë të veriut e të anëvet të mbrendëshme,



ndryshon pak në cilësit tregtare e inisiative. Karakteristikat fizike të popullit të Shqipnis s'Ulët moçalike nuk kallzojnë se ky i përket një race tjetër, por këto na vërtetojnë influencën e klimës mbi banorin e atyne visevet të Shqipnis. Cilësija tregtare e Shqiptarëve të jugës edhe të krahinave detike spjegohet me gjindjen gjeografike, që u ka pasë lejuem këtyne me ardhun në lidhje me botën tregtare të jashtme më përpara se Shqiptarët e krahinave veriake e të mbrendëshme.

2. Fiset e Shqipnis, veshjet dhe ndryshimet e tjera ndërmjet 'tyne.

Shqipnija me gjithë që është tepër e vogël, populli i saj ndahet në shumë fise, të cilët ndryshojnë nga një-tjetri në dialekt edhe në veshje. Këta ndryshime nuk rrjedhin vetëm pse këta fise rrojnë larg një-tjetrit. Në Shqipni ka fise të cilët me gjithë që rrojnë afër një-tjetrit kanë cilësina shpirtnore të përkundërta. Kjo përçarje e madhe në Shqipnin e vogël ka rrjedhur nga natyra e vendit dhe nga formimi i malevet, që shpeshë herë përbëledhin në gjinin e 'tyne krahina të papërshkueshme edhe krejt të vetmueme. Përvec kësaj nuk duhen me u-haruem edhe rrethânat historike.

Gjykoni jetën shqiptare në kohën e Mesme edhe në kohën e sundimit të Turqis! Pushtuesit për me shtruem mirë vendin me ç'mënyrë futshin grindje ndërmjet kryetarëve të fisevet? A kishte mjete marrëdhane (komunikasione) ndërmjet krahinave të ndryshme atëherë?

Përgjithënisht populli i Shqipnis ndahet më dy fise kryesore, në Gegë e në Toskë. Këta të fundit ndahen prap në dy: Labët edhe Toskët e vërtetë. Kufinin ndërmjet Gegënis e Toskënis e formon pothue Shkumbini.

Përpara në Shqipni populli ndahesh në shumë fise të vogla dhe gjithë se cili sundohesh prej një të pari të vet,



që ishte kryetar ose bajraktar i pajosun me të drejtat e gjygtarit.

Shqipnija e V. me até të J. ndryshojnë pak me zakonet që ka populli i se cilës pjesë. Toskët edhe Gegët kryesisht dallohen në djalekt (të folme). Toskët nuk mund t'i flasin zanoret hundore të Gegëvet; —N— e gegënishtës në shumë raste bâhet —R— në Tosknishtët. Ky ndryshim djalektuer i Toskëvet me Gegët, në krahasim me ndryshimin djalektuer të fisevet të kombevet të tjerë, mbetet fare pa rëndësi.

Ndryshimi i jashtëm mâ i dukëshëm, ndërmjet Gegëvet edhe Toskëvet është në veshjet dhe mâ tepër në kofsharët (shallvarët). Toskët bajnë kësosh të ngushta ke gjunjt dhe me çarapë të gjatë. Mbasandaj i dallon këta mangoreja me këmishën e gjânë; përpara ishte edhe fustanja, por tash është tue humbun dhe vishet vetëm në raste festash.

Veshja e Shqiptarëvet të Shqipnis së Mesme karakterizohet me shallvarët e gjânë, me jakucen xhufkore edhe me brezin, dhe e t' atyne të Veriut me kofsharët e ngushtë, që janë robe mâ origjinale e gegëvet.

Roben e jashtme populli e bân prej leshit të vendit, kurse të lintat (robet e mbrendëshme), me shumicë prej pëlhuravet t'ardhun së jashtmi. Importimi i math i këtyne (4 fr. ari për kokë në vit) dëfton qartazi se rrobot kombëtare po vijnë gjithënji tue na humbun. Po kështu është edhe gjendja e mjeshtrëvet të punës së dorës. Edhe kjo dëften se na Shqiptarët jemi tue i këthyem shpindën së vjetrës; për fat të keq ndër në mjeshtrit e punës së dorës, që dikurë patën qenë shumë naltë e në lulëzim, sot janë tue humbun; p. sh. mjeshtriya e pëlhuravet të mundafshhta, mjeshtriya e qylymavet, e ajo e të skalitunit të dërrasavet, argjantariya, armëtariya etj.. etj.. në kohët t'ona ranë shumë poshtë.

Ç'detyrë kemi në të përmbushunit e të metavet të përmenduna në këte kapitlë edhe si mund t'ia mbërrijmë qëllimit të shenjtë?



3. Sasija edhe shpeshësija e popullsis

Numuri i popullit Shqiptar nuk është aqë i pakët; gjithësejt janë 3,350.000 frymë që flasin shqip (1).

Prej këtyneve vetëm afër 1,100.000 formojnë popullsin e Mbretnis s' onë edhe rrojnë të lirë, mbrenda kufijvet të caktuem padrejtësisht nga fuqit e mëdha në konferencën e Londonit me 1913.

Vëllaznit e tjerë me shumicë i kemi nëpër pjesat e Shqipnis së Robnueme edhe nëpër vende të largëta, ku kanë shkuem si emigrantë për nevojë politike ose ekonomike. Këta gjinden të përndamë kështu:

1,200.000 ndën sundimin e Jugoslavis (pjesat e krahinavet të robnueme të Kosovës e të Manastirit.)

500.000 ndën sundimin e Greqis, Shqiptarët e vjetër t' atjeshëm t' ujdhesavet e të visevet të tjera bashkë me ata të Shqipnis së Robnueme, në këte anë, të Janinës, të Çamëris etj.

200.000 n' Itali (Kalabri, Siceli etj.)

250.000 në Turqi t' emigruem përpara edhe mbas luftës Ballkanike e Botnore.

50.000 t' emigruem n' Amerikë për nevojë ekonomike.

50.000 „ në Ruman, Egjypt, Bullgari etj. po për nevojë ekonomike.

Prej këtij shpjegimi kuptohet se një shumicë e madhe e vëllazënvet t' anë rron në grumbuj të përndamë ndër vende të ndryshëm; por ata të Shqipnis së Robnueme po gjinden në rrezik të humbjës mbassi ndodhen në një shkallë shumë t' ulët arësimore e shoqnore edhe mbassi nuk kanë lirin e arësimit në gjuhën amtare.

Shqiptarët, që përbajnë një pjesë të popullsis së Greqis së Mesme lindore, me gjithë që deri më sot e kanë rrujtun gjuhën amtare, mjerisht janë pajtisun nationalitetit Grek plotësisht. Përveç këtyne edhe Shqiptarët e Italis,

(1) Shikoni librin „Pritmi i Shqipnis“ prej Lumo Skendo faqe 6-7!



të cilët u-aratisën atje me t'ardhunit e Turqëvet në Shqipni, në shekullin XV—XVI, e u-vendosën në Kalabri, në Siceli etj., dita me ditë po vijnë mjerisht tue haruem kombësin e 'tyne.

Shqiptarët e emigruem n' Amerikë e gjetiu kanë një organizim shoqënuer e kombëtar që i mbanë të gjallë e jasht rrezikut të çkombëtarizmit. Prej këtyne, që janë afro 100.000 frymë, disa këthejnë n' atdhe por vendin e 'tyne e zanë prap emigrantët e tjerë.

Na 1,100.000 banorë të Shqipnis së Lirë të përndamë në një sipërfaqe prej 28.388 km²; kemi një shpeshës mezzatare afër 39 veta në një kilometrë katrorë, kështu që në krahasim me shpeshësin mezzatare të gadishullit të Ballkanit, që është pothuë 48 veta në km²., jemi prapa.

Tokat t' ona shumë pjellore mund t' ushqejnë një popullsi shumë më të shpeshët e ndoshta tre fishin e të sotshmes, porse të randuemit e zgjedhavit të hueja në shekujt e kaluem, të përhapunit e gjithë farë sëmundjevet faruese ndër popullsinë (si malarja etj.) edhe mungesat e të metat të tjera shoqnore na kanë shkaktuem jo vetëm një mosshtim, por edhe një paksim në numurin e popullsis ndër nâ. Kjo, fatkeqsisht, është një dukuni në Shqipni t' onë të soçme por nuk gjanë të këtë qenë gjithnji në këtë masë e fort e fort në kohnat e lulëzimit të qyteteve të vjetër, si Apollonia (Pojani), Epidamnos ose Dyrrachium (Durrësi) Butrintos (Butrinti) etj...

Përpjekjet që ka filluem Shteti i ynë të baje për përmirësimin e kësaj gjendjeje, lumnisht filluen me dhane frute të dukëshme e të gëzueshme.

Polni mbi të përndamit e popullsis në Shqipni e Lirë tue dëftuem se ku bijnë më me shpeshësi!

4. Banesat katundare edhe katundet

Banesa e bujkut Shqiptar përgjithënisht është e madhe; pothuë në të gjitha pjesat e Shqipnis ndodhet sis-



tema e familjes së madhe të përbame prej shumë njerëzish, të cilët rrojnë me një ekonomi të përbashkët. Shtëpia e një bujkut përbàhet prej shumë ndërtesash të rrethueme me mure guri edhe nëpër vende pyjore me gjer dhe druni. Nëpër katundet e Shqipnis nuk ka një rregull të përbashkët, në mënyrën e ndërtimit të shtëpijave; secili bujk shton ndërtesa rreth oborrit të vet si mbas nevojës edhe si mbas shtimit të familjes dhe kështu dalë nga dalë formohet pothuë një katund me një oborr.

Në shumë krahina gjinden edhe shtëpia të vetmueme e larg njana tjetrës¹⁾. Mënyra e banesës edhe e formimit të fshatnavet në Shqipni varet simbas të trajtuemit të sipërfaqes edhe mbas gjindjes s'ujnavet. Vendet e përçame tepër e detyrojnë fshatarin të banojë vetëm e larg shokut dhe shpeshë herë, ku gjindet ndonji burim uji i vetëm dhe i math aty pranë përmbëlidhen disa shtëpia edhe kështu formohet një katund.

Shtëpijat e ndryshme të bujqëvet kanë trajtën e një prizme, që rri i shtrimë edhe pullazin nuk e ka aqë të pjerrët. Këto shtëpia kanë nga një pjesë përdhecke t'ullët edhe nga një pjesë të naltë; dritaret i kanë shumë të vogla, të cilat janë me xhama vetëm ndër të pasunit. Shumë herë kati i sipërmë ka edhe një nimë (qoshk) apo çardak edhe pjesa e poshtme përdoret për bagëti, për fllanik (= vendi ku punohet bylmeti) edhe për amvizëni. Për këto qëllime shpeshë herë bujku ndreq ndërtesa të veçanta dhe t'ulta.

Në shumë oborre përmbëlidhen ndërtesat tok dhe nganjherë, kur ndodhë ndonji kullë në mest, apin pamjen e një kështjelle.

«Shqipnija e Lirë ka 2578 katunde, të mëdhenj edhe të vegjël».

Mënyra e jetesës së katundarit t'onë, mbrenda në

¹⁾ Katundet që ndodhen në brezin e dushqevet janë me shtëpia të përnda me, larg njana tjetrës; popullajia e këtyneve merret me bujqësi edhe me blegtori. Katundet e fshavet, të luginavet si edhe të pllajavet e të luginavet të brezit t'ahishtavet janë me shtëpia të grumbullueme afër njana tjetrës; populli këtu merret kryesisht me bujqësi ose me blegtori.



shtëpín e 'tij, nga pikëpamja e ushqimit, pastërtisë, t'ajruemit edhe të shtruemit të dhomavet, në shumë pjesa të Shqipnís kërkon një përmirësim ranjues!

5. Qytetet edhe roli i 'tyne

Trajta e sipërfaqës së Shqipnís ka shkaktuem formimin e shumë qyteteve, të cilët ndryshojnë njani prej tjetrit dhe çojnë një jetë më vehte. Mungesa e madhe në mjettet marrëdhanore e ka shtuem më tepër të vetmuemit e krahinavet të ndryshme. Këto krahina bujqësore kanë nevojë për qendra, në të cilat shvillohet jeta politike edhe mjeshtrorë. Në këto katundari gjen vend për t'u shitun rrethet të tjera prodhimet e veta dhe për me blemë çka i nevojitet. Qytetet e Shqipnís me gjithë që janë shumë të vegjël, këte rol e luejnë plotësisht. Krahinat e influencës së 'tyne apin bazën për ndarjen politike e administrative të vendit.

Shqipnija, administrativisht, ndahet në prefektura, në nënprefektura edhe në katundarí apo komuna.

Shqipnija është e ndame në dhjetë prefektura. Në krahinat detike marrin pjesë prej veriut në jugë prefekturat: Shkodër, Durrës, Tiranë, Elbasan, Berat, Vlonë edhe Gjinokastër. Krejt fellë në Shqipnín e Mbrendëshme përmbledhen prefekturat: Kosovë (qendra Kukës), Dibër (Peshkopí) edhe Korçë.

Prefekturat përmbledhin pothuë të gjitha krahinat ekonomike, mbas së cilavet i kanë marrë emnat e 'tyne. Më të shumtat prej këtyne prefekturave përmbledhin fushat e Shqipnís s' Ulët edhe zgjaten përmbrenda në Shqipnín e Naltë; me këte mënyrë shtinë në gjinin e 'tyne krahinat e ndryshme (fushë e malsí). Kjo gjá dëshmon bukur rolin ndërmjetsuer që luejnë qytetet t'onë ndërmjet malevet edhe fushavet.

Pjesën më me rëndësi të qyteteve t'ona e formon pazari. Ky përmbledh një shesh tregu dhe në qytete të



mdhenj disa sheshe. Në këta sheshe mbështillen katundarët dhe i shesin prodhimet e 'tyne, drith, djath, tëlyn, ve, zarzavate (qepë, hudhra, spec, domate etj.), pemë, ulli, gjà të gjalla, lesh, lëkura, mëshikza mundafshi, pël-hura etj. Rreth e qark sheshit gjinden dugajet e tregëtarvet. Nëpër këto blihet krypë, sheqer, kafe etj...; po këtu bujku shet prodhimet e veta dhe i mbulon nevojat e tij. Në Shqipni, qytetet formojnë ndërmjetsin e tregtis së jashtme. Po në pazar ndodhen edhe dugajet e mjesh-tërve të punës së dorës, si samarxhit, farkëtarët (kovaçët), nallbanët, këpucarët, robaqepësit, qeleshe-punuesit edhe furrat. Përveç kësaj afër sheshit të tregut ndodhen edhe hanet, garazhët ku gjejnë strehë karavanët edhe automobilat; mbandaj dallohen kafehanet edhe berberët.


Përgjithnisht në qytetet t'ona mbretnon një heshtje e qetësi e madhe, veç ditës së pazarit, ku ndihet një gjallni e jashtzakonshme. Dita e pazarit për rrethinat është një ndodhi me rëndësi. Në këte ditë, gjithë katundet mbesin si të shkretë, pse gjindja e 'tyne varet në qytet, në tregjet e të cilëvet vlon një britmë e një zhurmë e madhe e shitësvet edhe e blerësve, e çakiçavet të remtarëvet, të farkatarëvet, të teneqexhivet, të nalbanavet etj.

Mb' at' anë lagjës së pazarit fillojnë m'u zgjatun lagjet e 'tjera të shtëpijave me qetësi.

Mënyra e ndërtimit të shtëpijave, nëpër shumicën e qytetevet në bazë, është po ajo që mbretnon ndër katundet vetëm se, nëpër qytete pjesa e poshtme (përdhecke) përdoret për banim dhe pjesa e naltë përdoret për pritje e përcjellje miqsh.

Në disa qytete të Shqipnis Jugore gjindet një tip shtëpijash, që ia përngjan tipit të shtëpijave të Maqedonís. Ndër këto shtëpija pjesa e poshtme është e bame prej gurësh dhe ajo e sipërmja prej hatllavet (çatmavet).

Shqipnia e Ulët, me natyrën e 'saj fushore, është e mbarë për zhvillimin e shumë qytetevet, kurse Shqipnija e Naltë, përveç pjesave të 'saj fushore edhe luginore, nuk është e mbarë për këte punë.



Të ndamet administratore, qytetet, sasija e vendësve edhe madhësia në km² të prefekturavet.

I. PREFEKTURA E SHKODRËS

Prefektura e Shkodrës në pikëpamjen administrative ndahet në këto nënprefektura: Shkodra (si rreth i qendrës) *), Malsia e Madhe, Leshi, Mirdita, Puka edhe Dukagjini tue pasë gjithsejt 35 komuna, 339 katunde, një popullsi prej 135.000 frymësh edhe tue përshimun një sipërfaqe prej 4870,20 kilometrash katrore.

1. Shkodra (25.000 vendës) është qendra e prefekturës me këte emën; gjindet në jugë të fushës së Shtojit, ku shhtrihet me një gjatësi 3 kilometrash ndërmjet bregut të djathtë të Kirit edhe kullotavet moçalike, që rrethojnë liqenin e Shkodrës nga jugë-lindja.

Qyteti për së gjati përshkohet prej një rruge të quejtun Udha e Madhe, në mes të së cilës ndodhet pallati i Prefekturës, Bashkija, Kazermat, Gjymnazi Shtetnuer edhe magazinat e ndërtesat më moderne. Pothue paralel me këte rrugë, në dy anët e 'saj, përmbrenda qytetit, shtrihen edhe dy rrugë kryesore: Udha e Dukagjinit edhe Udha e Skanderbegut, të cilat, me udhët e ndryshme, lidhen me Udhën e Madhe.

Gjithë këto rrugë të ndërtueme fort mirë rrethohen me ndërtesa të bukura, të cilat i apin Shkodrës fytyrën e një qyteti të vërtetë.

Lagjet veri-lindore të qytetit shumë herë janë rrezikuem nga vërshimi i Kirit, por tash, me të goditunit e një pendës (murit) së madhe, ky rrezik i u-hoq krejt.

Shkodra e ndodhun në vendin, ku pjekin krahinat malësore me krahinat fushore të 'saj, luen rrolin krye-

*) Prefektat në rrethin e qendrës së prefekturës e bajnë punën e nënprefektavet. Të ndamet e komandavet të gjindarmeris në çdo prefekturë në komandën e qarkut e në komandën e rrethit, na spjegojnë më mirë këte punë.



suer si qendër shkëmbimi për prodhimet e atyne viseve me natyra të ndryshme. Veç kësaj, kjo, e lidhme me Adriatikun me ânën e Bunës (i vetmi lum i lundrueshëm i Shqipnís) edhe me Jugosllavín me anë të liqenit e të rrugës së Koplikut, ka një pozitë tepër të randësishme edhe për tregtin t'onë të jashtme, e cila këtu kap afër 4 M. ¹⁾ fr. ari në vit edhe e rendit këte me një herë mbas Sarandës. Madhësija e tregjevet të 'saj na e provon këte gjá.

Tregu ose Pazari i Shkodrës. — Ky treg gjindet përjashta qytetit, 1 km. 700 m. nga jugë-perëndimi edhe shtrihet së gjati ndërmjet kodrës së Kështjellës Rosafat e Bunës. Ky treg dikurë pat qenë má i randësishmi i të gjithë tregjeve t'Europës Tyrke; por tash, për shkaqet e ndryshme, që kemi me i pamë má poshtë, e ka humbun randësin e parë. Me gjithë që qe damtuem prej tërmetevë, që ranë më 1894 edhe më 1913, ky edhe sot na çfaqë typin má të bukur të pazarevet t'ona má të lulëzueme. Rruga e Tiranës e përshkon këte pazar në një pjesë të madhe; veç kësaj edhe shumë rrugica të tjera, të rrethueme me dugajë të ndreqme, e përçajnë ânë e mb'ânë tue pasun se cila një farë tregtije e zanati të veçantë, si me thanë: rruga e mishtarëvet, peshkatarëvet, zdrukëthtarëvet, prestarëvet (rrobaqepësvet), argjendarëvet etj... Në këte pazar gjindet një medrese me një bibliotekë të vjetër. Pranë pazarit, në buzë të Bunës, ndodhet zyra e doganës edhe stasjoni i vaporevet, që kryejnë shërbimin e lundrimit me Shingjinin (porta e Shkodrës) edhe me Virpazarin e Rjekën (në Jugosllavi, buzë liqenit).

Shkodra e sotshme me 25.000 vendës áshht një hije e një të shkuemes má të shkëlqyeshme. Në kohën e luftës qe bá me 40.000 vendës edhe pat filluem me mbledhë vehten e me ia përngjamë asaj së vjetrës. Rrethi i influencës tregtare të këtij qyteti dikurë shtrihesh fellë nëpër krahinat e mbrendëshme të Kosovës e të Maqedonís, por me të ndrequnit e hekurudhës së Selanikut, që i shtrini degat e veta n'ato vise edhe me të mbetu-

¹⁾ M. = Milionë.

nit e Kosovës ndën sundimin e huej, ky rreth i u-ngush-tue fort.

Këto pra janë shkaqet e të ranunit të këtij qyteti nga shkëlqimi e lulëzimi ekonomik i dikurshëm.

Shkodra, si qytet i vjetër, e njoftme me emnin Scodra, qysh tre shekuj para Kr., nuk ishte mb'ate vend, ku ndodhet sot, por mâ nga jugë-perëndimi, rreth e përçark kodrës së Kështjellit Rozafat, ku gjindet sot tregu edhe lagjet Ajazma e Qafa. Të ndrruemit vend të qytetit ngjau në shekullin e XIX-të.

Ky qytet pat lulëzuar me shekuj rradhë si kryeqy-qytet' i Ilirianvet. Këte lulëzim e rrejti edhe pastaj, jo vetëm në kohën e Romanvet, Bizantinvet, Balshajvet e Venedikasvet, por edhe në kohën e sundimit të Turqvet, kur ishte si kryevend i vilajetit me emnin e vet.

Shkodra, e forcuar me kështjella të forta, ka pa-më luftime të rrepta në çdo ndrrim sundimi, sidomos ato të 1479-tës, data e të hymit të Tyrqvet këtu, të 1788-tës, data e të thyemit të Tyrqvet prej Kara Mahmut Bushatit edhe ato të 1912—13-tës, data e të dalunit të Tyrqvet prej këndeje, kanë qenë me të vërtetë të tmershme.

Shkodra, si në kohnat e vjetra ashtu edhe mâ vonë, deri në ditët t'ona, ka pasë një randësi tepër të madhe në historin t'onë kombtare. Kjo, si thamë, në kohnat e lashta qe kryeqyteti i Ilirianvet edhe në kohnat mâ të vona, në shekullin e XVIII-të, qe kryeqyteti i Bushatasvet (Kara Mahmut Pasha edhe Mustafa Pasha), të cilët mâ se një gjymës shekulli e patën sunduar krejt Shqip-nin e Veriut deri te Shkumbini. Por edhe në historin e ré të zgjimit të rilindjes s'onë kombtare, Shkodra zen një vend kryesuer si qendër e zhvillimit të gjuhës s'onë amtare, e cila mësohesh këtu mâ parë se në çdo qytet tjetër, si qendër atdhetarizme e burrnije shqiptare tue u-bâmë kurdoherë si mburojë kreshnike kundra sulmimvet të rrepta të Malazesvet, që lakmojshin trojet t'ona arbnore edhe si vend-lindja e Hodo Pashë Bushatit, që ishte një shtyllë e fortë e Lidhjes së Prizrendit edhe e



Vaso Pashë Shkodranit, që është një nga apostojt e zgjimit t' onë kombtar, bashkëpunues i Sami bej Frashërit edhe i Jan Vretos.

Sot në Shkodër, përveç bukurivet të natyrës në rrethinat, bijnë në sy së pari Kështjella Rozafat, në të hymit në treg, në majen e një kodre (133 m.), që ndan Bunën prej Kirit; xhamija e Plumbit, në rranzë të Kështjellës, në lagjen Qafa, e goditme më 1768 prej Mehmet Bushatit, edhe tregu; mbasandaj mbrenda në qytet pallati i bukur i Prefekturës edhe shumë ndërtesa të tjera madhështore.


Shkodra ka një central elektrik, 3 fabrika mielli (njana edhe për pasta e shehrije), një fabrikë alkooli, 2 fabrika duhani: Tarabosh, Stamles (= Samas), një fabrikë çemente, një fabrikë sapuni e parfumerije edhe një regjtoje lëkurash në katundin Zogaj pranë liqenit; zoganjarrët punojnë edhe qylymat e Shkodrës.

Gjendja arsimore e qytetit është mjaft e pëlqyeshme; këtu ndodhen, veç dy foshnjoret edhe shumë shkollat fillore, Konvikti Malet t' ona edhe Gjymnazi Shtetnuer.

2. **Shiroka** (500 vendës), një katund peshkatarësh me pamje e me vende dëfrimi fort të bukura, ndodhet në buzë të liqenit vetëm 4 km. larg urës së Bunës.

3. **Kopliku** (1500 vendës) është qendra e nënprefekturës së Malsis Madhe; ndodhet në mes të fushës pjellore me emnin e vet, mbi rrugën, që lësh Shkodrën me Jugosllavin.

4. **Leshi**, qendër nënprefekturë për katundet e rrethit të vet e të Mirditës; ka vetëm 800 banorë; përshkohet prej rrugës Tiranë-Shkodër, lidhet me limanin e vogël të Shingjinit me anë të një rruge 7 km. e 700 m; është qytet shumë i vogël e malarik (shkaku?), por randësin historike e ka të madhe. Si qytet shumë i vjeter në rranzë të një kështjelle të moçme, Leshi njëfesh qysh në të katërtin shekull p. Kr. me emnin Lissus; këtu ka vdekun edhe është



vorruem i Madhi Heroi Yn Kombtar, Skanderbeu me 14 Kallnuer 1467.

Në kohnat e vjetra Leshi piqte me detin dhe kishte një randësi tregtare me limanin e 'tij të bukur, por lymnat, e sjelluna prej Drinit, e mbushën këte liman dalë nga dalë tue larguem detin prej këtij afër 4 km.

5. **Ungrej**, qendra e nënprefekturës së Mirditës, është një katund i vogël me 400 vendës; ndodhet në krahun e djathtë të përroit Dibri, që është kamba e Fanit. Në këte vend që nxjerrun shumë argjend në periodat e ndryshme të kohës së vjetër edhe mesjetare. Gërmadhat e kështjellës në Vig (kalaja e qytezës në Kalor) dëshmojnë madhësinë edhe shkëlqimin, që ka pasun ky vend dikurë.

6. **Oroshi** (1100 vendës) një katund i math i Mirditës, ndodhet në rranzë të Malit të Shenjt (1485 m.) edhe, si kryevend i Malsis s' Oroshit, formon pikën qendrore të mirditasvet. Këtu pranë ndodhen gërmadhat e shtëpis së kapitanit të Mirditës, të rrenueme prej Turqvet.

Oroshi përmendet edhe si vendlindja e Prend Doqit edhe e Preng Bibdodës, dy fytyra të çmueshme në historinë t'onë kombtare.

N' Orosh gjindet një internat filluer.

7. **Puka** (500 vendës), është qendra e nënprefekturës me këte emën; ndodhet në rranzën veriake të bjeshkëvet të Terbunit, afër burimevet të Gomsiqes. Rruga e karvanet, që shkon ndërmjet Vaut të Spasit e Vaut Dejës për me lidhë Kosovën me Shkodrën, kapërcen këndeje.

Nëpër rrethinat e Pukës gjinden disa katunde që janë qendra të vjetra historike si: Kabashi, që ka qenë kryevendi i Lek Dukagjinit; ende sot shifen këtu gërmadhat e pallatet të këtij Princi; Komoni mbi Drinin me gërmadhat e fortesavet e të kishavet të Dalmatianvet e me një vend të gjanë të vorrezëvet të kohës para Krishtit; Iballa (900



vendës), me fortesat e Xhullijvet edhe Vaspasi me gërmadhat e fortesës së Lek Dukagjinit.

8. **Kodra Shingjergj**, qendra e nënprefekturës së Dukagjinit, është një katund i vogël, gjindet afër vendit, ku bashkohet lumi i Nikajt me kambën e 'tij Geraj, në rranzë të Malit Korja e Rajës (1750 m.).

Shënim. — Shkodra, me anë të një rruge automobilash 120½ km. që shkon nëpër Lesh, lidhet me Tiranën.

Vizioni kartën e kësaj prefekturë tue tregue vendet gjeografikë të mësuem më nalt edhe emnat e prefekturavet, me të cilat rrethohet!

II. PREFEKTURA E TIRANËS

Prefektura e Tiranës në qarkun administrativ të 'saj nuk ka nënprefektura, por ka vetëm 7 komuna 110 katunde, një popullsi prej 60.000 frymësh edhe një sipërfaqe prej 850,20 km².

Tirana, kryeqyteti i Mbretnis s'onë Shqiptare, është një qytet i ri, por fort i bukur në mes të fushës, që thirret me emnin e vet; rrethohet me kopshte të punueme, me kodrina të bukura e sidomos me Dajtin madhështor nga lindja, që ia shtojnë hijeshin e pamjeve të 'saj tërheqëse.

Tirana përpara ishte një qytet i thjeshtë, por, porsa u-bâ kryeqytet, dita me ditë erth tue u-smadhuem e zbukuruem.

Numuri i vendësve të 'saj, që më 1920 ishte vetëm 8000 frymë, sot i u-katërfishue, d. m. th. i u-bâ 35.000.

Me të hapunit e me të zgjanuemit e rrugëvet e bulevardevet mbas planit më të ri edhe me ndërtimin e ndërtesave zyrtare, private e tregtare, kryeqyteti i ynë muer fytyrën e një qyteti modern me kuptimin e plotë të fjalës.

Kjo, qysh sa u-themelue prej Sulejman bej Mulletit në fillimin e shekullit XVII-të tue u-pagëzue prej 'tij me








Fig. 37. - Lesh

(Fot. Shqipnija e Illustrueme)






Fyt. 38. - Shkodra




Fyt. 39. - Tirana.
Pamja e përgjithëshme e Kryeqytetit





Fyt. 40 - Një rrugë kryesore në Tiranë



Fyt. 41 - Hotel Park në Lixhën e Elbasanit

ΒΑΙΟΓΡΑΦΙΚΗ ΕΠΙΧΕΙΡΗΣΗ
ΤΑΝΕΛΛΗ



Fig. 42. - Durres

(Fot. Shqipnija e Illustrueme)

emnin Tiranë, për kujtim të Tehranit të Persís, ku ai kishte pasë fituem një luftë, nga pozita e bukur e vendit të 'saj, zu të lulëzojë me një herë.

Me të vërtetë pozita e Tiranës është tepër natyrore edhe i përmbledh të gjitha kushtet, që i don Zhvillimi i një qyteti të math. Udhët e ndryshme, që lidhin Shqipnín e Mbrendëshme të kësaj ane me Shqipnín e Ulët detike, varen nëpër gryka, qafa dhe lugina të shumta edhe kryqzohen këtu në vendin ku është ngrefun Tirana, e cila edhe përpara se me u-caktuem definitivisht si kryeqytet (31 Kallnuer 1925), që e zonja me luejtun rolin e 'saj, si gjithë qytetet e tjerë më kryesorë të Shqipnís, si një qendër shkëmbimi për prodhimet e dy krahinave me natyrë të ndryshme edhe kështu me e shtrimun rrethin e influencës tregtare të 'saj si në fushë ashtu edhe në malsina të fella.

Natyrisht Tirana e soçme, si me shumicën e njerëzvet, ashtu edhe me shumicën e uzinave të fabrikave të vogla, na çfaqet me një pamje më të gjallë; ka një central të math elektrik, një fabrikë të madhe tjegullash, 3 fabrika zdrukthtarije, shumë fabrika mielli, disa uzina për punimet e hekurit, 2 fabrika akulli edhe 6 shtypshkronja.

Vizituesi, në kryeqytetin t'onë plot gjallësi, shef pallatet Mbretnorë, pallatet e ministrive, pallatin e Parlamentit, të Bashkís, Spitalin Ushtarak e Civil, Xhamit e vjetra me randësi arkeologjike, kullën e Orës (sahatit), tregun e zbukuruem në qendrën e qytetit edhe shumë e shumë ndërtesa të tjera madhështore. Veç këtyne ka edhe Muzeumin e Bibliothekën Kombtare.

Ndër institutet arsimore të këtushme bien në sy Shkolla Mbretnore, Gjymnazi Shtetnuer, Shkolla Teknike me degë bujqësore e teknike, Normaleja femnore e Naim Frashërit edhe shumë shkolla fillore të tjera.

„Një gojëdhënë mbi historinë e të ngrefunit e t'emnit të Tiranës 1).
Në vend të Tiranës së soçme gjindesh Tirana e vjetër. Kjo ishte prishë edhe vendi i ishte mbuluem me pyll.

1) Këte gojëdhënë e kam shkruem në Pëtrellë prej gojës së disa pleqvet më 30/VII/1922.



Pëtrela (600 vendës) qendër komune, ndodhet në jugë të Tiranës, 10 kilometra larg saj, në bregun e majtë t'Erzenit, mbi kodrinat shkambore të Krrabës, që ulen në luginën e këtij lumi. Ky katund përmendet me gërmadhat e kështjellës historike, e cila qe forcue prej Skenderbeut për ta rrujtun rrugën Tiranë—Elbasan. Këtu ndodhet vorri i Ballaban Pashës, i cili ka qenë kryekomandant i Mehmetit të II-të në rrethimin e Krujës.

Tirana si portë tregtare ka Durrësin, me të cilin lidhet me ânë të një rruge automobilash prej afër 39 km. të gjatë.

Vizioni hartën e kësaj prefekturë, shënoni vendet gjeografikë edhe kufit me prefekturat e tjera!

III. PREFEKTURA E DURRËSIT

Prefektura e Durrësit në pikëpamjen administrative ndahet në këto Nënprefektura: Durrësi (si rreth i qendrës), Kruja, Shijaku edhe Kavaja tue pasë gjithsejt 13 komu-

Sulejman beu, nga Mulleti, kishte pasë një bari dhensh, i cili një natë shef një andër se sikur dielli i kishte hypun në supin e djathtë edhe hâna mbi të majtin. Me të gëdhimet nesërejt, andrën e çuditshme ia rrëfeu Zotnis, i cili i tha: „nuk bân të rrijsh tek unë mâ, se ti, si më duket, do të bâhesh njeri i math“. Mbas këtyne fjalëve ia lau hesapin, edhe ai iku me paret në dorë në Stamboll. Aty mbas disa ditësh ishte çelë një luftë me Rusin (?). Në këtë luftë Mbreti e paska marrë këtë si vetë-dashës n'u-shtri. Ky, tue luftuem trimnisht, kishte fituem shumë grada edhe ishte bâ si shkaktar për fitimin e luftës.

Si u-fitue lufta, qe bâ Ministër i Luftës. Mbas disa kohësh ka çue një tatar (çostier) me dy kalorës, me urdhnin e Mbretit në dorë për me thirrë Sulejman beun me ardhë në Stamboll. Ky u-tremb shumë, mbassi nuk e dinte punën se përse ishte thirrë. Vojt pra me një herë në Stamboll, ku Mbreti edhe Ministri, me të marrmet vesht, e lânë me hy mbrenda në Sarajet, ku ndodheshin në një mbledhje edhe ministrat e tjerë. Kur hyni mbrenda ky, s'njifte as njeri, por bariu i vjetër i dëfteu një vend, tue i bëzajtë me emën edhe u kallzoi Mbretit e Ministravet në gjuhën, që ai s'e kuptonte, historin e jetës së vet në kohnat e kalueme, d. m. th. kur ishte bariu i Sulejman beut..

Si duelën prej këndej, Ministri e muer këtë edhe së bashku shkuen

na, 181 katunde, një popullsi prej afër 80.000 frymësh, tue përfshimun një sipërfaqe prej 2.445,90 km².

1. Durrësi sot është e para portë tregtije e Shqipnís¹⁾ me 6000 vendës, por randësin historike e ka më të madhe se çdo qytet i Shqipnís. Asht themeluar më 617 p. Kr. me emnin Epidamne; në kohën e pushtimit Roman e muer emnin Dyrrachium. Prej këtu fillonte «Via Egnatia»²⁾, që shkonte deri në Bizanc (Stamboll).

Më 48 p. Kr. qe bënë sheshi i luftimit ndërmjet Cesar-it e Pompeus-it. Ka pasë më se 60.000 banorë në kohën e pushtimit Roman. Fortesat a kështjellën, që na paraqet sot i u-patën ngrefun në të VI-tin shekull prej Justinianit, perandorit të Bizancit, mbi gërmadhat e fortesavet më të moçme, që i ka pasun 12 shekuj më parë.

Durrësi edhe në historin t'onë të re ka luejt një rol


¹⁾ Sot pjesa më e madhe e tregtis s'onë së jashtme (më se 10 miliona fr. ari) kryhet me anë të portës së Durrësit.

²⁾ Këndo vija Egnatia.

në shtëpin e vet, e shtini në një odë përdhecke, ku i pat rrejtun e mëçefë plaçkat e barinís edhe i tha: a i njëf këto? — jo; po mue a më njëf? — edhe ty jof tha Sulejman beu. Mbasandaj Ministri zú t'i kallzoi punën.... e kështu, si u-njoftën mirë e si ndejtën disa kohë bashkë, shkuen një ditë te Mbreti. Si ndejtën pak edhe kur bënë me ikë, Mbreti e pyeti Beun e Mulletit se ç'dëshiron edhe ai i tha: s'due gjá, gjithë të mirat m'i ka falë Perëndija, por vetëm due të kem një ferman që të ngrefi një qytet, aty ku të jetë më mbarë. Si ndejti edhe disa ditë, Sulejman beu iku e erdhi në Mullet. Mbasandaj shkoi në vendin, ku gjindet sot Tirana, çeli një vend tue premë pyllin, ngrefi Xhamin e Vjetër të soçme, një Teqe, një shtëpi edhe një furrë.

Mbassi i ngrefi këto, u-këthye në shtëpi të vet, por, tue ardhë rru-gës, afër përroit të Lanës, gjeti një njeri, i cili, si i pa punë qi ishte, lunte me ranë tue e hjedhë këte nëpër ndërmjetzat e gishtavet të dorës. Kur e pyeti atë se ç'bante aty, ai i u përgjegj: — *jam tue tjerrë ranë*, edhe Sulejman beu, mbassi ishte në mejtim e tue blsedue me shokë për emnin e qytetit të ri, i habitun krejt prej përgjegjës s'atij të panjofitunit, përnjiherë u tha shokëvet se emni i këtij qyteti do të jetë *Tir-ranë*, prej ku mbasanej u-bá *Tiranë*.

Qyteti u-banue e u-smadhue prej banorëvet të shpërngulun nga rrethinat. Vorri i Sulejman beut edhe sot gjindet afër Xhamís së Vjetër*.



të posaçëm, ka qenë dy herë (më 1914 edhe më 1919) kryeqyteti i Shqipnís, por në të dy herat për një kohë të shkurtën.

Ndreqjet, që janë tue u-bâmë si mbrenda në qytet (bulevardi i bukur etj.) si edhe në limanin e këtij qyteti, do t'ia rrisin rëndësinë ekonomike edhe mâ. Nalt mbi kodrën, në rranzë të së cilës ndodhet Durrësi, është ngrefun me hijeshí e me madhështí Pallati Mbretnuer.


Durrësi ka një central elektrik, dy fabrika mielli, nga të cilat njëna është edhe për pasta e shehrije, një fabrikë duhani «Stamles» edhe një shtypshkrojë të madhe.

Ndër institutet e arësimit përveç shkollave fillore nuk ka ndonjë shkollë të mesme.

2. **Kruja**, qendër nënprefekturë me 4500 vendës, i shmangët rrugës Tiranë — Shkodër nga lindja vetëm 10 km. edhe ndodhet e ngrefun nalt (608 m.) mbi kodrinat shkambore, që varen prej vergut me emnin e vet; rrethohet me ullishta e kopshte pemësh gjithkah, sundon një orizont të gjanë edhe është plot me kujtime të historís s' onë kombtare.

Qysh në shekullin e XIII-të Kruja thirresh prej të huejvet me emnat Bistrum Arbanum edhe Albanopolis. Në të XIV-tin shekull që kryeqyteti i gjithë Shqipnís së Mesme, prej Shkumbinit deri në Mat, ku sundonte atëhere dera Shqiptare e Topejvet (Karl Topija!) edhe pak mâ vonë dera e Kastriotvet. Në fillimin e shekullit të XV pat ra në dorë të Tyrqvet (1410), por në mesin e këtij shekulli 1443, që marrë prap prej dorës së 'tyne e që bâ kryeqyteti i Skanderbeut.

Mbas vdekjes së Skanderbeut, ra në dorë të Venedikasvet e më 1478, mbas një qëndrimi trembdhjetë muejsh, ra prap në dorë të Tyrqvet, të cilët shfryjtën pezmetimet e humbjevet, që kishin pasun 25 vjet me rradhë tue e rrënuem plotësisht këtë qytet historik, i cili, me hapsinën e lagjevet, që ka sot edhe me gërmadhat e ndryshme, që na çfaqë si edhe me gojë dhanat e shumta kujto-



het se do të ketë pasë më se 10,000 shtëpija. Në rrethinat e Krujës ndodhen shumë tyrbe e teqe historike, por ajo e Sari Sallikut, që gjindet mbi malin shkambuer të Krujës (1176 m.), është më me randësi.

2. **Shijaku** me 2000 vendës, është një qytet i ri e i vogël, i cili po zgjanohet e po përparon dita me ditë nga pozita e bukur që ka mbi rrugën Durrës — Tiranë. Shijaku ka një central elektrik edhe një fabrikë mielli.

3. **Kavaja**, qytet me 7000 vendës ndodhet 20 km. larg Durrësit mbi rrugën Durrës — Elbasan. Ky qytet, i gjindun në mes të fushavet shumë pjellore, numrohet si një qendër bujqësore me randësi. Pritmi i Kavajës do të jetë tepër i shkëlqyeshëm në pikëpamjen bujqësore. Djathi edhe shtambat e Kavajës janë për t' u-përmendun.

Pranë Kavajës ndodhet kryporeja me randësi.

Në Kavajë ndodhen dy institute arsimore Shqiptaro-Amerikanë: Shkolla e Bujqësis për djem edhe shkolla e Ekonomis shtëpiake për vajzat, të dyja në malin e Robit, 7 km. në veri të qytetit.

Durrësi është edhe porta tregtare e Elbasanit, me të cilin lidhet me një rrugë automobilash 86½ km. të gjatë.

Vizioni hartën e kësaj prefekturë tue shënjuem gjithë vendet gjeografike përkatëse të mësueme deri tash si edhe emnat e prefekturavet, me të cilat rrethot kjo!

IV. PREFEKATURA E ELBASANIT

Prefektura e Elbasanit në pikëpamjen administrative ndahet në këto nënprefektura: Elbasani (si rreth i qendrës), Peqini edhe Gramshi tue pasë gjithsejt 18 komune, 320 katunde, një popullsi prej afër 115.000 vendës edhe një sipërfaqe prej 2954.90 km.

1. **Elbasani** (14.000 vendës), ndodhet në anën e djathtë të Shkumbinit, mb' atë vend ku fillon të zgjanohet lugina e



këtij lumi e të marri trajtën e një fushe të gjanë, e cila me gryka e me lugina përrejsh, lidhet me krahinat e ndryshme malësore të Shqipnis së Mbrendëshme. Elbasani, i vendosun në krye të kësaj fushe, mû në pikën ku kryqzohen rrugët e varuna prej malsinash, luen rolin kryesuer të një qyteti të math (porsi Shkodra e Tirana) si vend shkëmbimi i prodhimevet të ndryshëm të krahinavet malsore e fushore. Madhësija që ka tregu i këtij qyteti e provon këte gjâ. Ky qytet, i gjindun ndërmjet Gegënis e Toskënis, në çdo pikëpamje është si një urë natyrore për bashkimin e të dy anëve; këtu, tue ardhun në pjekje të përditëshme Toska me Gegën, është gatuem vetiut gjuha e âmbël e Elbasanit. Nëpër rrethinat e qytetit si në fushë ashtu edhe në kodra, shtrihen ullishtat në blerim të gjithëmonshëm, zbukurojnë qipshtet e perimevet. Mbrenda në qytet nëpër oborret e shtëpijave blerojnë për bukurí trupat e portokallavet, të limonavet e të pemëvet të gjithëfarëshme, që formojnë një pasje për ata, që i kanë. N' Elbasan grumbullohen prodhimet mâ të randësishme të rrethevet të veta si duhan, ulli, oriz, pambuk edhe pemë të çdo stine nga mâ të mirat e gjithë Shqipnis, të cilat exportohen nëpër qytetet e tjerë. Elbasani, me pozitën e bukur që ka mbi rrugën e lëvizshme, e cila lidhë Shqipnin e Mbrendëshme të jugës edhe krahinat e Dibrës me Durrësin e Tiranën, do të ketë një shkëlqim mâ të math në kohnat e ardhëshme. Si institut i arsimit të mesëm në këte qytet gjindet vetëm Shkolla Normale, e cila, e themelueme këtu qysh më 1909, është një nga institutet e arsimit kombtar mâ me randësi që ka Shqipnia.

N' Elbasan gjinden këto fabrika: fabrika e alkoolit, fabrika e vojtit e shumë mullij voji, dy mullî për të qëruemit e orizit, fabrika e miellit, fabrika Saide e duhanit edhe një shtypshkronjë. Pranë Elbasanit, mb' at' ânë Shkumbinit (13 km.), ndodhen banjat squfrore të quejtuna Llixha. Me mijë njerëz nga çdo ânë e Shqipnis vijnë në verë këtu e shërohen nga romatizma tue derdhun mjaft të holla



nëpër tregjet e këtij qyteti. Elbasani me anën e rrugës me pamje tepër madhështore e tërheqëse e cila e përshkon për së gjati qafën e vargun e Krrabës, lidhet edhe me Tiranën (58 km.).

«Në kohën e Romanvet Elbasani qe quejtun Scampa. Nëpër këte shkonte via Egnatia. Qyteti i moçëm ndodhesh mbrenda murevet të kalas, që edhe sot pjesësisht na çfaqin meremetimet e bâme prej Venedikasvet e prej Tyrqvet. Scampa qe rrënuem në kohën mesjetare prej barbarëvet e mâ fort prej Bullgarëvet. Mâ vonë më 1466 qe rindërtuem prej Sulltan Mehmetit II-të, i cili me ushtrít e forta kishte pasë ardhun me pushtuem Shqipnín. Qysh në këte kohë Scampa e Vjetëtër zû të quhet Elbasan. Edhe në kohën e Tyrqvet ky qytet pat marrë një zgjânim e lulëzim të posaçëm e qe bâmë një nga qytetet mâ të mdhej të Shqipnís në shekullin e XVII e XVIII por, si mbas gojdhana vet të shumta, qe rrënuem edhe një a dy herë të tjera prej sëmundjevet korrëse si kolerë, murtajë etj. Ky zgjânim i fundit, që kishte pasë Elbasani provohet edhe me rrugat e me gërmadhat e ndryshme, që i gjinden sot nëpër fushat e andyç nëpër kodrinat e bukura të rrethit të vet. Elbasani edhe në lëvizjet për zgjimin t' onë kombtar ka dëftuem një gjallëni të posaçme, si vend-lindja e Dhaskal Todërit edhe e Kristoforidhit edhe si qendër e Kongresit të 1909-ës, i cili vendosi të hapunit e Shkollës Normale».

Elbasani është qendra e prefekturës me këte emën. Kësaj prefekturë i lidhen dy nënprefektura: Peqini edhe Gramshi.

1. **Peqini me 2000** vendës, qendër nënprefekturë, është një qytet i vogël, që ndodhet mbi rrugën Elbasan-Durrës, në të djathtë të Shkumbinit. Përmendet me ullishtat e orizoret e bukura. Ndodhet i ndërtuem pjesësisht mbi gërmadhat e Claudiana-s së moçme, e cila ishte si stasjon Roman mbi Vijën Egnatia. Xhamija edhe kulla e orës së këtij qyteti kanë një styl shumë të bukur.



2. **Gramshi**, një katund me 500 frymë, ndodhet në krah të djathtë të Devollit edhe lidhet me Elbasanin me anën e një rruge automobilash prej 43 km.

Rruga Durrës-Elbasan, në Rrogozhinë (37 km. prej Durrësit) lëshon një degë nga juga, e cila, mbas 57 km. nëpër Lushnjë, mbërrin në Berat.

Vizioni hartën e kësaj prefekturë tue shenjuem gjithë vendet gjeografike përkatëse të mësueme deri tash si edhe emnat e prefekturavet, me të cilat rrethohet kjo !

V. PREFEKURA E BERATIT

Prefektura e Beratit në pikëpamjen administrative ndahet në këto nënprefektura: Berati (si rreth i qendrës) Lushnja, Fieri, Mallakastra edhe Skrapari tue pasë gjithsejt 25 komuna, 524 katunde, një popullsi prej 149.000 vendës edhe një sipërfaqe prej 3932,20 km².

1. **Berati** (10.000 vendës) ndodhet në një grykë qëllqerike t' Osumit (lumi Beratit) edhe është një nga qytetet më pittoresk të Shqipërisë. Pjesa e qytetit, që ndodhet në bregun e djathtë të lumit, ka në mes kështjellën e vjetër, mbrenda murevet të së cilës ndodhen disa kisha e ndërtesa të vjetra. Kjo pjesë me anë të një ure lidhet me pjesën tjetër të qytetit (Gorica), e cila shtrihet në rrëzë të kodrinave, që varen nga malet e Spirakut. Edhe Berati, porsia Elbasani, Tirana edhe Shkodra, i ndodhun ndërmjet të fushavet e të malevet, luen rrolin tregtar me rëndësi në shkëmbimin e prodhimevet të krahinavet me natyrë të ndryshme.

Berati gjindet mbi gërmadhat e Antipatrea-s, e cila mund të jetë ndërtuem në kohën e Theodosit të Ri, perandorit të Bizancit, i cili e quejti Pulcheriopolis për kujtimin e emnit të motrës së vet. Në kohën e mesme u quejt Beligrad prej Bullgarëvet.

Në historinë t'onë të ré Berati ndahet në shenjë për kongresin e parë, që u-bâ për të ndamë Kishën Orthodokse Shqiptare nga Patrikana e Stambollit.






Fig. 43. - Kruja






Fig. 44. - Kavala

(Phot. Shqipnja e Illustrueme)





Fyl. 45. - Elbasani

Pamja e përgjithëshme e qytetit. Fabrika e vojtit në të hymit në qytet.
Largas malet e Polisit e të Shpatit.



*Fyl. 46. - Pamja e përgjithëshme e burimevet thermale
të Llixhës s'Elbasanit*






Fig. 47. - Pegin

(Phot. Shqipnja e Illustrueme)





Fyt. 48. - Ura e Rogozhinës



*Fyt. 49. - Berat.
Ura mbi lumin e Beratit (Osumi)*





Fyl. 50. - Kalaja e Beratit





Fyt. 51. - Lushnja.


(Fot. Shqipnija e Illustrueme)





Fyt. 52. - Lushnjë.
Shtëpia ku u mbajt Kongresi më 21 Kallnuer 1920.





Fyl. 53. - Fieri

(Fot. Shqipnija e Illustrueme)






Fig. 54. - Viona

(For. Shqipëria e Illustrueme)



Fig. 55. - Himara

(Fot. Shqipëria e Illustrueme 1927)








*Fyt. 57. - Porto e Palermos. E vetmëja portë e Himarës
(Fot. Shqipnija e Illustrueme 1927)*




Fyl. 58. - Gjinokashta.


(Fot. Shqipnija e Illustrueme)



Fyt. 59.
Gjinokastrë




Fyt. 60.
Fortesa e
Gjinokastrës




Fyt. 61.
Delvina







Fyt. 62.
Fortesa e
Libohovës





Fyt. 63.
Fortesa e
Tepelenës




Fyt. 64
Amfiteatër
në Butrint







Fyt. 65.
Mozaikat
në Butrint



Fyt. 66
Butrint



Fyt. 67.
Kryporja
e Vlorës





Fig. 08. Saranda

(For Shqipnja e Illustrueme)



Fyl. 69. Përmeti

(Fot. Shqipëria e Illustrueme)





Fyl. 70. - Korça

(Fot. Shqipëria e Illustrueme)



2. **Lushnja**, qendër nënprefekturë, është një qytet i vogël me 3000 vendës mbi rrugën Durrës—Berat. Ky qytet, si mbas vendit gjeografik që ka, numrohet si qendra e grumbullimit të prodhimeve bujqësore të fushës shumë pjellore të Myzeqes. Në vitet e fundit Lushnja ka bërë mjaft përparime të dukëshme në pikëpamjen e ndërtimit, por në kohën kur do të përmirësohet gjendja bujqësore e kësaj fushe, padyshim do të ketë një shkëlqim e lulëzim të math. Në këtë qendër bujqësore gjendet *Shkolla e mesme e Bujqësisë*. Lushnja në historinë e rilindjes s'është kombtare ka marrë një randësi tepër të madhe, mbasi këtu u-mblodhën përfaqësuesit e gjithë qyteteve të Shqipërisë edhe bënë Kongresin e Shenjtë më 21 Kallnuer—9 Shkurt 1920, i cili, tue venduem me mos pranuem asnjë mandat ose protektorat të huaj, shpalli vetëqeverimin edhe tanësin tokësore të Shqipërisë.

3. **Fieri** me 2000 banorë është një qytet i ri me rrugë të gjana e të drejta ndodhet në jugë të Semenit mbi rrugën Berat—Vlonë. Ky qytet e ka po atë randësi që ka Lushnja në grumbullimin e prodhimeve bujqësore të Myzeqesë në tregun e vet. Këtu qysh më 1927 është themeluar Muzeja *Zog I-rë*, e cila përmban kryesisht antikitetet e vlefshme, që u-gjinden në Pojan. Fieri lidhet edhe me skelen e vogël të Semenit me një rrugë 17 km., ku ndodhet një zyrë doganore edhe katundi me 300 banorë.

Tash së voni Fieri u-lith me Lushnjën me një rrugë të veçantë afër 30 km.

Qendra e nënprefekturës së Mallakastrës është **Ballshi**, një katund me 500 frymë në luginën e Gjanicës (kambë e Semenit). Katundi Hekal (1100 vendës) në jugë të Ballshit është vend-lindja e Rapo Hekalit, që ka luftuem kundër Tenzimatit.

Edhe qendra e nënprefekturës së Skraparit, **Çorovoda**, është një katund në jugë-lindje të Beratit, në vendin ku bashkohet përroji Çorovodë me Osumin.



Rruga Berat—Fier (44 km.) shtrihet edhe mb'atë anë Vjosës e mbërrin në Vlonë. (Fier—Vlonë afër 39 km.).

Vizioni hartën e kësaj prefekturë tue treguem vendet gjeografike të mësuem deri tash si edhe emnat e prefekturavet, me të cilat rrethohet kjo!

VI. PREFEKTURA E VLONËS

Prefektura e Vlonës në pikëpamjen administrative ndahet në këto nënprefektura: Vlona e Himara tue pasë 9 komuna, 88 katunde, 55.000 frymë, edhe një sipërfaqe prej 1360,20 km².

1. Vlona (75000 vendës) qytet me rëndësi ekonomike edhe historike. Kjo, e ndodhun në kufinin e dy krahinavet me natyrë të ndryshme d. m. th. ndërmyet Shqipnís së Naltë Jugë-perëndimore edhe Shqipnís s'Ulët, është vendi ku grumbullohen prodhimet blegtorore e bujqësore të njanës e të tjetrës anë. Në këte qytet rrjedhin gjithë pasjet blegtororë të malsinavet jugore edhe gjithë pasjet bujqësore të Myzeqesë së Vogël (në jugë të Semenit) edhe të Mallakastrës (si ulli, voj etj...) për dobín e tregtis së mbrendëshme ose të jashtme.

Ky qytet, mjaft i bukur si nga ndërtimet edhe nga pamjet tërheqëse të kodrinavet gjithëmonë në blerim (ullishtat), është qendër tregtare në shkallë të katërtë mbas Durrësit, Sarandës e të Shkodrës, me një lëvizje tregtare prej 3-4 miliona fr. ari. Vetëm dy kilometra larg nga jurga lidhet me Skelen e me limanin e vet. Ky liman është nga më të bukurit e botës; ka një gjânësi aqë të madhe, sa që n'atë mund të futen shumë flota tue qenë të sigurueme prej çdo rreziku. Në gojë të këtij limani ndodhet ujdhesa e vetme Shqiptare, Sazani, e cila qysh më 1914 ndodhet në dorë t'Italis.

Dy kilometra larg Skeles, në buzë të limanit, hijeshon për bukurí lagjeja e Ujit të Ftofët; në këte vend ndodhet Shkolla Tregtare, si institut kombtar për arësi-



min e mesëm të tregtis. Nga institutet shëndetsore në Vlonë gjindet Spitali i Shtetit nga mâ të rregulluemit e Shqipnís si edhe një Çmendingë.

Qyteti ndriçohet prej një centrali t' elektrikut; ka edhe disa fabrika e mullij si për miell ashtu edhe për Voj ullini.

Skelja lidhet me dy vija dekovili; njana shkon deri në Selenicë pranë Viosës e tjetra në Kryporen e Artës.

Në jugë-lindje të Vlonës, 5 km. larg përmpi një kodër 377 m. naltësi, ndodhet Kanina e famëshme me germadhat e kështjellës. Kanina është edhe vendi i princit Gjergj Arianitit, me të bijën e të cilit, princeshën Marina Donikën, qe martuem Skenderbeu më 26 Prill 1451. Këtu në Kaninë është vorruem edhe Ismail Qemali, shpallësi i vetqeverimit t'onë kombtar⁴⁾.

Si Vlona ashtu edhe Kanina qysh në kohnat e Vjetra kanë qenë të përmenduna me rrolin që kanë luejtun mbas pozitës së tyre si qendra të forta e luftarake. Edhe në kohën Mesjetare këta dy vende qenë të lakmuem prej Bizantinëve, Angjuinëve, Serbëve, Venedikasvet edhe mâ në fund prej Tyrqvet. Gjithë këta të huej për t'i shtimë në dorë këta dy vende të fortë, qenë detyruem me bâmë luftime të rrepta.

Vlona për né Shqiptarët është qytet me rëndësi tepër të madhe në historin t'onë të ré kombtare, mbassi përfaqësuesit e gjithë kombit Arbnuer, të mbledhun e të besatuem shoq me shoq ndën prisin e Ismail Qemalit shpallën këtu vetqeverimin e atdheut t'onë tue ngrefun Flamurin e kuq të Kastriotëve me shqiponjën e zezë dykrenëshe në mes që të valojë lirisht n' orizontin e âmbël Arbnuer.

Burrënija, trimnija edhe qindresa heroike qi tregoi Vlona me rrethinat e 'saj në kryngritjen plot guxim, të ngrefun prej 'tyne më 1920 për lirim e këtyne visevet nga pushtimi i huej, i zbardhen faqen gjithë Shqipnís

⁴⁾ Më 28 Nanduer 1932 vorri i Ismail Qemalit u shpërngul në mes të Vlonës ku u ngref edhe një përmendore që e përshembëllon luftëtarin kombtar.



tue bâ me dijtë botën mbarë se kombi arbinuer nuk duron asnji zgjedhë të huej».

2. **Himara** me 2000 vendës është qendra e nënprefekturës, që lidhet me prefekturën e Vlonës. Ky qytet i vogël, por tepër i bukur, është edhe qendra tregtare e katundevet të mëdhej të Rivierës Shqiptare mbi rrugën Vlonë—Sarandë, 70 km. larg Vlonës. Himariotët kurdoherë janë shquem për trimni e besnikí. Nji rrugë automobilahash 112 km. e gjatë lidhë Vlonën me Gjinokastën.

Vizoni hartën e kësaj prefekturë tue shenjuem gjithë vendet gjeografike përkatëse të mësueme deri tash si edhe emnat e prefekturavet me të cilat rrethohet kjo!

VII. PREFEKURA E GJINOKASTRËS

Gjinokastra në pikëpamjen administrative ndahet në këto nënprefekura: Gjinokastra (si qendër), Delvina, Saranda, Libohova, Tepelena, Përmeti, Kurveleshi edhe Çamërija tue pasë 26 komune, 352 katunde, nji popullsi prej 150.000 vendës edhe nji sipërfaqe prej 4142.30 km².

1. **Gjinokastra** (10.000 vendës) është kryevendi i prefekturës me këte emën; ndodhet n'ânën perëndimore të luginës së Dropullit, gjymës ore larg prej lumit Drin, e ndërtrueme mbi nji kodrinë shkambore (350 m. naltësi), që varet në rrânzë të malit Gjerë. Qyteti, i vështruem prej ndonji kodre mâ të naltë, çfaqet me planin e 'tij në formën e nji dore të hapme me pesë gishtat, që çdo njani prej këtyne tregon nji lagje të veçantë; në mezin e këtij plani ndodhet tregu edhe rreth tregut lagjet mâ kryesore si Teqe Mahale, Varoshi, Palortoja etj. — Në shumicën e lagjevet të rrethit shtëpijat vijnë tue iu veshë kodrinavet njana mâ naltë se tjetra edhe duken qysh së largu me nji pamje shumë të bukur. Nga juga qyteti sundohet prej kështjellës, e cila, e vështrueme prej sheshit të Çerçis Topullit, jep nji pamje tepër t'egër.



Kjo kështjellë qe ndërtuëm në kohna shumë të lashta, mbasandaj qe forcuëm e rindërtuëm prej Gjin Bue Shpatës e më vonë prej Ali Pashë Tepelenës më 1812. Mbrenda murevet të kësaj ndodhen kazermat edhe burgjet e vjetra, që u përngjajnë atyneve të kohës Mesjetare. Shumë vënishta edhe kopshtij pemësh ka pasun qyteti nëpër rrethinat e veta kodrinore, por sot kanë mbetun me pakicë, mbassi u-rrënuen prej Grekëve në kohën e pushtimevet të 'tyne.

Gjinokastra është vend-lindja e Koto Hoxhës, Çerçis Topullit edhe Bajo Topullit.

Në qytet është ngrefun edhe një central elektriku.

Në Gjinokastër ndodhet një shkollë e mesme: Shkolla Normale për djemt.

2. **Delvina** me 4000 vendës është qendra e nënprefekturës me këte emën; ndodhet në mes t'ultësinës po me emnin e vetë n'ânën e majtë të përroit Vrisi (kamba e Kalasës). Ky qytet përbâhet prej një rrugë të gjatë të dyqanevet edhe prej një sheshi të math të pazarit. Mbrapa 'tyne vijnë shtëpijat. Këtu bâhet një tregti e mbrendëshme mjaft e gjallë, mbassi mb'ate rreth mungojnë qendra të tjera konkruese.

Në jugë-perëndim të Delvinës (po thue 10 km.) ndodhen gërmadhat e vjetra të Finikut (Phoenicé) të zbulueme më 1925.

3. **Saranda** (2000 vendës) është qendra e nënprefekturës; ndodhet rreth një limanit të vogël edhe nga mbrapa rrethohet me një varg kodrinash shkambore, të cilat e ndajnë këte nga fusha e Vurgut. Saranda bân një lëvizje tregtare mjaft të gjallë, vjen në shkallën e dytë mbas Durrësit me një lëvizje tregtare prej afër 4 M. fr. ari në vit; nëpër këte kryhet gjithë tregtija e jashtme e prefekturës së Gjinokastrës edhe një pjesë t'asaj të Korçës. Dy rrugë kryesore automobilash kryqzohen këtu, njana 130 km. e gjatë vjen prej Vlone edhe tjetra 60 km. e gjatë vjen prej Gjinokastrës. Kjo e fundit, jo vetëm që i lidhë gjithë qyte-



tet edhe krahinat e kësaj prefekturë, por me një lëshon një degë nga Janina (në Greqi) edhe në tjetrën vijon edhe shkon deri në Korçë. Anijat e kompanivet të ndryshme sigurojnë një shërbim të rregullshëm të lundrimit si për viset e largëta ashtu edhe për brigjet t'ona.

Mungimi i një limanit konkurues në këto brigjet e t'ona jugë-perëndimore ka me i dhanë shkas përparimit të Sarandës, e cila qysh tash në pak kohë, me gjithë që, më parë, që rrënuem shumë herë prej Grekëve, ka zënë të lulëzojë e të tregojë një gjallë në rrolin e 'saj tregtarë. Edhe në këte qytet të vogël gjindet një central elektriku. Në rrethinat e Sarandës, 14 km. nga juga, ndodhen gërmadhat e famshme të Butrintit (Buthrontum), në buzën jugore të liqenit me këte emën.

4. **Konispoli** (me 2000 vendës) është qendra e nën-prefekturës së Çamëris. Ky qytet, dikurë në lulëzim, sot me të mbetunit jashta kufinit shumica e hinterlandit edhe i gjithë rrypi i hollë breguer i detit në ballë të Korfuzit e ka humbur krejt atë randësinë e parë.

5. **Libohova** me 3000 vendës, qendra e nën-prefekturës, gjindet e ndërtime mbi faqet e çveshme të malit Bureto. Ky qytet banohet prej bujqëve pasanikë, të cilët kanë prona të gjana në fushën shumë pjellore të Dropullit edhe është mjaft i mbarë për nevojat tregtare të popullsisë së Dropullit juguer e të Pogonit.

6. **Kurveleshi**, — Nën-prefektura e Kurveleshit ka për qendër katundin Gusmar (500 vendës) afër burimevet të lumit Bencës, i cili pranë Tepelenës derdhet në Viosë.

Gusmara, bashkë me katundet e mëdhenj: Progonat, Lekëdush, Golem edhe Nivicë, ndodhet në pllajën e Kurveleshit. Gjoleka me famë, që ka luftuem kundër Tenzimatis, ka qenë nga Kurveleshi.

7. **Tepelena** ndodhet në vendin, ku, aty pari bashkohet Drini me Viosën. Qyteti, i ngrëfun mbi një terrase



shkambore 40 m. nalt luginës së Viosës, ku kryqzohen rrugët e Gjinokastrës e të Korçës për me shkuem në Vlonë, deri më 1920 pat 5000 vendës edhe qe një qendër me rëndësi tregtare për rrethinat e veta malësore; por tërmeti i tmershëm, që ngjau këtu me 26 Nanduer 1920, e rrënoi krejt. Prandaj sot nuk ka më se 500 frymë.

«Tepelena është vend-lindja e Ali Pashë Tepelenës, i cili në mbarimin e shekullit XVIII-të gati 40 vjet e pat sunduem krejt Shqipërinë e Jugës deri në Shkumbin. Kështjella, që na paraqitet sot në këte qytet në trajtën e gërmadhavet, qe ndërnuem prej Ali Pashës».

9. **Përmeti**, qendër nënprefekturë me 3500 vendës, është një qytet i vogël me pamje shumë të bukura; ndodhet në bregun e majtë të Viosës, në rrënzë të vargmalit Dhëmbel. Qyteti në vetvedi është mjaft i bukur edhe në të gjitha anët rrethohet me kopshtna perimesh e pemësh të gjithëfarëshme. Një shkamb i math me naltësi 25 m. edhe me një perimetër 100 m., një krue e ndërtesë të vogël përsipri i quejtun Guri i Qytetit, vizitohet shpeshë herë prej popullit, mbassi kujtohet se ka qenë vend-banimi i themeluesit të vjetër të qytetit, i cili si mbas gojë-dhanave quhesh Premto.

15 minuta përmbi qytetin shifen gërmadhat e një kështjelle me emnin Boringa, ku, si thonë legjendat e kështjelle, kishte pasë qenë dikur vendi i qytetit të moçëm.

Në Veri-lindje të Përmetit, me 30 km. largësi ndodhet katundi **Frashër**, në mes të malevet të naltë, i cili sot është qendra e komunës me këte emën me 400 vendës.

Ky katund ka një rëndësi tepër të madhe për në, sepse është vend-lindja e apostojvet të kombit t'onë: Sami, Abdyl e Naim Frashërit. Edhe në Frashër bëhet për çdo të Mërkurë ditë pazari.

Këlcyra, 800 vendës, qendër komune, sundon krejt grykën me këte emën; ndodhet në grykën e Dëshnicës me pamje tepër madhështore, më në pikën ku bashkohet rruga e Beratit me rrugën Korçë—Vlonë—Gjinokastër. Ka



nji treg të bukur, ku katundet e rrethit për çdo të Premte grumbullojnë prodhimet e tyre edhe formojnë një pazar.

Nji rrugë automobilash (209 km.) tue kaluem nëpër Tepelenë, Këlcyrë, Përmet, Leskovik, Kolonjë, lidhë Gjinokastrën me Korçën.

Vizioni hartën e kësaj prefekturë.

VIII. PREFEKTURA E KORÇËS

Prefektura e Korçës ndahet në këto nënprefektura: Korça (si qendër), Leskoviku, Kolonja, Bilishti edhe Pogradeci tue pasë 26 komune, 331 katunde, një popullsi prej 155.000 frymësh edhe një sipërfaqe prej 3312,10 km².

1. **Korça** (26,000 vendës) gjindet në jugë të fushës me emnin e vet, në rranzë e në faqe të kodrinavet, që varen prej malevet të Moravës edhe është një qytet i lulëzueshëm e deri diku i modernizuem me rruga e me ndërtesa të bukura. Ky qytet e shtrini influencën e vet tregtare në të tănë Shqipnín e Mbrëndshme të Jugës e prandaj numrohet ndër qendrat tregtare më të lëvizshme të Shqipnís. Madhësija e tregut edhe e sheshevet të pazarit të vet na e provon këte gjá. Korça përparimin edhe lulëzimin e ka edhe më tepër prej gjindjes së mbarë gjeografike. Ndodhet në qendrën e vendeve bujqësore shumë të pasme, gëzon një klimë të shëndoshë edhe lidhet me rruga të ndryshme automobilash me Greqín (Follorina), me Jugosllavín (Monastir), me Shqipnín Jugë-perëndimore (Gjinokastër, Vlonë, Sarandë) edhe me Shqipnín e Ulët (Elbasan, Durrës, Tiranë). Në Korçë gjinden këto shkolla të mesme: Liceu, Shkolla Tregtare edhe Shkolla Normale Femnore. Korça ka edhe një bibliotekë, të ndërtueme prej bamirsit Thoma Turtullit. Korça ka një central elektrik edhe disa fabrika: një fabrikë e madhe e miellit, dy fabrika të trikovet, fabrika e alkoolit në Drenovë, dy shtypshkronja. Shumë Korçarë gjinden përjashta

Shtetit, si n' Amerikë, në Rumaní, n' Egjypt, ku merren me punë të ndryshme e të fitimshme.

Korça ka një randësi edhe në historín t'onë kombtare. Këtu qe hapun e para shkollë shqipe qysh më 1884; këtu qenë bënë lëvizjet më të gjalla për zgjimin e popullit në kohët më të errta të tyranís Turke.

Korça ka qenë qendra e kryengritësve Shqiptarë, që, nën prisín e Çerçis Topullit e Mihal Gramenos, dhanë shenjën e parë të ngritjes kundër zgjedhës së huej.

«Vrasja e Spiro Kosturit në Selanik edhe më vonë vrasja e djemvet të rí dëshmorë provojnë atdhetarizmën e Korçarëvet. Vepra e Themistokli Gërmenjit për shpalljen e Korçës si Republikë Shqiptare në kohën e sundimit të huej qe kulmi i patriotizmës Korçare». Për kujtim të kësaj vepre, Korça mirënjohëse i ngrefi Themistokli Gërmeenjit një shtat guri, që hijeshon kopshtin pranë bibliotekës së qytetit.

Në rrethinat e Korçës ndodhen shumë katunde të bukura si vende dëfrimi për verë: Mborja, Drenova. Boboshtica, Dardha etj., por me randësi të madhe historike është Voskopoja.

Voskopoja gjindet në perëndim të Korçës (23 km. larg), në mes të pllajës me ate emën, ka qenë një qytet i themeluar prej Vllahvet më 1330. Ky qytet më 1769 kishte 18.000 shtëpija, më se 30 kisha, një shtypshkronjë, një bibliotekë të çmueshme edhe shumë shkolla. Numuri i vendësve i mbërrinte atëhere deri më 100.000 frymë, por me këte datë. d. m. th. më 1769 u-shbë krejt prej banorëvet të rrethit. Sado që u-rindërtue disa herë të tjera, u-rrënu e u-dogj prap. Prandaj sot na paraqitet me gërmadhat e panumërta të ndërtesave të moçme, me të cilat lulëzonte dikurë. Nëpër këto gërmadha sot banojnë një a njëqind familje tue formuar një katund, i cili është edhe qendra e komunës me këte emën.



Në Jugë të Voskopojës (15 km.) gjindet katundi i Vithkuqit, i cili është vend-lindja e Naum Veqilharxhit, që e pat bëmë abetaren e re të gjuhës shqipe qysh më 1844 edhe me ate mundohesh me e përhapë mësimin në gjuhën e vendit qysh atëhere.

2. **Leskoviku**, me 3000 vendës është qendra e nënprefekturës me këte emën; gjindet në rrëzë të malit të Mellesinit edhe krejt afër kufinit grek. Qyteti i ngrëfun në një vend (930 m.) të naltë shquhet me klimën tepër të shëndetëshme. Nëpër këte kalon rruga, që lidhë Shqipërinë J. P. me Korçën.

Qyteti para luftës Ballkanike ka qenë në lulëzim të math; këte e dëshmojnë gërmadhat e sotshme të shtëpijavet të mëdha. Gjithë qyteti edhe katundet qenë rrënuem prej Grekëve në kohat e ndryshme të pushtimit të 'tyne.


Pranë këtij qytetit (8 km.) krejt afër kufinit ndodhen banjat squfrore të Vromonerit.

Në rrethin e Leskovikut ndodhet katundi *Podë* (qendër komune me 450 vendës) vend-lindja e Zylyftar Podës, i cili më 1831 pat luftuem me Tyrqit për lirim e Shqipërisë. Po me këte rreth, 5 km. larg qendrës, gjindet katundi Postenan (me 500 vendës), që është vend-lindja e Jan Vretos, i cili ka bashkëpunuem me Sami bej Frasherin e me Vaso Pashë Shkodranin më 1879 për zgjimin t' onë kombtar.

3. **Kolonja ose Erseka**, me më pak se 1000 vendës është qendër nënprefekturë, gjindet në mes t' ultësinës pllajore, e cila quhet me emnin e vet. Kjo qendër sot është më tepër me pamjen e një tregu, se sa të njëj qyteti, mbase bashkë me rrethinat e veta që rrënuem fort barbarisht prej Grekëve më 1914. Kjo ka edhe një internat filluer. Nëpër Kolonjë shkon rruga Korçë-Vlonë-Sarandë.

4. **Bilishti** me 2500 vendës është qendër nënprefekturë; ndodhet në lindje të luginës së Devollit, 880 m. mbi sipërfaqen e detit me një klimë të shëndoshë,

Shumica e katundevet të rrethit të Bilishtit janë të



mëdhenj, porsì ato të Korçës e të Himarës. Ndër këta, Hoçishti me 2600 vendës është më i bukur.

Nëpër Bilisht kapërcen rruga Korçë—Follorinë.

5. **Pogradeci** (3000 vendës), qendër nënprefekturë, është një qytet shumë i bukur, ndodhet në buzë të liqenit t'Ohrit, ka klimë të shëndoshë e pamje madhështore. Edhe në këtë qytet të bukur tash së voni u-ngref centrali i elektrikut. Pranë Pogradecit në mes të një fushe shumë pjellore ndodhet Starova me 1000 vendës.

Vizioni kartën e kësaj prefekturë tue shenjuem gjithë vendët gjeografike përkatëse të mësueme deri tash edhe emnat e prefekturave me të cilat lidhet!

IX. PREFEKTURA E DIBRËS

Prefektura e Dibrës në pikëpamjen administrative ndahet në këto nënprefektura: Peshkopia (si qendër rrethi), Zerqani edhe Mati tue pasë gjithsejt 20 komune, 203 katunde, një popullsi prej 106.000 frymësh edhe një sipërfaqe prej 2385 km².

Rruga Elbasan-Korçë (135 km.) në Librazhd (25 km. prej Elbasani) lëshon nga veriu një degë, e cila, tue ndjekë së pari luginat Çermenikë-Mokën, këthen nga veri-lindja e i qaset kufinit në Gollobordë edhe, si e përshkon këte me një naltësi deri më 1000 m. në qafën e Lajthís (Tesnikamen) përtej Klenjës, varet teposhtë e bie në ultësinën e Drinit të Zi Këtu vijon prap një 8-9 km. fort afër kufinit e mbasandej, tue ra nëpër Homesh, e kapërcen më tutje Drinin e Zi në Topojan, shkon nëpër Maqellar e prej andej ndjek drejtimin e veriut gjithnjë në lindjen e Drinit të Zi e mbërrin në Peshkopí. Kjo rrugë automobilash, qysh prej Librazhdi e deri në Peshkopi (108 km.), përmendet me bukurí natyrore të pamjevet madhështore të 'saj ndër më te parat në Shqipni.

1. **Peshkopia** (1000 vendës) është qendra e prefekturës. Kjo qendër e re dita me ditë është tue u-munduem me u-ndrequn për me marrë trajtën e një qyteti të vogël



e me i mëlkuem nevojat e popullsis së rrethinavet, mba-ssi Dibra e bukur madhështore kryevendi i principatës së Moisi Golemit padrejtësisht mbeti përjashta kufinit për me rënkue ndër sundimin e Jugosllavis e për me u-shikuem me mallëngjim të thellë prej gjithë neve, që ndodhemi këndeje, në Shqipnin t'onë të Lirë.

2. **Zerqani** (700 vendës), qendër nënprefekturë, është një katund i bukur; ndodhet në grykën, ku shkon udha Mat-Dibër; shquhet me klimën e bukur e me ujna shumë të freskët.

3. **Burrell** (500 vendës) është qendra e nënprefekturës së Matit.

4. **Burgajeti** (1000 vendës), katund shumë i bukur, qendër komune në veri-lindje të Burrelit, u-bâ për në një vend historik, pse është vend-lindja e N. M. T. Mbretit t'onë t'adhurueshëm.


Në këtë prefekturë ndodhen tre internate fillore: i Kastriotit, në Kastriot afër Peshkopis, i Homeshit edhe i Burrelit.


Vizioni kartën e kësaj prefekturë edhe shenoni vendet gjeografike të mësueme si edhe prefekturat me të cilat rrethohet!

X. PREFEKTURA E KOSOVËS


Prefektura e Dibrës nga âna e Veriut pjek me prefekturën e Kosovës, e cila ka këto nënprefektura: *Kuks* (si qendër rrethi), *Bicaj* edhe *Kolgecaj* tue pasë gjithsejt 10 komune, 110 katunde, një popullsi prej afër 65.000 vendës edhe një sipërfaqe prej 2135, km².

1. **Kukësi**, pors i Peshkopia, me të caktuem si qendër prefekturë po zbukurohet dita me ditë me ndërtesa të ndryshme zyrtare (pallati i prefekturës), private e me magazina tregtare e po merr fytyrën e njëj qytetit të vogël. Po bâhet një qendër tregtije për nevojat e vendësve të rrethit të malësinavet t'atyshme, të cilët, me të mbetunin e Prizrenit e të Gjakovës mb'atë ânë tjetër të kufi-






Fyt. 71.
Biblioteka e
Th. Turtullit
në Korçë



Fyt. 72.
Pojani



Fyt. 73.
Kisha antike
e Pojanit





Fyt. 74. - Peshkopija

(Fot. Shqipnija e Illustrueme)






Fyl. 75. Kruma

(Fot. Shqipnija e Illustrime)





Fyl. 76. - Ura e Vezirit pranë Kukësit

(Fot. Shqipëria e Illustrueme)



nit, nën sundimin e Jugosllavis, nevojiteshin me bëmë me mundime të mëdha një rrugë tri ditëshe për me u-zdjergjun deri në Shkodër.

Pranë Kuksit, ndodhen 3 ura, nga të cilat njana në Drinin e Zi po ndërtohet tash, pse ishte prishë prej vërshimit t'ujit të Drinit, tjetra mbi Drinin e Bardhë e goditme qysh në kohën e Turqís me katër qemerë edhe e treta është Ura e Vezirit mbi Drinin e bashkuem. Kjo urë madhështore e historike ka qenë më e rëndësishmja e gjithë Ballkanit si nga stili arqitektuer ashtu edhe nga madhësija. Ka pasë një gjatësi afër 600 metrash, përbàhesh vetëm prej pesë qemerash të mëdhenj, ndër të cilët tre të mesmit me formën harkore formojshin një tănësi të përbashkët me një lehtësi të mrekullueshme. Kjo pjesë e rëndësishme e mezit të 'saj mjerisht qe prishun prej Serbëvet e prandaj sot e tanë kjo urë, që dikurë lidhte Kosovën me krahinat e Mirditës e të Shkodrës, na paraqitet në formën e një gërmadhe, por plot me kujtime të famës shekullore.

2. **Bicaj** me 1700 vendës është qendra e nënprefekturës së Lumës edhe ndodhet në rrâzë të Gjallicës së Lumës pranë grykës së një përroi. Me një treg e me disa ndërtesa zyrtare e private dalë nga dalë po e merr trajtën e njëj qyteti të vogël.

3. **Kolgecaj** (500 vendës) është qendra e nënprefekturës së Malsís Gjakovës. Ndodhet ndërmjet krahinave Gash e Krasniqe, në krahun e djathtë të Valbonës, në rrânzën lindore të malit Maja e Hekuravet.

Kruma (400 vendës), ish qendra e prefekturës, sot është qendër komune, gjindet në veri të Kuksit (12 km.) në rrânzë të malit me emnin e vet.

Kjo ka një internat filluer.


Një rrugë automobilash (18 km.) shkon prej Kuksit deri në Prizren (Kosovë), kjo kalon kufinin pranë katundit të Morinës (400 vendës), ku gjindet një zyrë doganore.

Vizioni kartën e kësaj prefekturë edhe shënoni vendet gjeografike të mësuem si edhe prefekturat me të cilat rrethohet!



TË NDAMIT ADMINISTRATIV TË SHQIPNIS

Profekturat	Nën-prefekturat	KATUNDARIT ose KOMUNET	Sasla e katundeve	Sipërfaqja në km ²
BERATI	Berati	Berati (qendra), Goraj, Molishti, Pazar'i Frashërit (Roskoveci), Peshtani, Ura e Hasan Beut (Ura).	137	3,032,20 km ²
	Fieri	Fieri (qendra), Dukasi, Levani (Levan-Samar), Semani.	94	
	Lushnja	Lushnja (qendra), Bubullima, Diviaka, Fier-Shegani, Libofsha, Spolata.	143	
	Mallakastra Skrapari	Ballshi, Cakrani, Fratari, Graçani. Çorovoda, Çepani, Potomi, Tomorrice, Therepeli	55 95	
DIBRA	Dibra (Peshkopia)	Peshkopia (qendra), Luznia, Maqellara, Reçi, Sahadolli, Sllatina.	87	2,385 km ²
	Mati	Burreli, Baza, Fusha Lurës, Gurra Madhe, Klosi, Murra, Patini, Parlati (Proseku), Rrë-mulli, Selita (Qafa Kishës).	67	
	Zerqani	Zerqani (qendra), Homeshi, Klenja, Ostreni Madh.	49	
DURRËSI	Durrësi	Durrësi (qendra), Ndroqi (Tregu).	22	2,445,90 km ²
	Kavaja Kruja	Kavaja, Golemasi, Gosa, Kryevidhi. Krue (qendra), Cudhija (Beni), Mamurasi, Kur-bini (Laçi).	55 46	
	Shijaku	Shijaku (qendra), Ishmi (Kertushaj), Preza.	58	
ELBASANI	Elbasani	Elbasani (qendra), Çermenika I (Martaneshi), Çermenika II (Zdrâzhi), Dumreja (Belshi), Krraba (Cacabeza), Librazhdi, Quksi, Shpati I (Gjinari), Shpati II (Shtëpanja), Zaranika (Breneshi).	190	2,954,90 km ²
	Gramshi Peqini	Gramshi (qendra), Dragoti, Kukuri, Kushova. Peqini (qendra), Darsija (Gjuzaj), Mlika, Vrapit.	71 59	
GJINOKASTRA	Gjinokastra	Gjinokastra (qendra), Zagorija (Sheperi), Zanelaj (Kardhiqi).	44	4,142,30 km ²
	Çamëria	Konispoli (qendra), Pandelejmoni.	31	
	Delvina	Delvina (qendra), Dhrovjani, Jerma (Ymer-efendiu), Piqerasi,	63	
	Kurveleshi	Gusmara (qendra), Kolonja, Kuçi.	14	
	Libohova	Libohova (qendra), Jergucati, Pogoni (Poliçani).	45	
	Përmeti	Përmeti (qendra), Cerja (Hotova), Deshnica (Ballabani), Frashëri, Këlcyra, Reza (Dracova).	102	
	Saranda Tepelena	Saranda (qendra) Tepelena (qendra), Krahsi, Lap-Martallosi, Rabija (Buzi-Gjonça).	53	



Prefekturat	Nën-prefekturat	KATUNDARIT ose KOMUNET	Sasija e katundeve	Sipërfaqja në km ²
KORÇA	Korça	Korça (qendra), Dardha, Maliqi, Moglica, Opari (Protopapaj), Panariti, Pojani, Posteci (Gllomboçi), Vithkuqi, Voskopoja.	134	3.312,10 km ²
	Bilishti Kolonja	Bilishti (qendra), Bozhigradi, Hoçisti, Progri. Erseka (qendra), Barmashi, Shënmetiri (Qesarak), Bezhani.	40	
	Leskoviku Pogradeci	Leskoviku (qendra), Kovaçishta, Poda, Pogradeci (qendra), Pretushi, Derdusha (Gribeci), Mokrra (Velçan-Mokërr), Trebinja.	50	
			30	
KOSOVA	Kukësi Luma	Kukësi (qendra), Kruma, Bicaj (qendra), Gora (Shishteveci), Ploshtani, Tej-Drini (Surroj).	19	2.186 km ²
	Malcia e Gjakovës	Tropoja (qendra), Bytyçi (Vladi), Krasniqja (Kolgecaj), Nikaj-Merturi (Lekbibaj).	47	
			44	
SHKODRA	Shkodra	Shkodra (qendra), Anës-Malit (Oboti), Bushati, Guri Zi, Pulaj, Vraka (Boriçi).	64	4.870,20 km ²
	Dukagjini	Pulti (Xhani), Shala (Lekaj), Shoshi (Nikaj), Shllaku (Lekgjokaj).	23	
	Leshi	Bregu i Matit (Gajush), Malcia e Leshës (Rrubigu), Shën-Gjini, Vau-Dëjës, Zadrimja (Dajçi).	69	
	Malcia e Madhe	Kopliku (qendra), Hoti (Brigje), Kastrati (Bajza), Postriba (Drishti), Rrjollli (Lepuroshi), Shkreli (Dedaj), Vermoshi (Selca), Vukël-Nikçi (Vukli).	83	
	Mirdita	Dibri (Vigu), Fani (Xhuxha), Oroshi (Blinishiti), Oroshi i Poshtëm (Simoni), Spaçi I (Arrësi), Spaçi II. (Gojani i Poshtëm).	58	
	Puka	Puka (qendra), Dardha, Dukagjini, Iballja, Karma, Milla.	48	
TIRANA	Tirana	Tirana (qendra), Petrela, Priska (Priska e Madhe), Shën-Gjergji, Shupali, Vorra, Zall-Herraj.	110	850,20 km ²
VLONA	Vlona	Vlona (qendra), Dukati (Fusha Dukatit), Kantina, Kudhësi (Sevasteri), Mesapliku (Brajaj), Narta, Topalltisa (Trevllazën), Treblova (Gerneci).	81	1.360,20 km ²
	Himara	Himara (qendra), Vunoi.	7	

SHUMA: 10 Prefektura, 30 Nënprefektura, 189 Komuna, 2578 Katunde, 28.388 km² sipërfaqja.



III. Studimi ekonomik i Shqipnis

1. Bujqësija edhe vendi i 'saj

Populli i ynë merret përgjithnisht me bujqësi e me blegtorí, por themelin e jetesës s'onë kombtare e përmbân bujqësija.

Populli merret edhe me degët e ndryshme bujqësore, të perimevet e të pemëvet. Ullishtat e Vlonës, të Mallakastrës dhe t'Elbasanit formojnë një pasuní të madhe për këto vise. Të gjitha këto fatkeqsisht nga kujdesija e pakët nuk ndodhen në shkallën e duhur.

Me gjithë këte shpresohet se në një kohë të shpejtë gjindja e soçme bujqësore ka me ndrruem faqe, mbassi kujdesimet shtetnore edhe inisiativat private janë tue u shtuem dita me ditë për përmirësimin e kësaj dege gjallnore.

Përveç të metavet shoqnore, që e pengojshin edhe e pengojnë Shqiptarin nga punët bujqësore, duhet t'i përmendim edhe pengesat natyrore të dëftyeme má nalt.

Shqipnia e Ulët ka shumë fusha, si ato të Myzeqesë, të Drinit të Poshtëm, të cilat përgjithnisht janë moçalike, po kështu edhe fusha e Tiranës etj.; shumicës u mungon humusi. Me gjithë këte aty këtu gjinden edhe tokë shumë pjellore. Në Myzeqe bâhet misri dy herë në vjet; porse fusha vuen shumë prej malarjes, prej ujnash, që e mbulojnë edhe prej asish, që e mbysin fare. Sot mbjellja nëpër këto fusha ásht në shkallën minimale; me kohë shpresohet një përmirësim. Mungesa e rrugëvet, që mund të hapshin vende shitjesh, ka shkaktuem një vorfní e mospërparim në këte degë. Po sa të largohet kjo e mëte edhe po sa të bâhen kanalizimet e nevojshme vende vende për me i thamun dhe vende vende për me i ujitun këto fusha, kemi me pasë fitime shumë të mëdha.

Të 1700 km². tokë pjellore të fushavet pranë detit, prej të cilavet má se 400 km² ndodhen gjithë vitin të mbytuna ndër uj, po të kanalizohen e të përmirësohen mbas metodavet má të reja bujqësore, do të shofim një

pasuni të madhe në këto vise të gratëshme edhe do të mbërrijnë në një gjindje me i mëlkuem nevojat ushqimore të vendit, e me eksportuem sasina të mëdha drithnash. Po me këto punë do të mundemi me e zhdukun edhe malarjen bashkë me vorfnin.

Edhe fushat e thata si ato të Tiranës etj. mund të punoheshim më mirë e kështu mund të banoheshin më me shpeshësi, mbassi ujt për t'i ujitun nuk mungon; por prap se prap një pjesë e madhe e 'tyne përdoret ende për kullota e për livadhe. Shkaqet e kësaj gjindjeje edhe nëpër këto janë në mungesën e kanalevet.

Në disa vende zelli i vendësvet për punë ka dhanë përfundime të frytëshme: rreth Elbasanit ka kopshte (qipshte) perimesh, po kështu edhe në Pogradec, në Starovë, në rrethinat e liqenit t'Ohrit, në Përmet etj.

N'Elbasan edhe në disa vende bâhen pemët mesdheake, si portokalli, limoni etj. Ullini edhe fiku bâhen në të gjitha anët me klimë detike, po ashtu edhe mani, pemët e të cilit bâhen rakí, edhe gjethet përdoren për ushqimin e krymbit të mundafshit.

Kushtet bujqësore janë më të vështira në Shqipnín e Naltë jugë-perëndimore, por me gjithë këte tokat e mbjellëshme këtu shfrytëzohen më së mirit. Kultura e makjevet në Rivierën Shqiptare zâvendësohet me kulturën e pemëvet mesdheake gjithëmonë të blerta, si qitra, portokalli, limoni, mandarina, mushmulla etj. Nëpër fushat e Gjinokastrës gjinden tokë, që punohen pjesësisht.

Shqipnija e Mbrendëshme përmban fusha e lugina pjellore të rrethueme me pyje ahishtash e dushqesh (në të dy brezat). Ndër këto më e përmenduna âsht ajo e Korçës, ku duket çiltazi produkti i duervet puntore. Në këto vende nuk bâhet vetëm gruni e misri; por edhe rrushi e pemët e tjera. Përveç këtyne janë edhe ulësinat e Matit, të Drinit të Zí edhe ato të Krumës, të cilat përmbajnë vende bujqësore shumë pjellore, vetëm se përçahen shumë prej përrenjvet. Këta vende sot për sot punohen vetëm për t'i mëlkuem nevojat ushqimore të vendësvet; punimi më i gjânë nuk zbatohet, mbassi mungojnë mjetet për ekspor-



timin e prodhimevet nëpër krahinat e jashtme. Tash me të hapunit e rrugëvet po fillon edhe nëpër këto vise të vetmueme një jetë më me gjallëni.

Madhësija e tokëvet bujqësore (të punueme) në Shqipëri çmohet 200.000 — 250.000 hektarë, që d. m. th. 8 — 11,35% e sipërfaqes së tanëshme; me të vërtetë fort pak.

Shumë pjesa të tjera pjellore të Shqipërisë nuk janë të shfrytzueme ende: në veri vetëm 1/10-ta e tokës është futun në punë; në jugë kjo gjendje është më e mirë.

Nga këto shkaqe edhe mjeshtria e mullijvet, në Shqipëri nuk është e përparueme.

Neve, me konditat e soçme bujqësore, nuk është tue na mjaftuem buka; këte e blejmë nga ndonji herë së jashtmi.¹⁾

2) Pasqyrë përmbledhëse e gjendjes dhe e sasis së tokëvet të punueme e të pa punueme


PREFEKTURA	TOKË E PUNUEME				TOKË E PA PUNUEME				
	Ara hektar	Vne- shta hektar	Kop- snte hektar	Shuma hektar	Tokë qi- mund të punohet hektar	Kullota elivadbe hektar	Kneta hektar	Moçale hektar	Shuma hektar
Berati . . .	42270	2575	774,8	45619,3	19713	76500	42014,5	4357,5	142585,3
Dibra . . .	8187	37	1211	9435	2849	8783	5	20	11657
Durrësi . . .	14608	219	1444	16271	11478	6188	5153	150	22969
Elbasani . . .	83303,8	1178	10450,1	94931,9	19225	26757	800	2500	49882
Gjynokastrë . . .	14365	840	2476	17681	16009	53351	1176	1393	71929
Korçë . . .	26410,8	881	7998	35289,8	4681	137277,7	14442,5	275,5	156676,7
Kosovë . . .	2991	12	274	3277	1880	966	—	—	2346
Shkodra . . .	8672	615	526	9813	7038	10495	1387	493	19413
Tirana . . .	5166	5	250	421	1813	1317	2	15	3147
Vlojë . . .	11341	965	1255	13561	5765	15530	100	1000	22395
Shuma	217314,6	7327	26658,9	251300,5	91051	337164,7	65080	10204,3	503500

Nga këto tokë të tregueme në këte listë, rrotull vitit 1926 janë marrë këto prodhime:

Grun	kuintal	214.636	Rrush	kuintal	63.872
Misër	»	797.257	Voj ullini	«	45.518
Elb	»	50.811	Frashullë	«	34.121
Tërshânë	»	72.623	Patate	«	3.814
Duhan	«	30.113			

¹⁾ Sidomos kurr merr moti me thatësi; në vitin 1932 kemi blemë së jashtmi afër 4 M. ari drith. Kjo gjindje e keqe do të përmirësohet po sa që të mësohet bujku të mbjelli grun (si domos ate të farës së rë të zgjedhun) në vend të misrit.

²⁾ Kopjuem prej *Shqipëria më 1927*, T. Selenica, f. LXXII. Kjo pasqyrë dëfton vetëm afër 1/4 e sipërfaqes së përgjithshme të Shqipërisë. Tri të katërtat e tjera janë male të veshuna e të çveshuna.



Prodhimi bujqësuer i vitit 1932

PRËFËK-TURAT	GRUNË		E L B		TEKSHANË	
	HEK.	KUINT.	HEK.	KUINT.	HEK.	KUINT.
<i>Berati</i> . .	4.559.69	50.118.13	905.66	7.706.20	3.652.40	25.435.68
<i>Dibra</i> . .	775.10	8.218.20	366.60	4.376.40	72.70	749.20
<i>Durrësi</i> . .	2.402.86	29.037.72	381.45	5.052.70	2.474.35	36.456.--
<i>Elbasani</i> . .	1.661.30	15.174.80	795.70	4.507.--	849.60	6.400.90
<i>Gjinokastr</i>	4.604.70	37.255.--	768.70	5.630.--	1.031.55	8.781.--
<i>Korça</i> . .	9.949.90	128.132.50	1.252.80	18.487.90	1.089.90	12.596.90
<i>Kosova</i> . .	306.60	8.851.70	190.20	2.897.--	74.20	1.256.75
<i>Shkodra</i> . .	4.148.42	41.223.--	365.84	4.618.35	46.50	562.--
<i>Tirana</i> . .	236.12	2.877.--	142.40	1.859.50	293.--	3.839.--
<i>Vlona</i> . .	2.366.30	26.987.--	388.32	3.243.--	1.654.20	18.995.--
Shuma	31.010.99	342.875.05	5.557.67	58.978.05	11.238.40	115 072.38

	THEKËN		TEPË		ORIS	
	HEK.	KUINT.	HEK.	KUINT.	HEK.	KUINT.
<i>Berati</i> . .	104.09	1.759 50	373.92	9.635.10	110.--	8.000.--
<i>Dibra</i> . .	296.50	3.038.--	325.--	9 050.20	—	—
<i>Durrësi</i> . .	0.50	6.--	341.82	9.269.--	—	—
<i>Elbasani</i> . .	124.80	867.--	872.--	25.518.50	108.70	789.50
<i>Gjinokastr</i>	299.10	2.079.--	7.30	103.--	—	—
<i>Korça</i> . .	1.291.90	16.435.70	39.70	405 50	—	—
<i>Kosova</i> . .	290.65	4.163.50	—	—	—	—
<i>Shkodra</i> . .	86.25	1.065.50	—	—	—	—
<i>Tirana</i> . .	7.40	80.--	9.037.--	135.641.--	1.30	30.--
<i>Vlona</i> . .	14.42	184.--	—	—	1.20	30.--
Shuma	2 515.61	29.678.20	10 997 24	189.622.80	216.29	15.955.—

	MISËR		JONXHE E THATË		RRUSH VNESHTE *	
	HEK.	KUINT.	HEK.	KUINT.	HEK.	KUINT.
<i>Berati</i> . .	25.000.00	200.000.00	137 20	4.542.00	PJERG.	39.43
<i>Dibra</i> . .	4.200.70	108 956.00	2 267.00	43.980.00	47.40	1.806.00
<i>Durrësi</i> . .	9.001.50	120.546.40	2.041.75	42.067.75	288.55	3.847.00
<i>Elbasani</i> . .	10.498.00	83.948.00	818.80	16.463.00	182.60	4.355.50
<i>Gjinokastr</i>	6.131.80	69 461.00	290.10	1.839.00	406.90	7.581.00
<i>Korça</i> . .	7.634.20	105.089.80	1.528 40	51.616.00	958.20	18.595.00
<i>Kosova</i> . .	3.125.30	35.246.40	9.580.00	28.388.00	2.90	78.00
<i>Shkodra</i> . .	6.584.50	85.847.50	3.032.03	85.669.00	196.95	4.197.00
<i>Tirana</i> . .	2.037.10	35.641.00	6.116.00	11.006.00	105.00	2.526.00
<i>Vlona</i> . .	3.749.65	45 805.00	2.320.10	404.00	352.79	6.838.00
Shuma	77.937.55	890.541.10	28.181.98	286 888.75	2.541.20	49 362.93

* Në shumicën e katundevet edhe nëpër rrethinat e kopshtet e qyteteve vendin e vneshtave të zanë pjergullat të ngjiturat nëpër lisat e mëdha të caracavet, të plepavet etj., sasija e këtynevet nuk është llogaritur këtu.



Prodhimi bujqësuer i vitit 1932


PREFEK- TURAT	ULLI		DUHAN		L I	
	BRANJE	KUINT.	HEK.	KUINT.	HEK.	KUINT.
<i>Berati</i> . .	150.000	60.000	67.80	161.76	12.82	29.25
<i>Dibra</i> . .	—	—	164.25	421.30	—	—
<i>Durrësi</i> . .	58.000	17.649	421.27	2.138.85	0.30	3.00
<i>Elbasani</i> . .	250.000	100.000	304.18	2.914.40	19.50	39.10
<i>Gjinokastr</i>	10.000	4.676	233.36	793.35	8.90	32.00
<i>Korça</i> . .	—	—	84.20	302.35	—	—
<i>Kosova</i> . .	—	—	102.47	221.63	—	—
<i>Shkodra</i> . .	3.817	1.142	407.21	4.259.35	16.05	62.65
<i>Tirana</i> . .	43.000	15.000	160.40	471.00	9.85	35.20
<i>Vlona</i> . .	300.000	150.000	162.48	553.00	0.10	0.50
Shuma	814.817	348.467 *	2.107.62	12.236.99	67.52	201.70

	PAMBUK		U R O F		O K Ê R	
<i>Berati</i> . .	4.10	12.75	221.09	1.305.39	291.18	1.705.50
<i>Dibra</i> . .	—	—	54.00	455.90	5.00	22.50
<i>Durrësi</i> . .	5.50	14.95	162.90	832.00	?	?
<i>Elbasani</i> . .	2.90	6.50	59.90	368.20	?	?
<i>Gjinokastr</i>	?	?	101.70	680.00	72.10	622.00
<i>Korça</i> . .	—	—	534.80	4.587.40	13.40	71.00
<i>Kosova</i> . .	—	—	11.65	128.50	—	—
<i>Shkodra</i> . .	?	?	?	?	—	—
<i>Tirana</i> . .	8.10	45.60	?	?	—	—
<i>Vlona</i> . .	?	?	?	?	—	—
Shuma	20.60	79.70	1.146.04	8.357.39	381.63	2.421.00

	GROSHË		BATHË	
<i>Berati</i> . .	50.63	406.00	—	—
<i>Dibra</i> . .	13.50	2.696.30	—	—
<i>Durrësi</i> . .	162.90	822.00	—	—
<i>Elbasani</i> . .	?	104.60	—	—
<i>Gjinokastr</i>	7.50	74.00	2.00	11.00
<i>Korça</i> . .	20.20	195.70	—	—
<i>Kosova</i> . .	?	198.00	—	—
<i>Shkodra</i> . .	?	?	—	—
<i>Tirana</i> . .	22.80	159.00	—	—
<i>Vlona</i> . .	?	?	—	—
Shuma	277.53	4.655.60 **	2.00	11.00

* Sasija e ullinit në kokrra: 348,467 kuintalë. Madhësija e tokëvet që mbu lohën me ullishta çmohet deri më 5000 hektarë. Në vjetin më të mbarë, prej këtyne ullijvet është nxjerrë një prodhim voji prej 200.070 kuintalësh.

** Në shumicën e anëvet të Shqipnis groshta ose frashulli mbillet bashkë me misrin nëpër misoret.



**Madhësija e tokave të punueme edhe sasija e prodhimit
për vitin 1932**

Emri i prodhimit	Sasija e hektarëve	Sasija e prodhimit
Grunë . . .	31,010,99	kuintal 342,875,05
Elb . . .	5,557,67	« 58,378,05
Tërshanë . . .	11,238,40	« 115,072,38
Thekën . . .	2,515,61	« 29,678,20
Tebë . . .	10,997,24	« 189,622,30
Oriz . . .	216,29	« 15,955,—
Misër . . .	77,937,55	« 890,541,10
Barë (Jonxhe) . . .	28,131,98 ¹⁾	« 286,883,75
Rrush . . .	2,541,29	« 49,362,93
Ullë . . .	5,000,—	« 200,000,— ²⁾
Duban . . .	2,107,—	« 12,236,99
Li . . .	6,752,—	« 201,70
Pamuk . . .	20,60	« 79,70
Urof . . .	1,146,04	« 8,357,39
Okër . . .	381,63	« 2,421,—
Frashullë . . .	277,53	« 4,655,60
SHUMA	185,833,82	

¹⁾ Gjanësija e livadhevet edhe i kullotave të Shqipnis çmohet aproksimativisht 213.614,7 hektarë.

²⁾ Në gjithë Shqipnën çmohen afër 814.000 rranjë ullini.

SHËNIM: Lista e shenueme në faqet 91-92 është përmbledhja e listave të ndryshme të çdo prefekturë, që i mora nga Ministrija e Ekonomis Kombtare.

Numuri i drûvet pemëdhanës në vitin 1927 ¹⁾

Fiq . . .	136,619	Pjeshkë . . .	16,959
Mollë . . .	291,951	Kajsí, zerdeli	26,592
Qershí . . .	106,951	Mana . . .	421,477
Ullë . . .	519,898	Arra . . .	175,633
Dardhë . . .	318,641	Bajama	16,236
Mushmulla . . .	20,681	Lajthí . . .	11,936
Ftoj . . .	45,324	Gështenja . . .	160,559
Kumbulla . . .	344,637	Portokalla . . .	91,744
Sbegë . . .	109,214	Limona . . .	28,870

¹⁾ Nxerrë prej një fletë statistike që e mora nga Ministrija e Ekonomis Kombtare.

2. Pasunija shtázore

Blegtorija

Shqipnija në brezat e naltë të malevet të sajë ka kullota të gjâna, të cilat i kanë dhanë shkas shvillimit të një blegtorije extensive (të sipërfaqëshme), e cila kryesisht kufizohet me dhen edhe mâ pak me dhi. Në dimën shi-



fet nevoja e kullotavet t'ulëta dhe të gjàna, kështu që vit për vit varen e ngjiten tufat (grigjet) e bagëtivet prej maleve nëpër fusha edhe prej fushave nëpër male.

Në Shqipnín e Veriut edhe n'atë të Mesmen kjo ende (ecje) e tufavet bâhet ndërmjet maleve e fushave t'afërme. Kjo punë në disa vise, si me thanë në Mirditë, bâhet edhe kurdoherë mbrenda njëj dite. Në Shqipnín J. P. edhe në Shqipnín e Mbrendëshme Jugore tufat e bagëtivet largohen në verë prej vendit, ku qindrojnë dimënit, tue udhëtuem shumë ditë. Po kjo ngjanë edhe nëpër Alpet e Shqipnís së Veriut. Kelmendasi, me tufat e veta përpara, zdirgjet, dimnit, deri në fushat e Zadrímës, në Jugë të Shkodrës edhe nga një herë deri në gojën e Matit.

Në Shqipnín, përgjithënisht, pas punimit të tokës, blegtorija zen vendin e dytë në jetën t'onë ekonomike. Fisi i Kelmendit, me gjithë që punon edhe pakë tokë në Zadrímë, merret mâ tepër me blegtorí. Po kjo ngjanë edhe me Vllehët e jugës. Disa nga fiset e këtyne janë nomadë të thjeshtë d. m. th. merren me blegtoría me mbarshkrimin e kafshëvet. Këta shetisin gjithë motin, tutje-tetu, me gjithë çkanë e ku kanë, pa u-lodhun tue çuem gjithë jetën e 'tyne ndërmjet kullotavet verore e dimnore. Kasollet edhe çadrat e hapta të këtyneve, formojnë katunde shetitse. Këta pjesësisht enden edhe nëpër kufinin e Greqís (pllaja e Pindit).

Mbarshtimi i kafshëvet, ndër ne, porsi punimi i tokës, gjindet në një shkallë shumë primitive. Na mjerisht deri më sot, kafshëvet t'ona nuk u kemi bâmë banime si na urdhënon hygjiëna edhe veterinaríja. Po kështu, ende nuk e njofim dobín e përmirësimit të racës së bagëtivet (*).

Prodhimet mâ me rëndësi të delevet t'ona janë: djathi i cili, ndër na formon një ushqim populluer me rëndësi; leshi edhe lëkurat. Nëpër malsinat e Shqipnís Jugore, ku gjithë verës tufat ndodhen larg banimit, gjithë qumështi

(*) Kujdesi edhe aktiviteti shtetnuer për këte degë filloj t'api fryte të mira. Vëreni qendrat e ndryshme të veterinerivet në hartën e posaçmel



bâhet djath dhe shpeshë herë kaparoset prej tregtarëve të huej për me u-eksportuem jasht. Djathi, leshi, lëkura edhe gjât e gjalla, që eksportohen jasht, formuen për vendin t'onë një t'ardhun prej mâ se 6 M. fr. ari në vitin 1930.

Përveç dhenvet e dhivet në Shqipni mbarshtohen edhe lopët e nëpër disa vende edhe derrat. Lopët e Shqipnis së Lirë, përgjithësisht, janë të vogla dhe në disa vende fort të degjenerueme, këto apin fort pak qumësht. Vetëm n'ulësinën e Delvinës gjindet një racë lopësh të mira të kryqzeme me lopët Italjane. Po kështu edhe në Shkodër asht tue u shtuem një racë e mirë e lopëve.

Në Shqipni edhe mbarshtimi i kafshëve bartëse ka një rëndësi të madhe. Këto kafshë luejnë një rol të math në punën e marrëdhanjeve që kanë krahnat e ndryshme ndërmjet tyne. Këto janë: kualt, mushkat edhe gomarët. Të gjithë këto kafshë janë të vogla por të forta dhe shumë të durueshme, me gjithë që mbahen e shikohen keq. Edhe këto kafshë prap në ulësinën e Delvinës janë mâ të mira se gjithëkund. Vetëm nëpër fushat e gjâna të Myzeqes gjindet raca mâ e mirë e kualvet rendës. Nëpër livadhet moçalike, që gjinden pranë liqenit të Maliqit, kullosin shumë tufa kualsh, prandaj tegtija e kualvet në Korçë âsht e madhe. Në krahnat moçalike të Shqipnis s'Ulët dhe në fushat e Korçës e të Starovës rriten buallicat, të cilat përdoren për punë toke edhe për qumësht.

Mbarshtimi i shpezëve shtëpijake në Shqipni nuk po zbatohet ende ashtu si duhet pas metodave të reja, me gjithë që në disa vende ka filluem një përveshje për këte e po jep fryte të mira.

Edhe peshkataria (*) në Shqipni âsht lanë krejt mbas dore; e zanmja e peshkut në det nuk po âsht ende tue u bâmë; po ashtu edhe nëpër liqenjt e lumenjt nuk po zba-

(*) Peshkatarija i siguron shtetit një t'ardhun vetëm prej 500.000 fr. ari në vit si taks nga sipërmarrësit. Shqipnija në vitin 1932 ka eksportuem afër 500 tone peshq të ndryshëm.



tohet mënyra e frytëshme e peshkatimit për me siguruem një fitim më të math.

Sasija e gjâvet të gjalla që ka Mbretnja e jonë është si vijon: dele 1,500.000 kokë, dhi 975.000, gjedhë 388.000 (ndër këto afër 10.000 buallica e buej), kual 62.000, gomarë 64.000, mushka 8000, derra 25.000 etj..


3. Pasurit pyjore edhe minerale

Shqipnja, përveç tokavet pjellore për bujqësi edhe kullotavet të gjâna për blegtori ka edhe pasuri pyjesh e mineralesh, të cilat nuk janë shfrytsuem ende ashtu si duhet. Në Shqipni e Mbrendëshme veriake gjinden pasje të mëdha pyjesh sidomos në brezin e ahishtave. Mbassi të gjitha këto pyje gjinden nëpër krahina të vetmueme e të papërshkueshme, nuk ka qenë e mundun t'u merren drutë e t'u çohen nëpër tregje. Por edhe në Shqipni e Ulët, krejt afër brigjevet të detit, ka pyje të mëdha dushqesh, të cilat gjajnë se janë pjesat e mbetuna të një pylli të math, i cili dikurë shtrihesh qysh prej Drinit deri në krahinën e Krujës. Mund të thohet se *pyjet t'ona shtetnore* përbajnë një sasi drush prej 5 milionë m³.

Në kohën e vjetër edhe në kohën e mesme duket se kanë vijuem punimet e minierëvet në disa vende të Shqipnis. Në këto tri qendra është nxjerrë argjend me sasina të mëdha: 1-a te Fandi (Dukagjin), 2^o te Bulgëri (ndërmjet malësis së Leshit dhe Kurbinit), 3^o në malet e Leshit; në këte të fundit kishte pasë edhe florë; florini duket se është nxjerrë edhe në Pirusten, afër Kukësit, tek bashkohen të dy Drinat si edhe në Tomoricë të Beratit ¹⁾.


Këto punime në kohën e Tyrqis u-shtinë në harresë. Vëzhgimet gjeologjike të kohës së fundit kanë nxjerrë në dritë disa vende që mund të vleftësohen. Ka kohë që në Shqipni e Ulët Jugore janë dukun shenjat e vojqurit. P. sh.

¹⁾ Shikoni librin Pritmi i Shqipnis prej Lumo Skendo faqe 44.



HARTA
E
SHQËYTNIS

Shkalla 1:1.200.000



asfalti (sera) e Selenicës, pranë Vlonës, është në përdorim qysh prej vitit 1875 edhe jep një prodhim të përvjetshëm prej 5.000 tonelatash. Shumë shoqëri të huaja kanë marrë koncesionet e vojturisë.

Me rëndësi të madhe janë vendet squfrore të Mirditës. Këto, në bazë të studimeve të bëra prej gjeologëve, kujtohet të kenë një pasje tepër të madhe si në sasi ashtu edhe në cilësi; veç kësaj është çmuem edhe se puna e të nxjerrurit si edhe të të vënit të tyre në vlerë do të jetë tepër e lehtë; mirëpo gjendja e mjeteve marrëdhënëse në mes të njëj malsije të papërshtueshme është mjaft e vështirë.

Mbasandaj me pakicë gjinden chromi, rami, arzeni, hekuri, oliti i hekurit, të cilët janë të përndamë aty këtu. Interesant është ndodhja e linjitetit (thingjill guri gjymës i bamun) në Krrabë edhe afër Korçës edhe pak ram i përziem me pak flori në jugë po të këtij qyteti¹⁾.

Shqipëria është mjaft e pasur edhe nga burimet minerale edhe thermale. Më me rëndësi janë padyshim burimet squfrore të Llixhës s'Elbasanit me një temperaturë më se 60° C. Këtu gjinden edhe bânjat.

4. Mjetet marrëdhënëse edhe rrugët në Shqipëri

Deri në kohat e fundit rrugët mungojshin, pothuë se krejt në Shqipëri. Nga kjo mungesë spjegohet vetmija ekonomike e krahinave të ndryshme të Shqipërisë. Disa vjet mbas luftës Botnore gjindeshin afër 1000 km. rrugë por tash, ditë për ditë çilen rrugë të reja dhe marrëdhënëse bënë jo më me karavana por me automobila të ndryshëm e me qerre. Përpara nga mungesa e rrugëve prodhimet që eksportonte një prefekturë n'Itali, i blente tjetra atje, si p. sh. vojën e Vlonës e blente Shkodra n'Itali, edhe lëkurat e Shkodrës e t'Elbasanit i blente Gjinokas-

¹⁾ Vereni hartën gjeologjike prej Dr. Ernst Nowack.



tra po atje. Gjinokastra blinte drith n'Italí kurse Berati s'kishte se ku ta çonte të vetin. Nga ky shkak nuk janë shvilluem punimet bujqësore në Myzeqenë t'onë pjellore.

Hekurudhat në Shqipni mungojnë krejt. Në kohën e luftës, fuqit pushtuese, patën ndërtuem disa vija dekovilash të cilat má vonë u-rrënuen. Vetëm dy vija dekovili, që shkojnë prej Vlone në Selenicë edhe në kryporen e Artës, janë në përdorim.

Nji rrjetë ajrore sot kryen shërbimin e bartjes së shpejtë të njerëzvet si edhe të postavet, pothue se ndërmjet gjithë qytetevet má kryesorë të Shqipnis.


Lundrimi në Shqipni nuk ást shvilluem pothue se aspak. Shërbimi i lundrimit ndërmjet Shqipnis e botës së jashtme sot po kryhet krejtësisht prej shoqnitvet të hueja, të cilat kanë në dorë rregullimin e marrëdhanjevet. Vetëm nji pakicë lundrimi buzëdetar, báhet prej lundravet t'ona.

Këndim. — Rrugët në Shqipni ¹⁾

Rruga që fillon në kufinin grek, Kapështicë, mbrenda në tokën Shqiptare, shkon nëpër Bilisht, mbërrin në Korçë dhe këtu ndahet në dy dega: nji vijë ndjek kufinin grek dhe shkon përmes Kolonjës, Leskovikut, Përmetit, Tepelenës, Gjinokastrës, Delvinës e mbërrin në Sarandë, prej ku fillon nji vijë e ré, e cila shkon përmes Himarës e mbërrin në Vlonë; gjithë ashtu nga Saranda e nga Gjinokastra rruga mbërrin në kufinin grek, Kakavijë.

Dega tjetër e Korçës shkon përmes Pogradecit, Quksit, Librazhdit, Elbasanit, Peqinit, Rogozhinës, Kavajës, Durrësit, Shijakut e mbërrin në Tiranë. Po kjo rrugë me të dalë nga Elbasani, (4 km. afër urës së Kushës) lëshon nji brryl nga Krraba edhe shkon në Tiranë. Prej këndeje rruga në Vorrë bán nji brryl dhe ndahet në dy vija: njana tue

¹⁾ Kjo copë ást marrë prej librit Shqipnia më 1927, T. Selenica (faqe L.) tue i u-shtuem edhe pjesa e rrugëvet që s'ishin të godituna atëhere.



shkuem nga fusha e Prezës dhe e Krujës, i lëshon edhe një degë për këte qytet, kalon n'urën Zogu, në lumin e Matit, mbasandaj si e përshkon përmes edhe Leshin mbërrin në Shkodër dhe së këtejmi përmes Koplikut, kalon në kufinin Jugoslav, në Hot, dhe një vijë tjetër nga Kopliku mbërrin deri në Shkrel e tutje.

Tash janë tue vijuem punimet e rrugës ndërmjet Shkodrës edhe Kukësit.

Rruga Korçë—Elbasan, në Librazhd ndanë një degë nga veriu, e cila tue kaluem Gollobordën edhe ulësinën e Drinit të Zi, e tue i u-qasun në shum vende kufinit Jugoslav mbërrin në Peshkopí.

Një rrugë e re tue vijuem prej Elbasanit e lidhë këte me Gramshin.

Po kështu rruga Krue—Burrel, që të mbërrijë deri në Peshkopí në një anë, edhe nëpër Mirditë tue ndjekë luginën e Fanit, n'anë tjetër, që të mbërrijë deri në Kukës, është në ndërtim e sipër.

Dega tjetër e rrugës së Tiranës, tue shkuem përmes Durrësit e Kavajës, në Rrogozhinë kalon Shkumbinin mbi një urë madhështore, e tue përshkuem përmes edhe Lushnjen mbërrin në Berat. Prej këndeje rruga ndahet në dy drejtime: njana në Poshnje tue kaluem Qafën e Sqepurit, përmes Roskovecit mbërrin në Fier ¹⁾ e së këtejmi tue kaluem Viosën, mbi një urë të ré në Mifol, mbërrin në Vlonë, prej ku një rrugë përmes malit të Llogarasë shkon në Himar e prej andej mbërrin në Sarandë e tjetra nga malet e Kudhësit shkon për në Tepelenë. Drejtimi i dytë i rrugës së Beratit, tue kaluem, me urë në qytet, lumin Osum, vijon në malet e Çorogjatit e të Gllavës dhe përmes fushës së Deshnicës mbërrin në Këlcyrë, ku bashkohet me rrugën që shkon për Gjinokastër.

Nga këto spjegime kuptohet se gjithë prefekturat e Shqipnis, përveç prefekturës së Kosovës, janë lidhun ndër-

¹⁾ Tash së voni, për me lith Fierin me Lushnjen u-hap një rrugë e ré më e shkurtën, që shkon përmes Myzeqes (23 km.).



mjet 'tyne me një rrjetë rrugësh edhe udhëtimi në këto vende është mjaft i lehtë edhe kryhet me automobila. Rrugët t'ona të mbarueme deri më sot kanë një gjatësi prej 2.189,952 km. nga këto 1.141,532 km. janë rrugë Kombëtare, 661,411 Provinciale edhe 387,001 Komunale.

Këtu shenohen rrugët e përmenduna me gjatësinë e 'tyne në kilometra:


Tiranë — Korçë	km.	190,006
Tiranë — Shkodër	"	120,520
Tiranë — Berat	"	128,647
Tiranë — Vlonë	"	160,816
Tiranë — Durrës	"	38,798
Tiranë — Elbasan	"	55,027
Tiranë — Burrel	"	86,892
Elbasan—Peshkopi	"	133,066
Elbasan—Durrës	"	86,546
Korçë—Gjinok.—Sarandë	"	270,543
Korçë—Përmet—Vlonë.	"	260,068
Sarandë—Himarë—Vlonë	"	130,140
Berat—Fier—Vlonë. . .	"	82,901
Elbasan—Gramsh	"	43,213

5. Tregtija e jashtme e Shqipnis

Një verejtje përmbi statistikën e tregtis së jashtme të Shqipnis dëftën qartazi se sa e paforcume është ekonomija e vendit t'onë. Kjo dëftën edhe se cilat janë nevojat më të mëdha të vendit dhe me çfarë prodhimesh mundet Shqipnija me i blëmë gjëndet e nevojshme përjashta Shtetit.

Na tregtin kryesore t'onën e bëjmë me *Italin*, prej së cilës na importohen afër $\frac{2}{5}$ -tat (8.918.800 fr. ari) e gjëndet të nevojshme. Kësaj i shesim $\frac{3}{5}$ -tat (2.822.105 fr. ari) e gjëndet që eksportojmë. Rolin më të math të marrëdhënjëve t'ona tregtare e luen Trieshta edhe mbas të ndamunit të sajë prej Austris; por edhe Bari nuk po i mbetet aqë prapa Trieshtës edhe duket se për pak kohë do t'a kalojë atë.

Vendin e dytë, të tretë, të katërtë etj. radhazi e zanë: *Shtetet e Bashkueme t'Amerikës* (2.215.700 imp.,



996.250 eksp.), *Jugoslavija* (2.063.000 imp., 55.025 eksp.), *Çekoslovakija, Anglija, Greqija* etj...¹⁾

Vlefta e tregtis s'onë të përgjithëshme u-naltsue prej 1920 deri më 1923, prej 20 M.*) fr. ari. në 30 M. Vjeti 1922 me 15 M. paraqiti një t'ulme të përkohëshme, mbassi në vitet e tjerë erth prap tue u-naltësuem e me 1929 mbë-rini në shumën 53 $\frac{1}{3}$ M. në një maksimum. Në vitin 1930 u ulë prap në 45.650 M. fr. ari. Kjo ulje e vleftës tregtare vijoj po kështu edhe në vitet 1931 e 1932; 37 M. fr. ari në të parin edhe 27 M. fr. ari në të dytin. Viti 1925 (22 M. fr. ari imp. 17 M. fr. ari eksp.) me afrimin e eksportit në importim ka pasë një bilancë tregtare më të favorshme se vitet e tjera, të cilët këte bilancë e kanë pasë me një shumë pasivi më të madhe.

Në importim, për t'u çuditë, vendin e parë e kanë gjënat ushqimore. Në vjetin 1932 këto kapen në 7,7 M. fr. ari prej të cilavet 4 M. për drith e të tjerat për gjëna koloniale si sheqer, kafe, oriz, etj... T'importuemit e drithit shkaktohet nga thatësija e madhe e verës²⁾ edhe nga mungesa e kanalevet ujitse. Vendin e dytë e kanë pëlhurat me 3 $\frac{1}{3}$ M. fr. ari (Statistika 1932), prej të cilavet 2,5 M. fr. ari janë pëlhurat e pambukut. Mbas këtyne vijne gjana luksi të mundafshita, të leshta dhe lëkura këpucësh. Gjënat e tjera që importohen janë automobilat, material për ata, si benzinë etj., çimento, trenë e drresa, vojguri, xhama, porcelana, karta etj...

Përkundrejt importimevet që më 1932, kapën shumën 22.814.000 fr. ari eksportojmë gjënat e poshtëshe-nueme, të cilat kapin shumën 4.500.360 fr. ari.

Gjënat e eksportueme rreth vitit 1932 bashkë me vleftën e tyre po shënohen këtu:

1) Vereni tabelat e ndryshme me shifra edhe me grafikë, të cilat tregojnë sasin e tregtis s'onë të jashtme. Krahasoni artikujt e ndryshëm t'eksportit edhe t'importit si edhe shtetet me të cilët kryhet kjo tregti!

* M = milion.

2) Të randuemit e bilancit tregtar të vitit 1932 me importimet e drithit u shkaktohet nga thatësija e madhe që mbretnoi në verën e vitit 1931. Kurse vitet 1932 e 1933 me verrat e tyre më të favorshme për bujqësin, jo vetëm zhdukën zën e bukës por e prunë Shqipnën në gradë që t'eksportoje sasina të mëdha drithi



I. Kafshët dhe produkti i 'tyne:			
Shtazë gjithëfarësh	krenë	11,574	fr. ari 115,050
Lëkura — — — —	kgr.	372,021	" " 380,016
Lesh — — — —	"	289,100	" " 299,000
Djathë — — — —	"	738,645	" " 1,290,915
			Shuma " " 2,084,915
II. Ullijt e prodhimi i 'tyne:			
Ullij — — — —	kgr.	3,388,655	fr. ari 422,865
Voj ullini — — —	"	14,632	" " 12,252
			Shuma " " 435,117
III. Vezët — — — —	"	639,219	" " 485,000
IV. Dru e qymyr druni:			
Dru — — — —	"	4,197,925	" " 190,255
Qymyr — — — —	"	899,450	" " 202,990
			Shuma " " 393,245
V. Peshk e putarga— —	"	508,858	" " 493,641
VI. Zift — — — —	"	4,358,650	" " 288,910
VII. Duhan e cigare — —	"	23,377	" " 37,690
VIII. Zhugë (xunkth) -- —	"	594,500	" " 64,435

Kur është moti i mbarë teprica e misrit (kollomboqit), pastaj edhe gruni, voji, grosha etj. eksportohen; por edhe ky eksportim i vojit është i paqindrueshëm nga shkakut se ullishtat nuk apin mot për mot prodhime¹⁾. Shumë herë importohet drith edhe voj për t'a mbuluar mungesën e shkaktueme nga moti i prapët bujqesues.

Me prodhimet e blegtoris ndryshon puna krejt. Prodhimet e blegtoris si gjâja e gjallë, djathi, tëlyni, leshi, lëkura, veja (vezët), me gjithë që edhe këto nuk janë gjithënjë të qindrueshme, nuk mund të krahasohen me ato të bujqesues, të cilat nga shkakut i motit të prapët edhe nga mungesa e metodave të punimit, janë të pa sigurta. Prandaj të mbajtunit e gjâs së gjallë. d. m. th. mbarshtimi i kafshëveve shtëpiake për bujkun t'onë luan një rol të math. Ky me anën e produkteve të blegtoris mundet me blemë gjithë çka i nevojitet.

Asht për t'u-shënuem se shumicën e djathit e eksportojmë për Sh. B. t' Amerikës dhe një pjesë për Greqi e

1) Mënyra e keqe e të vjelunit është një nga shkaqet kryesore.



Italí. Tregtarët Grekë shumë herë blejnë djathin e shumë tufavet tok dhe e dërgojnë në Greqí. Një rol má të vogël luen eksportimi i mëshigzavet të mundafshit. Për Vlonën ka një rëndësi të veçantë eksportimi i ziftit (asfaltit = serës) të Selenicës.

Tregtija e mbrendëshme, që bâhet me gjânat e produkteve në vend, kur krahasohet me tregtinë e jashtme, mbetet fare me pak rëndësi. Me krypën, që nxirret në Artë, pranë Vlonës, edhe në Kavajë, tregtohet në të gjitha anët e Shqipërisë, përndryshe tregtija e mbrendëshme, me kuptimin e plotë të sajë, kufizohet me produktet e mjeshtrisë së dorës që ndërrohen a shkëmbehen me prodhimet natyrore ndërmjet qyteteve e katundeve.



Pasqyrë e lëvizjes së tregtis së jashtme për vjetët 1932 e 1931, ndamun nëpër Shtete më kryesore *)

E K S P O R T I M


Nr. rend.	SHTETET	FR. ARI		
		1932	1931	o/o
1	Itali . . .	2,822 105	4,965.800	66.15
2	Amerikë . . .	996.250	769 800	10.25
3	Greqi . . .	589.465	1,422 500	18.94
4	Jugosllavi . . .	55.025	143.600	1 91
5	Angli . . .	6.665	62.900	0.83
6	Francë . . .	3.070	121.600	1.61
7	Sh. tjera . . .	27.730	22.800	0.31
		4,500.360	7,509.000	100 0/0

I M P O R T I M

Nr. renduer	SHTETET	FR. ARI		
		1932	1931	o/o
1	Itali . . .	8,918.800	18,839.500	39.10
2	Amerikë . . .	2,215.700	2,803.600	9.72
3	Jugosllavi . . .	2,063 000	2,733 300	9.05
4	Çekoslovaki . . .	1,766 900	1,982 000	7.75
5	Angli . . .	1,561.880	1,770.900	6.84
6	Gjermani . . .	1,113.200	1,325 300	4.88
7	Rumani . . .	1,030.800	117.300	4.52
8	Bulgari . . .	862.200	224.600	3.78
9	Austri . . .	667.300	951.400	2.92
10	Greqi . . .	644.900	1,076.200	2.82
11	Francë . . .	436 800	672.00	1.91
12	Belgjikë . . .	374.700	600.100	1.65
13	Japani . . .	290.000	115.500	1.27
14	Ungari . . .	255 000	430.400	1.11
15	Svicër . . .	77.800	116.100	0.34
16	Turki . . .	53.200	131.400	0.23
17	Hollandë . . .	48.100	40.500	0.21
18	Egypt . . .	35 300	110.000	0.15
19	Svecl . . .	37.420	11.500	0 15
20	Sh. tjera . . .	364.200	461.700	1.60
		22,814.500	29,513.300	100 0/0

*) Pasqyrat e faqeve 104, 105, 106, 107 dhe 108 janë marrë nga Statistika e Tregtis së jashtme të vitit 1932.





Përmbledhja (importim) e disa artikujve më kryesorë në vjetër 1932 e 1931

EMËRTIM i gjësë	1932		1931	
	Sasija	Vlefë fr. arl	Sasija	Vlefë fr. arl
Grinë	978,092	160,029	3,227,251	647,081
Misër	38,067,221	3,945,216	26,401,212	2,797,497
Oriz	3,164,505	570,942	3,440,355	869,969
Kafe	609,327	640,873	639,887	800,296
Sheqer	4,720,541	1,120,227	5,356,629	1,259,127
Birri	546,292	290,952	616,189	391,476
Voj për industri	678,167	299,179	740,344	379,375
Lëkurë të punueme	150,926	369,274	211,105	606,961
Landë nërtesë	12,985	556,407	17,774	984,007
Pambuk (fiqe)	207,601	422,460	251,982	602,601
Pëlthurë pambuku	886,562	2,576,839	906,959	3,294,096
Pëlthurë leshi	83,774	698,815	92,362	895,404
Pëlthurë mëndafshi	6,676	104,145	7,358	122,613
Çemento	23,079,520	635,901	26,547,740	1,098,447
Trena e hekura	924,572	147,655	2,666,924	488,688
Mašina për indus.	319,854	377,410	657,282	710,364
Mašina për bujqësi	71,551	63,137	210,140	158,406
Automobila	163	539,670	276	943,280
Bensin	3,133,266	793,378	3,290,186	869,990
Voj guri	2,091,780	418,855	2,321,019	544,835
Nasfë	1,961,265	294,190	947,780	116,399
	—	15,025,054	—	18,560,550

Përmbledhja (eksportim) e disa artikujve më kryesorë në vjetër 1932 e 1931

EMËRTIM i gjësë	1932		1931	
	Sasija	Vlefë fr. arl	Sasija	Vlefë fr. arl
Shtazë gjithfarësh	kre- ne	11,547	415,050	92,839
Djathë	kg.	738,645	1,290,915	730,669
Ve (vezë)	«	639,219	485,009	1,479,927
Peshk	«	508,858	493,641	476,030
Ullij	«	3,388,655	422,865	4,372,883
Voj ullini	«	14,632	12,252	47,489
Duhan e cingare	«	23,377	37,690	305,191
Lëkurë shtazësh	«	366,974	338,777	426,159
të buta	«	5,047	41,239	9,524
Lëkurë shtazësh	«	4,197,925	199,255	2,484,510
t'egra	«	594,509	64,435	599,760
Dru zjarmi	«	289,100	299,000	896,747
Zhugë (xunkth)	«	899,450	202,990	3,585,730
Lesh	«	—	—	14,760
Qymyr drumi	«	4,358,650	288,910	3,163,259
Shqeme, druce gjethi	«	—	—	—
Zyft (serë)	«	—	4,283,028	—
				7,228,030

Shënim: Këto përmbledhje janë marrë nga Statistika e Tregtis së jashtme për vitin 1932, faqe XVII e XVIII.




Pasqyrë komparative e shvillimit të tregtis së jashtme për disa artikuj kryesorë gjatë viteve 1930-31-32

EKSPORTIM

IMPORTIM

Shkalla e naltësive :

1/2 cm. për 1,000.000 fr. ari



1930 1931 1932

Gjithë . . . 1932 1931 1930

Karburanta . 1931 1930

Makina Indus- 1931 1930

Tire e bujqësi 1932

Trena, heku- 1930 1931 1932

ra gjithfar. . 1932

Pëlhurë leshi 1930 1931 1932

Pëlhurë pam- 1930 1931 1932

bukë 1932

Lëndë ndërtim- 1930 1931 1932

mi e gemento 1932

Lëkurë të pu- 1930 1931 1932

nueme 1932

Koloniale . . 1930 1931 1932

Gjithë të 1930 1931 1932

ndryshme . . 1930 1931 1932

Lesh 1930 1931 1932

Lëkurë të pa 1930 1931 1932

puneme . . . 1930 1931 1932

Ullin e voj 1930 1931 1932

Vezë 1930 1931 1932


Djathë 1930 1931 1932

Shtazë 1930 1931 1932



Lëvizja e tregtis së jashtme e ndamun nëpër Dogana (në mij fr. ar)

N. rend.	DOGANAT	EKSPORTIM			IMPORTIM		
		1932	1931	1930	1932	1931	1930
1	Vlonë— — —	1,078.6	2,430,0	2,376,2	2,152,9	2,580,0	4,194,8
2	Durrës — — —	588.7	1,350,0	2,932,9	10,240.6	12,869,3	14,094,3
3	Sarandë — — —	1,233.1	1,250,0	2,610,0	2,778.6	4,050,0	4,636,6
4	Shkodër — — —	337.9	655,0	1,077,7	2,959,8	4,088,0	4,550,5
5	Vivar — — —	442.4	570,0	796,5	6,1	1,6	14,2
6	Shingjll — — —	360.3	395,0	341,1	645,1	802,0	559,8
7	Patok — — —	195,4	175,0	383,7	0,6	--	--
8	Seman — — —	108,2	135,0	407,1	106,2	140,0	138,3
9	Perat — — —	12,1	130,0	315,1	27,8	36,0	37,5
10	Himarë — — —	89,1	125,0	324,0	30-	55,0	14,8
11	Kakavi — — —	12,3	115,0	146,4	50,7	52,8	75,2
12	Kapshticë — — —	13,3	70,0	302,5	2,005,0	3,325,0	3,889,3
13	Blldë — — —	7,5	37,0	129,4	212,5	75,2	63,3
14	Qaf-Thanë — — —	12,-	91,0	61,1	2,4	30,8	27,6
15	Mursi — — —	2,2	20,0	46,6	--	0,4	0,5
16	Letaj — — —	1,8	11,0	33,9	97,9	29,5	10,6
17	Morinë — — —	4,6	11,0	28,9	230,8	170,0	131,0
18	Goricë — — —	--	--	22,9	18,7	46,5	36,9
19	Pogradec — — —	0,8	1,5	11,5	260,8	247,5	151,4
20	Qaf-Badër — — —	--	--	1,5	--	--	--
21	Sopik — — —	--	--	0,5	--	0,9	2,8
22	Pulaj — — —	--	7,5	3,0	--	--	--
23	Korçë — — —	--	--	--	372,5	375,5	342,2
24	Tiranë — — —	--	--	--	603,1	537,2	318,3
25	Hot — — —	--	--	--	12,4	--	--
		4,500,3	7,503,0	12,352,0	22,814,5	29,513,3	33,288,9



6. Gjindja ekonomike e kulturele e Shqipërisë

Nji verejtje përmbi gjendjen ekonomike të vendit t'onë na jep nji fytyrë jo aqë të gëzueshme. Vendi i ynë ka kushte të mira për shvillimin e lulëzueshëm t'ekonomisë; por për fat të keq nga këto kushte as njani deri tash vonë, nuk qe shti më ndonji përdorim.

Këte gjindje na e patën shkaktuem shumë gjana. Shkalla e ungjët e kulturës së popullit, paplotësimi i rrugevët e i mjetevet marrëdhanore, përpjestimi jo i mbarë i pronisë, nevoja e madhe e kredisë, malarja e sëmundjet e tjera...etj..

Qeverija, nën prirsin gjeniale të N. M. Tij Mbretit t'onë, Shpëtimtarit të Kombit, tue i kuptuem këto të meta po mundohet me natë e me ditë për me përmirësuem gjindjen. Shenjat e këtij përmirësimi zûn të shifen për hera më shumë në çdo degë t'organizatës shtetnore.

Rrugët, që na mungojshin krejtësisht më parë sot lumnisht po i shofim se po shvillohen e po përmirësohen gjithënjë në trajtën e nji rrjete tue siguruem marrëdhanjen e gjithë qytetet t'ona.

Bankat e ndryshme si Banka Kombtare, e Banka Bujqësore, që është tue u themeluem, mund ta sigurojnë nevojën e kredisë.

Reforma agrare do ta sjelli në drejtim të mbarë çash-tjen e pronisë.

Shoqnit e hueja, tue pamë qetësin shembullore, që mbretnon n'atdheun t'onë zunë ta konkurojnë shoqja shoqen për me ardhun në vendin t'onë e me shfrytzuem pyjet e pasurit e tjera, që përmban *truelli i Ynë arbnuer*, (mbassi kapitalet t'ona mjerisht nuk po munden me i byrë të gjitha këto punë të randa përnjiherë).

Projektet e të thamunit të moçalevet e të kënetavet si edhe të të rregulluemit të lumejve e të kanaleve janë bâmë gati edhe për së shpejti do të vëhen në zbatim tue shkaktuem nji lumni në katër anët e Atdheut të Shtrëjtë.

Organizata e vlefshme bujqësore në çdo qendër po



përpiqet me gjallëni që ta mësojë bujkun të punojë më mirë tue i dhënë këtij vegla më të reja, farë më të zgjedhun edhe këshillime dobipruse.

Po kështu edhe organizata shëndetsore me një aktivitet të gjallë po i vjen në ndihmë popullit për t'ia përmirësuar shëndetin, tue hapun spitale e dispenserina në shumë vende edhe tue dërguem anë mb'anë t'atdheut mjekë shetitës. Me këte rast duhet t'i kujtojmë me mirënjohësi edhe punimet plot gjallëni, t'organizatës antimalarike të Rockefeller-it, një organizatë kjo e cila në bashkëpunim me Bashkit e vendeve fqinjsh e malarike (Vlonë, Berat, Durrës, Elbasan, Shkodër, Tiranë etj...) ka hapun stacionet antimalarike me mjekë specialista shqiptarë, për t'i zhdukun anofelët (miskonjat) që përhapin malarjen.


Gjithë rinija Shqiptare me ndihmën e organizatave arsimore e sportive, t'entit e t'ushtrisë kombtare zu të marri një fytyrë më të gjallë tue shkundë atë pluhurin e përtimit, që merrte trashëgim nga prindët e shtypun nën zgjedhën e huej.

Më në fund dega arsimore me vullnet të patundun po e formon brezin e ri me ndjenja e karakter krejt kombtare, me virtyte të nalta morale e fizike me anën e shkolllavet fjesht kombtare, tue i mësuem e edukuem shtetasit Shqiptarë vetëm ndër shkolla dhe institute shtetnore shkallësh të ndryshme.

Sot në gjithë Shqipëri t'onë gjinden dhe veprojnë 540 shkolla fillore, me më se 40.000 nxanës e nxanëse, 10 shkolla të mesme për vajza edhe për djelm me 4000 nxanës e nxanëse.

Shteti mban edhe shumë nxanës me bursa kombtare nëpër vendet e hueja (nëpër universitetet e hueja) si edhe shumë nxanës nëpër konviktet e shkollavet fillore e të mesme mbrenda në Shqipëri.

Gjithë këto veprime të gjalla pra janë fakte edhe na apin s'harriqin se vendi i ynë ka zënë rrugën e përparimit të vërtetë edhe së shpejti gjithë kombit mbarë ka me i ardhë dita e lumnueshme e fatbardhe, të arrijë në një shkallë të naltë qytetnimi.



Formimi i Shtetit

Forma e qeverimit të Shqipërisë është mbretëri demokratike, parlamentare edhe e trashigueshme.

Flamuri i Shqipërisë është i kuq me Shqiponjën e zezë dykrenëshe në mes.

Gjuha zyrtare është Shqipja.

Shteti Shqiptar nuk ka fé zyrtare; çdo fé është e lirë dhe ushtrimi i 'saj është i siguruem.

Gjithë pushtetet shtetnore burojnë nga kombi. Pushteti legjislativ ushtrohet prej Mbretit edhe Parlamentit, që përbâhet prej një dhome.

Parlamenti përbâhet prej deputetësh të zgjedhun prej popullit për periodën katër vjetëshe. Për çdo 15.000 frymë edhe për çdo fraksion që kalon 7.500 frymë zgjidhet një deputet.

Deputeti duhet të jetë shtetas Shqiptar, të ketë mbushun 30 vjetët, të gëzojë të drejtat civile e politike, të dijë me shkruem e me kënduem gjuhën shqipe.

Iniciativa e ligjëvet i përket Mbretit dhe parlamentit; por propozimi i ligjëvet që sjellin shtesë financiare i përket Mbretit.

Çdo ligjë për me qenë e zbatueshme duhet të jetë e votueme prej parlamentit dhe e pëlqyeme prej Mbretit, Pushteti përmbarues i përket Mbretit.

Mbreti i Shqiptarëve është *Zog I* nga fëmija e famëshme shqiptare *Zogu*.

Trashigimi i fronit mbretnuer i përket vijës direkte; në mungesë të trashgimtarëve të vijës direkte, trashgimtari caktohet prej Mbretit.

Në krye të shërbimevet shtetnore i lidhun drejtë për së drejti ke Mbreti, ndodhet Këshilli Ministrues i përbâmë prej Kryeministrit e Ministravet.

Mbreti ngarkon Kryeministrin me formuem kabinetin.

Gjygtarët në të dhanunit e vendimeve janë të pavarun dhe udhëhiqen vetëm prej ligjës dhe ndërgjegjës



së 'tyne; askush nuk mund të ndërhyjë dhe t' influencojë në dhanjen e vendimevet gjygjësore.

Çdo Shqiptarë lind dhe rron i lirë. Lirija është nga të drejtat natyrore për çdo njeri dhe kufizohet me kufirin e liris së të tjerëvet, dhe ky kufi caktohet me anë të ligjëvet.

Lirija personale është e garantueme. Askush nuk mund të ndiqet, t' arrestohet, të burgoset veçse në rastet e parapame prej ligjit dhe në formën e caktueme prej 'tij.

Të gjithë shtetasit janë baraz para ligjit dhe pa përjashtim janë të detyruem me i respektuem ligjët.

Mësimi edhe edukimi i shtetastet Shqiptarë janë një e drejtë eksklusive e Shtetit. Jepen vetëm ndër shkolla dhe institute shtetnore shkallësh të ndryshme, si mbas ligjës.

